



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 644 Akti

Nr. 744 Vendimi
Tiranë, më 19.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 12.3.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artan Hajredinaj**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Artan Hajredinaj, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VË R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Artan Hajredinaj është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Artan Hajredinaj, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 30.1.2024, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artan Hajredinaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 30.1.2024, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 14.2.2024; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 30.1.2024, subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.

8. Në datën 12.2.2024, subjekti paraqiti kërkesë për zgjatjen e afatit për të paraqitur provat dhe shpjegimet.

9. Me vendimin nr. 3, datë 12.2.2024, trupi gjykues pranoi kërkesën e subjektit për zgjatjen e afatit, duke i caktuar një afat deri në datën 24.2.2024.

10. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 7.3.2024, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore për në datën 12.3.2024.

11. Në datën 12.3.2024 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm së bashku me përfaqësuesin ligjor, dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

13. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja (ish-DSIK) është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 28.1.2017, pra në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Artan Hajredinaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPDF) me nr. indeksi *** dhe më pas ka dorëzuar deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Artan Hajredinaj, ka konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, si dhe të personave të lidhur me të.

19. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

20. *Apartament banimi, me sip. 113.1 m², kati ***, adresa rruga “***”, ***, Tiranë, kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2006, blerë në shumën 45.000 euro dhe 30.000 euro shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, nga të ardhurat si noter vitet 2001 – 2007, shitje toke bujqësore, kredi pranë NBG Bank. Vlera: 75.000 euro.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

20.1. Në lidhje me këtë, pasuri nga aktet në dosje rezultoi se sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2006, subjekti Artan Hajredinaj ka porositur një apartament te shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k., me sip. 113.1 m², ndodhur në Komunën ***, në vlerën totale 45.000 euro. Në përgjigje të pyetësorit standard, ashtu sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se i ka paguar ndërtuesit gjithsej shumën prej 40.000 euro, konkretisht në datën 18.10.2006 shumën 20.000 euro, në datën 26.3.2007 shumën 10.000 euro dhe në datën 22.8.2007 shumën 8.000 euro, për të cilat ka paraqitur edhe mandatpagesat, ndërsa për shumën 2.000 euro deklaroi se nuk mund të gjejë dokument. Në këtë deklaratë subjekti shpjegon se ndërtuesi i ndërpreu punimet kur apartamenti ishte në fazën e karabinasë dhe në këtë periudhë ai aplikoi për të marrë një kredi. Punimet për përfundimin e apartamentit i kreu vetë me të ardhura të përfituara nga kredia e marrë pranë NBG Bank prej 35.000 euro dhe, në këto kushte, shuma e mbetur sipas kontratës së sipërmarrjes prej 5.000 euro, e palikuiduar, nuk iu kërkua më nga ndërtuesi, fakt që do të reflektohej në kontratën finale që do të redaktohet pasi të regjistrohet apartamenti në emër të shoqërisë. Po kështu, ka deklaruar se në të njëjtën datë 16.10.2007 ka marrë edhe një kredi konsumatore prej 5.000 euro, kryesisht për mobilim apartamenti.

20.1.1. Siç vërehet, pasuria është porositur në vitin 2006 kur subjekti ka qenë noter dhe në datën 18.10.2006 ka paguar shumën 20.000 euro. Subjekti ka filluar detyrën e gjyqtarit në datën 20.3.2007 dhe 6 ditë më vonë, në datën 26.3.2007, ka paguar shumën 10.000 euro, ndërsa 4 muaj më vonë, në datën 22.8.2007, ka paguar shumën 8.000 euro. Shuma 2.000 euro për të cilën subjekti nuk ka dorëzuar një mandatpagesë u konsiderua e paguar në datën 22.8.2007. Nga informacioni i ASHK/ZVRPP nuk ka të dhëna për regjistrimin e pasurisë në emër të subjektit, pasi sikurse edhe subjekti ka deklaruar nuk është bërë kalimi i pronësisë me kontratë shitjeje në emër të tij.

20.1.2. FSHU-ja ka konfirmuar në emër të z. Artan Hajredinaj kontratën nr. *** dhe nga detajet figuron adresa ***, kabina “***”, lidhur në datën 30.3.2017, për të cilën subjekti ka paraqitur

librezën në emër të tij. UKT-ja nuk ka konfirmuar ndonjë kontratë në emër të z. Artan Hajredinaj apo familjareve të tij, por subjekti ka paraqitur librezë uji me nr. kontrate *** në emër të tij, me adresë rruga “****”, pallati “****”.

20.2. Sa i takon çmimit të paguar për blerjen e kësaj pasurie, nga verifikimi i të gjitha deklarimeve të subjektit u konstatuan disa paqartësi e mospërputhje në vlerat dhe periudhat e kryerjes së pagesave. Konkretisht, ndryshe nga kontrata e porosisë që parashikon çmimin prej 45.000 euro, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti deklaroi se vlera faktike e paguar prej tij te shoqëria ndërtimore është në shumën 40.000 euro, duke pretenduar që 5.000 euro iu falën nga ndërtuesi. Edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka paraqitur të njëjtin pretendim, duke paraqitur një deklaratë noteriale me datë 11.9.2023 të ndërtuesit “****” sh.p.k., me administrator P. K., i cili pohon deklaratimet e subjektit. Ndërsa në të gjitha deklaratimet e interesave periodikë vjetorë të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, si vlerë pasurie ka deklaruar vlerën 70.000 euro.

20.2.1. Sa i takon kredisë së marrë nga ABI Bank të pretenduar për kryerje punimesh, ky institucion konfirmon se subjekti është financuar me një kredi hipotekore në shumën 35.000 euro sipas kontratës së kredisë datë 16.10.2007. Nga ekstrakti i llogarisë bankare të subjektit, kjo shumë është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 25.10.2007 e më pas është transferuar po brenda kësaj dite, por pa u identifikuar përfituesi i këtij transferimi. U pyet subjekti në lidhje me përfituesin e kësaj shume, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaroi se pas disbursimit me datë 25.10.2007, shuma është tërhequr *cash* nga ai po në këtë datë dhe se kjo shumë është përdorur për rikonstruksion dhe mobilim të apartamentit. Iu rikërkuar informacion ABI Bank, e cila në përgjigje të saj ka bashkëngjitur mandatin e transaksionit, ku rezultoi se përfituesi i shumës 35.000 euro është shoqëria “****” sh.p.k., me detaje të transaksionit “Blerje apart. Artan Hajredinaj”.

20.2.2. Në këto kushte, sipas provave shkresore të administruara në përfundim të hetimit, shuma në total e paguar nga subjekti për pasurinë rezultoi të jetë 74.510 euro, e cila është pothuajse e njëjtë me vlerën e pasurisë së deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 75.000 euro dhe përbëhet nga:

i) 40.000 euro paguar gjatë periudhës 18.10.2006 – 22.8.2007, vërtetuar me tri mandatpagesa (përfshirë edhe shumën 2.000 euro, për të cilën nuk ka një mandatpagesë). Sa i takon shumës 5.000 euro, është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit vërtetuar nga shoqëria ndërtuese, që është falur prej saj;

ii) 34.510 euro transferuar shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k pas marrjes së kredisë, me përshkrimin “Për blerje apartamenti nga Artan Hajredinaj”.

20.2.3. Pas verifikimeve nuk rezultoi konflikt interesi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe P. K. apo përfshirje të këtij të fundit në veprimtari të kimit të organizuar.

20.3. Sa i takon shpenzimeve për kryerje punimesh dhe mobilim, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se pasi ndërtuesi ndërpreu punimet në fazën e karabinasë, ai aplikoi për kredi rikonstruksion apartamenti (është fjala për kredinë 35.000 euro, disbursuar nga ABI Bank në datën 25.10.2007) dhe një kredi tjetër prej 5.000 marrë po në të njëjtën datë dhe nga e njëjta bankë për mobilim banese. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ndër të tjera ka përmendur se shpenzimet për arredim/mobilim apartamenti kanë qenë 13.000 euro, me burim kredinë e parë prej 35.000 euro, ndërsa shuma 5.000 euro, përfituar me kredinë e dytë marrë në po të njëjtën datë, sqaroi se ka shërbyer për blerje pajisjesh elektroshtëpiake.

20.3.1. Sikurse është trajtuar më sipër, duke qenë se shuma e disbursuar e kredisë prej 34.510 euro u transferua në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. për blerje apartamenti, kjo shumë u konsiderua si burim për përfundimin e punimeve nga ana e shoqërisë. Ndërsa shpenzimet për mobilimin, në përfundim të hetimit administrativ u konsideruan në vlerën 13.000 euro, të

kryera në fund të vitit 2007 (sipas deklarimeve të subjektit) me të ardhura të tij, pra jo me të ardhura të përfituara nga kredia bankare.

20.4. Në lidhje me çmimin e apartamentit krahasuar me çmimet e EKB-së, sipas udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e Tiranës është 79.615 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Në rastin konkret çmimi i referencës për apartamentin në objekt verifikimi rezulton 79.615 lekë/m² x 113.1 m², në total 9.004.457 lekë ose 72.793 euro sipas kursit zyrtar të vitit 2006. Pra, rezulton se apartamenti është blerë më lirë se çmimi i referencës nëse i referohemi çmimit të kontratës së datës 18.10.2006 në shumën 45.000 euro dhe pothuajse sa çmimi i referencës nëse i referohemi vlerës së investuar nga subjekti në total prej 74.510 euro.

20.4.1. Në parashtrimet e tij, sa i takon çmimit të apartamentit, subjekti sqaroi se konstatimi i Komisionit se sipas kontratës së sipërmarrjes apartamenti është blerë më lirë se çmimi i referencës së EKB-së prej 74.510 euro, nuk qëndron, pasi:

- sipas kontratës çmimi për apartamentin është përcaktuar në 400 euro/m², në total 45.000 euro dhe ky është çmimi real;
- shoqëria ndërtuese në të gjitha kontratat e porosive të ngjashme ka pasur të përcaktuar çmimin prej 400 euro/m², kështu, bazuar edhe në këto kontrata, çmimi i apartamentit të tij prej 45.000 euro është i saktë. Subjekti paraqiti 4 kontrata të lidhura nga shoqëria, dy të vitit 2011 me çmim 400 euro/m² dhe 409 euro/m², si dhe dy kontrata të vitit 2014 me çmim 405 euro/m² dhe 430 euro/m²;
- sipas subjektit çmimi i referencës së EKB-së nuk mund të shërbejë si indikator për shkak se pallati nuk ndodhet në qendër të Tiranës dhe as brenda unazës së kryeqytetit, por në Komunën ***, pra në një zonë jashtë qytetit, dhe për të cilat ndërtimet në atë kohë konsideroheshin larg qendrës urbane dhe zona tepër periferike, çka ndikonte në përcaktimin e çmimit mes palëve.

20.5. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë në DPFID, plotësuar më 19.3.2008, subjekti ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve apartamentin me sip. 113.1 m², me të ardhura: (i) kredi për blerje apartamenti marrë nga Banka Greke në datën 16.10.2007 në shumën 40.000 euro; (ii) nga aktiviteti privat noter; (iii) nga shitja e pasurisë nr. *** dhe pasurisë nr. *** me sip. 19.000 m² të ndodhura në ***, Tropojë. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim: (i) të ardhurat si noter në vitet 2001 – 2007; (ii) shitje toke bujqësore; (iii) kredi pranë NBG Bank.

Analizë specifike e secilit burim

20.6. Në lidhje me të ardhurat si noter në Tropojë në vitet 2001 – 2007, në DPFID, plotësuar më 19.3.2008 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 6.000.000 lekë. Për të provuar aktivitetin si noter, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur disa dokumente, në analizë të të cilave dhe pas verifikimeve edhe gjatë hetimit administrativ u evidentua se:

- QKB-ja ka konfirmuar se z. Artan Hajredinaj ka qenë i regjistruar si person fizik në datën 13.7.2001 si noter, ndërsa me vendimin e datës 26.3.2007 është vendosur çregjistrimi i aktivitetit.
- DPT-ja dhe DRT-ja Kukës konfirmojnë se z. Artan Hajredinaj figuron i regjistruar me NIPT ***, krijuar në datën 13.7.2001 dhe datë mbarimi 26.3.2007. DRT-ja ka përcjellë në ILDKPKI me *email* dosje nga arkivi për subjektin Artan Hajredinaj, sipas të cilave rezulton se gjatë periudhës 2001 – 2007 subjekti ka realizuar qarkullim prej 6.550.000 lekësh nga aktiviteti privat si noter, duke paguar detyrimet tatimore të taksës vendore dhe tatim-fitimin e thjeshtuar. Duke pasur në konsideratë llojin e aktivitetit, të ardhurat neto nga ky aktivitet për periudhën 13.7.2001 – 26.3.2007 deri në çregjistrimin e tij janë konsideruar në masën 80% të qarkullimit vjetor, në shumën 5.240.000 lekë. Kjo shumë është konsideruar e ardhur nga aktiviteti privat

si noter në analizën financiare për periudhën para fillimit të detyrës, gjatë së cilës është kryer pagesa e këstit të parë të apartamentit objekt verifikimi.

- Bashkia Tropojë konfirmon se për subjektin Artan Hajredinaj nuk ka të dhëna pasi në sistem kërkohet përditësimi i të dhënave për subjektin me NIPT ***. Ndërsa ISSH-ja ka konfirmuar pagesat e kontributeve/tatimeve mbi të ardhurat bruto personale të realizuara si i vetëpunësuar për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2005.

20.6.1. Në lidhje me burimin e të ardhura nga shitja e tokës bujqësore në DPF, plotësuar më 19.3.2008, subjekti ka deklaruar shitjen e pasurive nr. *** dhe *** me sip. 19.000 m², të ndodhura në ***, Tropojë, në vitin 2006, në shumën 12.392.800 lekë. Në lidhje me dy tokat bujqësore të shitura nga subjekti, nga aktet në dosje rezultoi se:

- Sa i takon pasurisë nr. ***, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje nr. ***/***, datë 8.6.2006, sipas së cilës z. Artan Hajredinaj i ka blerë shtetas H. S.pasurinë nr. ***, lloji vreshtë tokë, me sip. 12.117 m², në vlerën 1.000.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit A. V. me kontratë nr. ***/***, datë 9.10.2006, në vlerën 8.481.900 lekë.

- Sa i takon pasurisë nr. ***, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje nr. ***/***, datë 8.6.2006, sipas së cilës z. Artan Hajredinaj i ka blerë shtetas H. S.pasurinë nr. ***, lloji vreshtë me sip. 5.586,4 m², në vlerën 500.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit A. V. me kontratë nr. ***/***, datë 9.10.2006, në vlerën 3.910.900 lekë.

- ZVRPP/ASHK Tropojë ka konfirmuar se z. Artan Hajredinaj ka pasur pasuritë nr. *** dhe nr. ***, të cilat i ka shitur, duke përcjellë edhe kontratat, certifikatat e pronësive, si dhe kartelat e këtyre pasurive, ku figurojnë transaksionet si më sipër.

- Sipas informacionit të ASIG-ut, i cili ka përcjellë pamje imazherike të territorit në z. k. ***, nuk ka të dhëna për investime në objekte në të dyja tokat e shitura nga ana e subjektit.

20.6.2. Sa më sipër provohet se në datën 9.10.2006, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimi nuk ka qenë subjekt deklarues, ka përfituar shumën prej 12.392.800 lekësh nga shitja e dy pasurive të mësipërme. Duke qenë se pasuritë janë regjistruar në emër të blerësit, janë paguar edhe detyrimet tatimore. Por, për Komisionin mbetej e paqartë arsyeja se përse pasuria nr. *** është shitur rreth 8.5 herë më shtrenjtë ndërsa pasuria nr. *** është shitur 7.8 herë më shtrenjtë, vetëm pas 4 muajve nga blerja e tyre. Me kërkesë të Komisionit në lidhje me këtë fakt, subjekti ka dhënë përgjigje të pyetësorit nr. 2, ku ka sqaruar se kjo ka ndodhur gjatë kohës që ishte noter, profesion i cili i ka dhënë mundësinë për të marrë njohuri të mira për sa i përket tjetërsimit të pasurive. Me shtetasen H. S.kishin njohje familjare për shkak të origjinës nga i njëjti fshat, e cila donte t'i shiste patjetër këto pasuri për të krijuar të ardhura, duke mbajtur në konsideratë edhe moshën e saj 73 vjeç dhe faktin se ajo jetonte e vetme dhe pa fëmijë. Për çmimin e shitjes së tokave kanë rënë dakord për shumën prej 1.500.000 lekësh, shuma e cila ishte reale dhe e përafërt me çmimin e referencës, duke marrë përsipër vetë pagesat për regjistrimin dhe kalimin e pronësisë. Sipas tij, në momentin e fitimit të pronësisë ka kërkuar mundësinë e shitjes dhe shtetasi A. V., të cilin e njihte personalisht dhe kishte biznes import-eksport produktesh ushqimore ishte i interesuar për blerjen e një sipërfaqeje të madhe toke (truall) në qytetin e ***. Për këtë arsye ka rënë dakord me të që të shiste këto pasuri. Sipas subjektit, nga momenti i blerjes së këtyre pronave dhe deri në kohën kur ai i shiti, në qytetin e Bajram Currit filloi një interes nga biznesmenë të ndryshëm për të blerë prona dhe kjo ndikoi edhe në rritjen e çmimit të tyre. Sipas subjektit, çmimet e pronave në Bajram Curri ndryshojnë rast pas rasti, si dhe paraqiti kthim përgjigjen e Bashkisë Tropojë, e cila ka vënë në dispozicion kopje kontrate për shitjen e pasurisë së paluajtshme nga shitësi E. Gj.dhe blerës Bashkia Tropojë. Sipas kësaj kontrate të datës 14.9.2009, pasuria e llojit vreshtë me sip. 12.000 m² është

shitur në çmimin 3.624.000 lekë, sipas VKM-së nr. 514, datë 13.5.2009, me objekt shpronësimin për interes publik.

20.6.3. Pavarësisht deklarimeve të subjektit, nga Komisioni ka pasur dyshime se çmimi i blerjes dhe i shitjes së të dyja pasurive mund të ketë qene fiktiv dhe për rrjedhojë, shpenzimet e kryera nga subjekti për blerjen e pasurive nr. *** dhe *** në shumën prej 1.500.000 lekësh dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre në shumën totale prej 12.392.800 lekësh, deri në fazën e përfundimit të hetimit administrativ nuk janë përfshirë në analizën financiare.

20.6.4. Në lidhje me burimin kredi pranë NBG Bank, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore për dy kredi të marra nga kjo bankë. Gjatë hetimit ABI Bank ka konfirmuar se z. Artan Hajredinaj është financuar me një kredi hipotekore në shumën 35.000 euro me afat 20-vjeçar dhe një kredi konsumatore prej 5.000 euro me afat 5-vjeçar. Nëpërmjet ekstraktit të llogarisë bankare të kredisë në euro, evidentohet disbursimi i dy shumave prej 35.000 euro dhe 5.000 euro në datën 25.10.2007. Në DPFD-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 subjekti ka deklaruar kredinë si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë. Në vijim, në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar kredinë dhe shlyerjet e detyrimeve të kredisë sipas viteve përkatëse. Përputhet deklarimi i subjektit për sa i përket financimit me dy linja kredie në shumën 35.000 euro dhe 5.000 euro në datën 25.10.2007. Sikurse është trajtuar më sipër, kredia në shumën 35.000 euro është konsideruar e përdorur për të paguar vlerën 74.150 euro. Ndërsa kredia prej 5.000 euro është konsideruar e përdorur për mobilimin në periudhën nëntor – dhjetor 2007.

20.6.5. Në përfundim të hetimit, nga ana e Komisionit janë verifikuar mundësitë financiare të subjektit për pagesën e shumës 74.510 euro si investim për apartamentin në Tiranë në periudhën 18.10.2006 – 25.10.2007, duke konsideruar se: (i) kësti i parë prej 20.000 euro është paguar para fillimit të detyrës ndaj dhe analiza është bërë kumulative deri në datën 18.10.2006¹, që është data e pagesës së kështit të parë, duke përfshirë të ardhurat e dokumentuara dhe shpenzimet e njohura deri në atë datë; (ii) tri këstet e tjera prej 20.000 euro në total janë paguar pas fillimit të detyrës në periudhën 26.3.2007 – 22.8.2007; (iii) kësti i fundit prej 34.510 euro është paguar nëpërmjet kredisë 35.000 euro, marrë në NBG Bank në datën 25.10.2007. Në tabelën më poshtë është pasqyruar mundësia e pagimit të shumës 54.510 euro pas fillimit të detyrës.

Përshkrimi	26.3.2007 dhe 22.8.2007	25.10.2007
Pasuritë	2,481,400	4,217,467
Apartament 113.1 m ² , Tiranë, kontratë sipërmarrjeje nr. ***/***, datë 17.10.2007	2,481,400	4,217,467
Të ardhurat	-	4,277,350
Të ardhura nga kredia NBG, disb. 25.10.2007	-	4,277,350
Shpenzimet	-	-
Shpenzime komision disbursimi kredie NBG	-	59,883
Mundësia për kursime	- 2,481,400	0

20.7. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi apartament me sipërfaqe 113.1 m² në Tiranë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: (i) subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit për shkak të balancës negative prej 1.815.767 lekësh para detyrës dhe 2.481.400 lekësh gjatë detyrës; (ii) subjekti ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat e pasurisë ndër vite, në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ, në lidhje me çmimin e apartamentit dhe burimin e të ardhurave; (iii) ka dyshime

¹ Analiza financiare për mundësinë e pagesës së kështit të parë të apartamentit me sip. 113.5 m², Tiranë, paraqitur në tabelën përmbljedhëse të analizës financiare para fillimit të detyrës, në fund të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë.

të arsyeshme për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. *** dhe ***, të ardhurat e të cilave janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20.8. Sa i takon konstatimit në lidhje me deklaratimet e pasakta të çmimit të apartamentit dhe burimit të krijimit, subjekti pretendon se:

20.8.1. Sipas tij nuk ka asnjë mospërputhje dhe pasaktësi në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë pasi deklaratimet ndër vite i referohen në mënyra të ndryshme të njëjtimit rezultat. Paqartësitë në deklarime kanë qenë sipas tij për shkak se njohja e legjislacionit për deklaratimet nuk ka qenë si në kohën e aktuale, por transaksionet kanë qenë të vërteta dhe nuk ka pasur qëllim të bëjë deklaratimet të pasakta. Sipas subjektit, në DPFD ai e ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes të vitit 2006 për blerjen e apartamentit në vlerën 70.000 euro, paguar deri në datën 31.12.2007 vlera 65.000 euro, ndërsa vlera 70.000 euro ka nënkuptuar vlerën totale të investimit, përfshirë atë të punimeve dhe mobilimit. Këtë vlerë nuk e ka ndarë sipas llojit të pagesave të kryera dhe kjo mund të konsiderohet një pakujdesi e paqëllimtë e tij, por kurrësi që të identifikojë një fakt ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit. Sipas tij në deklaratën *Vetting*, qëllimi i së cilës ka qenë deklarimi i çdo pasurie dhe korrigjimi i çdo mangësie të mundshme të deklaratave vjetore, ka deklaruar se kjo pasuri është blerë 45.000 euro dhe 30.000 euro janë shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore.

20.8.2. Sa i takon kredisë së marrë pranë NBG Bank në vlerën 35.000 euro, subjekti pretendon se siç ka deklaruar në deklaratën *Vetting* ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, kjo është përdorur për rikonstruksion banese nga ana e tij, duke theksuar se edhe në kontratën e kredisë qëllimi i saj ka qenë i dyfishtë, për blerje ose rikonstruksion të pasurisë. Në lidhje me këtë kredi për të cilën në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se në momentin e disbursimit, në datën 25.10.2007, është tërhequr prej tij, subjekti parashtron se vetëm pas analizimit të dokumentacionit që iu vu në dispozicion pas rezultateve të hetimit administrativ ka konstatuar se shuma e disbursuar e kredisë ka shkuar me transfertë bankare në llogari të ndërtuesit, fakt që e kishte të harruar edhe për shkak të kohës së gjatë të kaluar (18 vite). Ajo që kujton mirë është se këtë shumë e ka pasur *cash* dhe prandaj është shprehur se kjo shumë është tërhequr *cash* prej tij, duke argumentuar se me aprovimin e kredisë prej 35.000 euro, NBG Bank i vuri kusht që paratë duhej të kalonin tek shoqëria ndërtuese dhe e gjithë shuma është pasi tërhequr *cash* nga administratori i firmës, z. P. K., në të njëjtën ditë i është dhënë subjektit në *cash* të cilat i përdori për përfundimin e punimeve.

20.8.3. Si përfundim në lidhje me çmimin e apartamentit, subjekti parashtron se investimi total për apartamentin është 74.510 euro, sikurse ka konkluduar edhe Komisioni, nga të cilat shuma prej 40.000 euro u pagua tek shoqëria ndërtuese sipas mandatpagesave të administruara nga Komisioni dhe pjesa tjetër e marrë kredi u shpenzua për ta përfunduar vetë atë çka shoqëria e ndërtimit nuk arriti të përfundojë në kohë, si dhe për ta kompletuar apartamentin. Mbi këtë shumë (74.510 euro) është shpenzuar edhe shuma 5.000 euro, e cila është mbuluar me kredi konsumatore nga NBG Bank për blerje pajisjesh eletroshtëpiake. Subjekti kërkon që shuma prej 13.000 euro konsideruar për shpenzime mobilimi nga Komisioni të hiqet si shpenzim më vete i tij në analizën e vitit 2007 dhe të përfshihet në shumën 34.510 euro të marrë me kredi e cila është shpenzuar për përfundimin dhe mobilimin e apartamentit.

20.8.4. Sa i takon burimit të krijimit, në parashtrimet e tij në thelb subjekti pretendon se ka bërë deklarime të sakta dhe si burim kanë shërbyer të ardhurat nga noteria, të ardhurat nga shitja e dy tokave me nr. *** dhe ***, si dhe kredia që ka shërbyer për rikonstruksion e mobilim. Sipas tij, viti 2008 ishte viti i parë i deklaratimit dhe ka pasur një moskuptim të drejtë të ligjit, në kushtet kur nuk ka pasur një udhëzues konkret dhe të saktë ligjor lidhur me mënyrën e deklaratimit të pasurive. Ndërkohë që në deklaratën *Vetting*, qëllimi i së cilës ka qenë deklarimi i çdo pasurie dhe korrigjimi i çdo mangësie të mundshme të deklaratave vjetore, kjo pasuri

është deklaruar e blerë 45.000 euro dhe 30.000 euro, shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, duke përcaktuar të njëjtin burim sikundër është deklaruar në vitin 2008. Pra, burimi i krijimit të kësaj pasurie, sikundër edhe çmimi i përcaktuar për blerjen, nuk kanë ndryshuar në asnjë prej deklaramëve të tij. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2008 është bërë një përshkrim në mënyrë më sintetike dhe koncize lidhur me pasurinë, duke nënkuptuar vlerën totale të shumës së shpenzuar mbi këtë pasuri, ndërsa në deklaratën *Vetting*, edhe pas njohjes më të mirë të procesit të legjislacionit të deklarimit të pasurive, përshkrimi është bërë në mënyrë më të saktë lidhur me ndarjen e vlerës së investuar mbi këtë pasuri.

20.8.5. Pas pyetjes në lidhje me mosdeklarimin e ndonjë gjendjeje likuiditeti në *cash* në DPDFD në seancën dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit ka deklaruar se është e vërtetë që ka një pasaktësi me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* në këtë deklaratë, por të ardhurat nga shitja e dy pasurive kanë qenë në fakt gjendje *cash* në momentin kur subjekti i rivlerësimit është emëruar për herë të parë në detyrë, në datën 20.3.2007, ndërkohë që këto të ardhura janë transformuar në pasuri të paluajtshme brenda këtij viti. Sipas saj, është e pamundur me logjikë njerëzore, qytetare e profesionale që këto të ardhura të jenë shpenzuar për një periudhë shumë të shkurtër kohore (pra nga muaji tetor 2006 kur janë shitur pasuritë deri në ditën e fillimit të detyrës datë 20.3.2007). Pra, sipas përfaqësueses, pasaktësia e mosdeklarimit të gjendjes *cash* në datën e fillimit të detyrës 20.3.2007 në DPDFD (që mban datën 19.3.2008) vjen për faktin se të ardhurat nga shitja e dy pasurive ishin shpenzuar deri në fund të vitit 2007 dhe mënyra se si është bërë ky deklarim apo veprimet e datat respektive lënë të kuptohet që ky është një deklarim i atij viti (pra deklarim periodik për vitin 2007) dhe jo një deklarim i gjendjes *cash* përpara fillimit të detyrës.

20.9. Sa i takon dyshimeve për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. *** dhe ***, subjekti parashtron se blerja e këtyre pasurive nga shtetasja H. S. është bërë në përputhje me Kodin Civil dhe vullnetin e palëve me anë të kontratave që kanë fuqinë e ligjit si dhe, nëse shitësja do të kishte pasur ndonjë pendesë në lidhje me çmimin e përcaktuar, do të kishte iniciuar ndonjë proces gjyqësor civil. Subjekti paraqiti vërtetim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ku nuk rezulton që kjo palë (H. S.) të këtë hapur ndonjë proces gjyqësor kundër subjektit deri në momentin e ndërrimit të jetës së saj në vitin 2014. Subjekti dha të njëjtat sqarime me ato gjatë procesit në lidhje me origjinën e këtyre pronave dhe vullnetin e palës shitëse. Sipas tij, për të ardhurat e përfituara nga shitja e tokave është paguar tatimi në burim, pasi këto pasuri janë regjistruar në emër të blerësit A. V., çka i bën këto të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

20.9.1. Subjekti i referohet dhe nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku thuhet shprehimisht se: *“...4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”*. Sipas tij, nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se çdo provë vlerësohet në unitet me provat e tjera, që do të thotë se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundërt nuk do të kishim çmuarje të provave. Për rrjedhojë, të gjitha provat e vëna në dispozicion të Komisionit duhet të çmohen në unitet me provat e tjera në tërësi.

20.9.2. Lidhur me referimin e Komisionit për çmimin prej 1.000.000 lekësh të përcaktuar si çmim blerjeje për tokën bujqësore me sipërfaqe 2.463 m² (ose 406 lekë/m²), subjekti parashtron se kjo pasuri vërtet është blerë më shtrenjtë se pasuritë nr. *** dhe ***, por sikundër rezulton dhe nga fotografimet ajrore bashkëlidhur ajo gjendet në zemër të qytetit të Bajram Currit, brenda unazës së qytetit dhe ka pozicion më të favorshëm sesa pasuritë nr. *** dhe ***.

20.9.3. Sa i takon çmimit të shitjes të të dyja pasurive, parashtron se janë shitur me çmimin e tregut dhe sipas dakordësisë së plotë mes palëve, duke shpjeguar se shtetasi A. V. ishte biznesmen shumë i suksesshëm në atë kohë duke zotëruar një aktivitet tregtar me emrin “****” sh.p.k., ndër më të njohurit në Bajram Curri dhe planifikonte të zgjeronte biznesin e tij, duke

investuar në përpunimin e gështenjave, projekt ky i cili në atë kohë ishte shumë inovator. Për të mbështetur këtë pretendim subjekti ka paraqitur: dy deklarata noteriale të vitit 2024 të bashkëshortes dhe djalit të shtetasit A. V. të pohojnë deklaratimet e subjektit; kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 22.2.2024, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, bashkëngjitur edhe vendimi për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “****” sh.p.k.; certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, sipas të cilave duket se shtetasi A. V. ka ushtruar aktivitet privat.

20.9.4. Për të provuar se çmimi i shitjes së pasurive është real, subjekti ka paraqitur disa dokumente, si:

- Shkresë datë 16.2.2024 nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, sipas së cilës zona ku shtrihen këto pasuri ndodhen në zona periferike të qytetit të Bajram Currit, z. k. *** dhe në bazë të planit të përgjithshëm vendor të miratuar me vendim të KKT-së lejohet realizimi i ndërtimeve për aktivitete ndihmëse bujqësore dhe në rast aplikimi për leje ndërtimi, kjo tokë kthehet në tokë truall;

- Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2024, e Sektorit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-së, lidhur me kategorinë e këtyre pasurive, sipas së cilës tokat futen në kategorinë IV, ndërsa në lidhje me çmimin dhe vlerën e tokës për vitet 2005 – 2009 nuk kemi informacion;

- Raport vlerësimi nga ing.gjeo. SVP. R. D., ku ekspertja ka përdorur 3 mënyra për vlerësimin e çmimit të shitjes së tokës, konkretisht:

a) Sipas metodës së çmimeve referuese sipas legjislacionit në fuqi dhe konkretisht vendimi nr. 1620, datë 26.11.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna” çmimi i shitjes së tokës truall në qytetin e Bajram Currit varion nga 1.500 lekë/m² deri në 2.500 lekë/m². Ekspertja ka pranuar si çmim të shitjes vlerën më të vogël, pra 1.500 lekë/m² në vitin 2008, meqenëse edhe prona objekt vlerësimi ndodhet në periferi të qytetit të Bajram Currit, si dhe e ka indeksuar këtë çmim me inflacionin mesatar vjetor, nga ku ka rezultuar se vlera e tregut për shitjen e tokave në vitin 2006 ka qenë 883.68 lekë/m². Sipas kësaj metodologjie vlera e pasurive objekt vlerësimi në vitin 2006 ka qenë 15.644.140 lekë.

b) Sipas metodës së shitjeve krahasuese përcaktohet “vlera” nëpërmjet analizës së shitjeve të kaluara të pronave krahasuese, ku ekspertja i referohet dy kontratave të shitblerjes të viteve 2002 dhe 2003 dhe çmimin e rezultuar e ka indeksuar me inflacionin mesatar vjetor deri në vitin 2006, ku çmimi i shitjes së parcelave tokë arë varion nga 587,12 lekë/m² në 1.765,07 lekë, ose mesatarisht 1.176,1 lekë/m². Në bazë të këtij çmimi vlera e pasurive objekt vlerësimi në vitin 2006 ka qenë 20.820.912,21 lekë. Subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje toke bujqësore me sip. 1.500 m² me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2002, në çmimin 500 lekë/m², si dhe kontratë shitblerjeje toke bujqësore me sip. 2.951 me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2003, në çmimin 273 lekë/m².

c) Sipas mënyrës së dokumentacionit të shpronësimit të realizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Energjetikes, ku në vitin 2008 çmimi i shpronësimit për njësi të sipërfaqes rezulton 4.526 lekë/m². Duke bërë indeksimin e këtij çmimi në vitin 2008 me inflacionin mesatar vjetor rezulton se çmimi për metër katror është 2.666,35 lekë dhe vlera e pasurive objekt vlerësimi në vitin 2006 ka qenë 47.363.441,59 lekë.

20.10. Në lidhje me konstatimin se nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit për shkak të balancës negative prej 1.815.767 lekësh para detyrës dhe 2.481.400 lekë gjatë detyrës, subjekti e kundërshton këtë konstatim duke parashtruar se sipas analizës financiare të paraqitur prej tij, ka rezultuar se ka pasur fonde të mjaftueshme nga të ardhura të ligjshme për të paguar këstet në shumën totale prej 40.000 euro në datat përkatëse. Sa i takon mundësisë për pagesën e këstit 10.000 euro në datën 26.3.2007, pra vetëm 6 ditë pas emërimit në detyrë dhe këstit tjetër 10.000 euro në datën 22.8.2007 ose 4 muaj pas fillimit të detyrës, subjekti pretendon se ato janë paguar me burimet të cilat i ka deklaruar në deklaratën *Vetting*. Për shkak të një kohe shumë të afërt nga emërimi në detyrë, të ardhurat për pagesën 20.000

euro nuk mund të krijoheshin nga data 20.3.2007 deri në 26 mars dhe 22 gusht të po këtij viti. Këto burime vijnë nga akumulimi i kursimeve gjatë viteve të mëparshme nga puna si noter nga viti 2001 deri në fund shkurtit 2007 dhe nga shitja e tokave vreshtë në Bajram Curri. Sipas tij, ai është përpjekur që të konkludojë çdo veprim financiar brenda vitit 2007 për shkak të akumulimit të një pasurie e cila i kishte përmbushur objektivat e tij financiare, pra para emërimit në detyrë, pas të cilit nuk do kishte më as kohë dhe as mundësi të merrej me menaxhimin e pronave.

Vlerësimi i Komisionit

20.11. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura vërehet se subjekti ka vërtetuar bindshëm të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, arsyetuar si vijon:

20.11.1. Sa i takon paqartësive dhe pasaktësive të evidentuara në mënyrën e deklarimit të çmimit të pasurisë së blerë, në analizë të parashtrimeve të subjektit në raport me të gjitha deklaratimet në deklaratat e paraqitura pranë ILDKPKI-së dhe ato gjatë hetimit, në përfundim të procesit vlerësohet se pasaktësitë dhe mospërputhjet e evidentuara nuk janë kryer me ndonjë qëllim të caktuar dhe si të tilla nuk kanë ndonjë peshë specifike, për sa kohë subjekti:

i) Në DPFD-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 dhe atë të dorëzuar në datën 27.10.2014 e ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes të vitit 2006 për blerjen e apartamentit në vlerën 70.000 euro, vlerë e përafërt me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

ii) Vlera totale e vërtetuar gjatë hetimit e investimit prej 74.510 euro është pothuajse e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* prej 75.000 euro në të cilën ka specifikuar se pasuria është *blerë në shumën 45.000 euro dhe 30.000 euro shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, nga të ardhurat si noter vitet 2001 – 2007, shitje toke bujqësore, kredi pranë NBG Bank. Vlera: 75.000 euro.*

iii) Deklarimi i shumës 45.000 euro në deklaratën *Vetting* është bërë referuar çmimit të shitjes në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2007, aq sa është çmimi i shitjes së pasurive në kontrata të tjera të ngjashme sipërmarrjeje që subjekti paraqiti. Edhe përfaqësuesi i shoqërisë nuk rezultoi të ketë kontestuar çmimin prej 45.000 euro të kontratës së sipërmarrjes, përkundrazi me deklaratën noteriale datë 11.9.2023 ka konfirmuar deklaratimet e subjektit.

iv) Pretendimi i përsëritur se kredia nga NBG Bank në vlerën 35.000 euro është përdorur nga vetë subjekti për përfundimin e punimeve dhe arredim, sikurse përmendet edhe në deklaratën *Vetting*, vlerësohet i bazuar në analizë logjike e harmonike të të gjitha rrethanave dhe argumenteve që subjekti paraqiti. Për më tepër, në kontratën e kredisë qëllimi i saj është i dyfishtë për blerje dhe rikonstrukcion të pasurisë dhe në kushtet kur likuidimi i çmimit të blerjes sipas kontratës së vitit 2007 ishte kryer përpara se të merrej kredia në datën 25.10.2007, është logjike që kredia të jetë përdorur për investimet për përfundimin e punimeve përfshirë edhe arredimin. Në këto kushte, Komisioni nuk vlerëson me ndonjë peshë specifike faktin nëse punimet për përfundimin e punimeve janë kryer nga subjekti apo nga shoqëria ndërtimore, duke i dhënë peshë faktit se kredia prej 35.000 euro është përdorur për përfundimin e punimeve dhe mobilim.

20.11.2. Sa i takon dyshimeve të ngritura për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. *** dhe ***, nga ana e Komisionit çmohet se për të arritur në një konkluzion mbi besueshmërinë e tyre duhen vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën koha, rrethanat, faktet dhe provat e administruara, që në tërësi përputhen me deklaratimet e subjektit. Konkretisht:

i) Nga ana formale ligjore nuk rezultoi asnjë problematikë sa i përket origjinës së këtyre pronave, blerjeve/shitjeve apo regjistrimeve të tyre të konfirmuara zyrtarisht nga ZVRPP/ASHK Tropojë, si dhe nuk rezultoi që palët të kenë pasur pretendime ndaj subjektit.

ii) Sa i takon faktit që subjekti i ka blerë pasuritë disa herë më lirë se një tokë me sipërfaqe 2.463 m² të blerë në vitin 2003 në çmimin 406 lekë/m², argumenti i subjektit se ky fakt ka të

bëjë me pozicionim, vlerësohet i bazuar edhe duke u nisur nga fakti që po kjo pasuri në vitin 2004 është shitur me çmim prej 1.421 lekë/m², pra sa dyfishi i shitjes së pasurive nr. *** dhe *** në vitin 2006, me një çmim prej 700 lekë/m².

iii) Subjekti provoi se pala blerëse e këtyre pasurive ka ushtruar aktivitet tregtar dhe ky fakt së bashku me dokumentet e paraqitura në parashtime të çon në një deduksion se është e logjikshme që blerja e këtyre tokave të jetë kryer për qëllim investimi. Sa i takon konkluzioneve në raportin e vlerësimit të pasurive nr. *** dhe ***, ku ekspertja ka nxjerrë vlera të ndryshme dhe më të larta se ato të shitjes nga subjekti, nga ana e Komisionit nuk vlerësohen si kategorike, por vlerësohet që raporti përmban elemente që pasqyrojnë vlera të mundshme për kohën.

iv) Një element thelbësor është se në analizë të të gjitha të dhënave, dokumenteve dhe deklarimeve të subjektit, blerja dhe shitja e pasurive nr. *** dhe *** nuk mund të shihen si rast i vetëm dhe i shkëputur jashtë kontekstit kohor dhe sjelljes së subjektit para fillimit të detyrës, pasi siç u vërtetua subjekti në disa raste ka blerë pasuri të paluajtshme dhe më pas i ka shitur më shtrenjtë (trajtuar në vijim), konkretisht: (a) në vitin 2003 ka blerë pasurinë nr. ***/***/*** e llojit tokë arë në shumën 1.000.000 lekë dhe e ka shitur në vitin 2004 në shumën 3.500.000 lekë; (b) në vitin 2003 ka blerë pasurinë nr. *** të llojit apartament në shumën 700.000 lekë dhe e ka shitur në vitin 2007 në shumën 2.000.000 lekë; (c) në vitin 2005 ka blerë pasurinë nr. *** të llojit apartament në shumën 500.000 lekë dhe e ka shitur në vitin 2011 në shumën 1.500.000 lekë; (ç) në vitin 2002 ka blerë pasurinë nr. *** të llojit apartament në shumën 800.000 lekë dhe e ka shitur në vitin 2007 në shumën 1.300.000 lekë. Këto katër raste (secili në veçantinë e vet), për të cilat nuk janë ngritur dyshime, konsiderohen se mjaftueshëm përbëjnë premisat për të arritur në konkluzionin se subjekti ndodhet në të njëjtën situatë edhe në rastin e blerjes/shitjeve të pasurive nr. *** dhe ***.

v) Në kohën kur këto pasuri janë blerë dhe janë shitur, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues dhe as në funksion gjyqtar, rrethanë kjo e cila në vetvete nuk motivonte subjektin nga ana subjektive të kryente veprime përtej qëllimit të përfitimit të të ardhurave nga shitja e tyre sipas përmbajtjes së kontratave përkatëse.

vi) Të ardhurat nga shitja e pasurive nr. *** dhe *** janë deklaruar në mënyrë konsistente nga subjekti si burim për apartamentin objekt vlerësimi për të cilin pagesat kishin filluar disa muaj para detyrës dhe i ka përfunduar disa muaj pas fillimit të detyrës.

20.11.3. Në përfundim të procesit, përtej dyshimeve të ngritura gjatë hetimit administrativ, bazuar në një analizë ligjore e logjike të fakteve të sipërpërmendura, Komisioni vlerësoi se nuk mund të konkludohet për veprime fiktive të blerjes dhe shitjes së pasurive nr. *** dhe *** në periudhën kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues dhe as në detyrën e gjyqtarit dhe se çmimi i blerjes/shitjes pasqyruar në kontratat përkatëse është shprehje e vullnetit të lirë të palëve bazuar në rrethanat dhe periudhën kur janë kryer veprimet juridike. Për pasojë, të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre të deklaruara nga subjekti në mënyrë koherente si në deklaratat e interesave privatë ashtu dhe në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e apartamentit, duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kohën e përfitimit të tyre, duke i përfshirë ato në analizën financiare të rishikuar.

20.12. Sa i përket kundërshtimit të balancës negative prej 1.815.767 lekësh për periudhën para detyrës dhe 2.481.400 lekë gjatë detyrës, pretendimet e subjektit vlerësohen të bazuara, për sa kohë analiza afektohej më së shumti nga të ardhurat nga shitja e pasurive nr. *** dhe *** të cilat u konsideruan të ligjshme. Për pasojë, balanca negative e periudhës para detyrës bie ndërsa sa i takon balancës negative pas fillimit të detyrës, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në DPFD në datën 19.3.2008, nuk mund të konkludohet se të ardhurat nga shitja e pasurive nr. *** dhe *** në tetor të vitit 2006, nuk kanë shërbyer si burim për pagesën e kësteve prej 10.000 euro 6 ditë pas fillimit të detyrës, në datën 26.3.2007 dhe 10.000 euro 4 muaj më pas, në datën 22.8.2007. Ka qenë pikërisht shpenzimi brenda vitit 2007 i të ardhurave të përfituara nga shitja e pasurive nr. *** dhe *** shkak që nuk janë deklaruar

likuiditete *cash* në DPFĐ që mban datën 19.3.2008, e cila ka qenë edhe deklarata e parë e interesave privatë plotësuar nga subjekti. Për më tepër, të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive nuk janë pretenduar/deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër pas vitit 2007, e për pasojë nuk janë konsideruar në analizën finale financiare si burim për krijimin e ndonjë pasurie pas këtij viti. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se edhe në vitin 2014 kur subjekti ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së një deklaratë tjetër para fillimit të detyrës (me qëllim qartësimin e deklaramit të datës 19.3.2008), subjekti nuk është “kujdesur” që të deklaronte likuiditete *cash*, gjë që tregon se i është referuar pikërisht faktit që në mars të vitit 2008 nuk e ka pasur më likuiditetin *cash* të përfituar nga shitja e dy pasurive, pasi ato kanë qenë të shpenzuara brenda vitit 2007.

20.12.1. Veç sa më sipër, për një vlerësim sa më objektiv Komisioni mban në konsideratë se periudha e pagesave për pasurinë objekt vlerësimi është një periudhë tranzicioni e kalimit nga ushtrimi i aktivitetit si noter në detyrën e gjyqtarit dhe pretendimet e subjektit në lidhje me paqartësinë në deklarime në atë periudhë vlerësohen të besueshme.

20.12.2. Në këto kushte, duke konsideruar si të ardhura të ligjshme nga periudhat e kaluara shumë prej 2.077.302 lekësh (ku bëjnë pjesë edhe të ardhurat nga shitja e dy tokave vreshtë) e cila rezultoi si mundësi kursimi deri më 20.3.2007, këto të ardhura janë vlerësuar se kanë shërbyer për pagesën e kësteve prej 2.481.400 lekësh të paguara pas fillimit të detyrës dhe në analizën e rishikuar financiare për pagesën e kësteve, balanca negative ulet në vlerën 414.098 lekë.

20.13. Sa i takon shpenzimeve për mobilim, referuar deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* ku ka deklaruar se shuma 30.000 euro është shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore me burim kredinë e marrë nga NBG Bank, i cili është në koherencë të plotë me deklaramet në përgjigje të pyetësorit standard dhe me të gjitha faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, në përfundim të procesit Komisioni e vlerëson tërësisht të besueshëm pretendimin se shuma 13.000 euro për arredim/mobilim është pjesë e shumës 34.150 euro përfituar me kredi e cila është shpenzuar nga ana e subjektit për përfundimin e punimeve dhe mobilim e apartamentit. Në këto kushte, në analizën e rishikuar Komisioni ka hequr nga zëri i shpenzimeve për vitin 2007 shumë 13.000 euro.

20.13.1. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se subjekti ka kundërshtuar bindshëm barrën e provës në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi apartament banimi me sip. 113.1 m², në ***, Tiranë, duke kaluar kështu testin e rivlerësimit për këtë pasuri.

21. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar llogaritë bankare si më poshtë:

- Llogari nr. ***, Raiffeisen Bank (aktive). Vlera: 4 GBP. Zotërimi: 100%;
- Llogari nr. ***-Eur, Raiffeisen Bank (aktive). Vlera: 284 euro. Zotërimi: 100%;
- Llogari nr. ***-USD, Raiffeisen Bank (aktive). Vlera: 80.055 USD. Zotërimi: 100%²;
- Llogari nr. ***-ALL, Raiffeisen Bank (aktive). Vlera: 0 (zero) lekë. Zotërimi: 100%,

për të cilat ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Pas verifikimeve nuk u konstatuan problematika në lidhje këto llogari bankare.

22. Gjendje *cash* në banesë. Vlera: 10.000 euro. Zotërimi: 50%. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat familjare. Nga ana e Komisionit janë kryer disa verifikime në lidhje me gjendjen e likuiditetit *cash* të deklaruar ndër vite dhe në përfundim të hetimit rezultoi se gjendja *cash* e mbartur deri në fund të vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* në shumë 10.000 euro është pasuri me të ardhura të ligjshme.

² Nga veprimet bankare konstatohet se gjendja në llogari ka si burim të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme të deklaruara në vitin 2016.

23. Anëtar i familjes bujqësore që ka në pronësi pasuritë nr. ***, sip. 14.000 m², nr. ***, sip. 300 m², nr. ***, sip. 2600 m², nr. ***, sip. 1.700 m², nr. ***, sip. 3.850 m², z. k. 1062, Tropojë, të fituara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. E pandarë. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

23.1. Nga ana e Komisionit u kryen disa verifikime të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të këtyre pasurive dhe nga aktet e administruara nuk u konstatuan problematika për këto pasuri të cilat u vërtetua të jenë përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.

24. Bashkëmbajtës i llogarisë nr. ***-Euro, NBG Bank Albania, me vëllain B. U. H. (aktive). (Bashkëmbajtës llogarie përfaqësues me prokurë). Vlera 0 (zero) euro. Zotërimi: 0%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

24.1. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. 8, datë 23.1.2017, nga NBG Bank ku vërtetohet se shtetasi B. H. është klient me nr. llogarie ***, në të cilën janë bërë dy depozitime në datën 2.8.2007 në shumën 14.000 euro dhe në datën 16.8.2007 në shumën 31.000 euro. Në datën 17.8.2007 është tërhequr shuma 45.000 euro. NBG Bank konfirmon se subjekti është bashkëmbajtës i llogarisë së kursimit në monedhën euro me shtetasin B. H. dhe gjendja e llogarisë në datën 28.1.2017 është 4.02 euro. Siç vërehet, ka një mospërputhje të balancës së llogarisë të deklaruar nga subjekti (0 euro) me të dhënat bankare (4.02 euro). Duke qenë së balanca e kësaj llogarie është e ulët, duket të jetë lapsus nga ana e subjektit deklarimi i saj prej 0 (zero) euro në deklaratën *Vetting*.

25. Automjet tip “Volkswagen Passat”, nr. shasie ***, me targë ***. Blerë me kontratën nr. ***, datë 29.7.2016. Vlera: 820.000 lekë. Zotërimi: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

25.1. Në lidhje me këtë mjet nga aktet në dosje u verifikua mënyra, origjina si dhe përfitimi i pronësisë së subjektit sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.7.2016, në vlerën 820.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Ky mjet është regjistruar në pronësi të subjektit sipas certifikatës së pronësisë datë 6.9.2016 dhe është shitur në vitin 2018 në shumën 600.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar blerjen e këtij mjeti në vlerën 820.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Gjatë hetimit u vërtetua që mjeti të jetë blerë me burime të ligjshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të mjetit në vlerën 820.000 lekë.

25.2. Në parashtrimet e tij subjekti deklaroi të njëjtat burime si në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Lidhur me mosdeklarimin e burimit sqaroi se ky është një gabim njerëzor, duke menduar se me deklarimin e të gjitha transaksioneve bankare të kryera dhe duke bashkëlidhur kontratat e shitblerjeve ka ezauruar deklarimin e të gjitha të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, por edhe pasurive të tjera. Sipas tij, pasaktësia në rastin konkret duhet vlerësuar si e paqëllimtë dhe që nuk ka të bëjë me asnjë aspekt të fshehjes apo deklarimit të rremë ose të pasaktë, pasi nuk ka pasur asnjë arsye, për sa kohë ka përdorur pikërisht këto të ardhura të deklaruar dhe se nuk mund të sjellin penalizimin e subjektit. Në lidhje me këtë qëndrim, subjekti sjell në vëmendje edhe disa vendime të Kolegjit nr. 37/2021, nr. 33/2021 dhe nr. 20/2022.

25.3. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, ashtu siç edhe vetë ai e pranon, pasaktësia për mosdeklarimin e burimit qëndron, por nisur fakti që subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme si dhe referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit, Komisioni vlerëson se pasaktësia e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme nuk mund të konsiderohet si shkak që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

26. Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur V. H. , e cila në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri

veçmas në emrin e saj, duke deklaruar *llogari rrjedhëse në RFZ Bank, nr. ***ALL, vlera 62.500 lekë*. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Pas verifikimeve të kryera nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

DETYRIMET FINANCIARE

27. *Kredi e marrë në Bankën Greke në datën 25.10.2007, në shumën 5.000 euro, e cila është mbyllur në datën 1.11.2012. Kredi e marrë në Bankën Greke në datën 25.10.2007, në shumën 35.000 euro, me afat maturimi 20 vite deri në datën 25.10.2027, kredia ka interes 5.5%, kësti aktual 240 euro, shuma e ngelur deri në datën 23.1.2017 është 23.381 euro.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Kjo kredi është trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i të dhënave bankare subjekti është i saktë në deklarimin e detyrimit financiar të mbetur.

28. *Kredi e marrë në datën 5.5.2003 pranë ish-Fondit të Financimit të Zonave Malore, dega Tropojë sot Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, dega Tropojë, në shumën 1.000.000 lekë e cila është mbyllur në datën 27.5.2006, ku afati ka qenë 3 vjet dhe interesi 15%, ku në përfundim janë paguar 1.247.952 lekë nga këto 247.952 lekë interesa, detyrimi 0 lekë.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Subjekti ka paraqitur vërtetimin datë 12.10.2016 nga FAF, ku vërtetohet se z. Artan Hajredinaj ka përfituar kredi në datën 5.5.2003 në shumën 1.000.000 lekë dhe e ka mbyllur në datën 27.5.2006, duke paguar gjithsej 1.247.952 lekë.

28.1. Shoqëria “Agrokredit” sh.a., institucioni financiar që ka përthithur FFZM-në, konfirmon se subjekti është financuar me një kredi në shumën 1.000.000 lekë sipas kontratës se huas nr. ***, datë 7.5.2003, me afat 36-mujor, me objekt “Ngritje vreshti”³. Përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me huan 1.000.000 lekë me të dhënat e dërguara në shkresën e shoqërisë “Agrokredit” sh.a. Në analizën financiare të vitit 2003 kjo kredi është konsideruar e shpenzuar në përputhje me objektin e kontratës së kredisë (pasqyruar në analizën financiare).

29. *Kredi e marrë në datën 2.8.2006, pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, dega Tropojë, sot Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, e cila është mbyllur në datën 7.9.2007, ku afati ka qenë 3 vjet dhe interesi 15%, ku në përfundim janë paguar 3.269.019 lekë nga këto 269.019 lekë interesa.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Subjekti ka paraqitur vërtetimin datë 12.10.2016 nga FAF, ku vërtetohet se z. Artan Hajredinaj ka përfituar kredi në datën 2.8.2006 në shumën 3.000.000 lekë dhe e ka mbyllur në datën 7.9.2007, duke paguar gjithsej 3.269.019 lekë.

29.1. Agrokredit sh.a., institucioni financiar që ka përthithur FFZM-në, konfirmon se subjekti është financuar me një kredi në shumën 3.000.000 lekë sipas kontratës se huas nr. ***, datë 2.8.2006, me afat 36-mujor, me objekt “Rikonstruksion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”. Përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me huan 3.000.000 lekë me të dhënat e dërguara në shkresën e Agrokredit sh.a. Në analizën financiare të vitit 2006 kjo kredi është konsideruar e shpenzuar në përputhje me objektin e kontratës së kredisë.

29.2. Nisur nga vërtetimi i FAF-së, kredia e marrë në datën 2.8.2006 me afat 3-vjeçar është mbyllur në datën 7.9.2007, pra para afatit. Gjatë kësaj periudhe, subjekti ka qenë në detyrë që prej datës 20.3.2007. Shlyerja e kësaj kredie dhe burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e saj nuk janë deklaruar në DPDFD-në e dorëzuar më 19.3.2008 apo në DPV-në për vitin 2007 depozituar në ILDKPKI në datën 27.10.2014.

29.3. Në shkresën kthim përgjigjeje të Agrokredit sh.a. (ish-FAF) në dosjen e Komisionit, në lidhje me pagesat e kryera nga subjekti për shlyerjen e kredisë, citohet se nuk disponohet informacion në sistemin elektronik pasi ai është vënë në funksion në vitin 2010, por sipas

³ Në lidhje me pagesat e kryera nga subjekti, në shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.9.2023, të Agrokredit sh.a. në dosjen e Komisionit, citohet se shoqëria nuk disponon informacion në sistemin elektronik pasi ai është vënë në funksion në vitin 2010. Në këto kushte në analizën financiare janë përfshirë shpenzimet për pagesat e kësteve të kredisë përlogaritur nga Komisioni sipas skedul amortizimi duke përfshirë shumën e financuar, interesin dhe afatin sipas kontratës se huas nr. *** rep., nr. *** kol, datë 7.5.2003.

vërtetimit nr. *** prot., datë 10.3.2008, lëshuar nga Fondi i Financimit të Zonave Malore depozituar nga subjekti në ILDKPKI në vitin 2014, vërtetohet se subjekti ka paguar në total në periudhën pas fillimit të detyrës 4.4.2007 – 7.9.2007 shumën prej 2.577.590 lekësh (principal + interes), ku pagesat më të larta janë kryer në periudhën 4.4.2007 – 12.6.2007 në shumën 2.224.250 lekë⁴, duke ulur ndjeshëm principalin e kredisë që është shlyer totalisht në datën 7.9.2007. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume analiza financiare⁵ është kryer duke konsideruar të ardhurat nga punësimi/pensioni dhe shpenzimet jetike të familjes sipas përbërjes familjare, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar me të ardhura të ligjshme shlyerjen e kredisë para afatit në periudhën 4.4.2007 – 12.6.2007 dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare.

29.4. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve se: (i) kredia, shlyerja e saj si dhe burimi i të ardhurave për shlyerjen e saj nuk janë deklaruar në DPDFD-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 dhe as në DPV-në e dorëzuar në datën 27.10.2014 nga ana e subjektit; (ii) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të shlyer kredinë para afatit për shkak të balancës negative prej 2.105.256 lekësh.

29.5. Në parashtrimet e tij, fillimisht subjekti kundërshton qasjen e Komisionit në lidhje me përdorimin e kredisë, duke paraqitur si argument dhe provë të pakundërshtueshme se në deklaratën para fillimit të detyrës të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më 27.10.2014 ka deklaruar se kredinë e marrë prej 3.000.000 lekësh e ka përdorur për ndërtimin e shtesës së objektit. Subjekti pretendon se, meqenëse ndërtimi i shtesës së njësisë ka filluar në dhjetor 2006, pra disa muaj pas disbursimit të kredisë, nuk është në gjendje të mbajë mend nëse këtë shumë e kishte të ruajtur në shtëpi të tërën apo mund ta ketë përdorur pjesërisht për veprime të tjera dhe të gjitha paratë së bashku, edhe nga fitimet e punës së tij edhe nga shitja e vreshtave etj., kanë qenë në banesë para fillimit të investimit për shtesën e njësisë dhe e ka të pamundur të kujtojë, të përcaktojë dhe të deklarojë pas 17 vitesh. Kjo kredi, sipas subjektit, nuk mund të konsiderohet si një shpenzim tjetër dhe më vete nga ai për të cilin është marrë “Rikonstruksion i një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”, pasi qëllimi dhe destinacioni i saj ka qenë shtesa e llojit njësi, dhe kërkon që në analizën financiare të rezultateve të hetimit të hiqet shpenzimi i shumës 3.000.000 lekë si e shpenzuar gjatë periudhës 8.6.2006 – 22.9.2006.

29.5.1. Lidhur me deklarin e kësaj kredie, subjekti sqaroi se ajo është marrë përpara emërimit të tij në detyrë, në datën 2.8.2006 dhe është shlyer plotësisht në datën 7.9.2007, përpara datës 19.3.2008, që përkon me deklarin e tij të parë të interesave privatë përpara emërimit në detyrë, në kushtet kur deklarin e parë e ka kryer me vonesë. Sipas tij, në rubrikën e detyrimeve financiare përcaktohet se duhen të deklarohen ato detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të detyrës dhe në deklaratën e parë përpara fillimit të detyrës, më 19.3.2008, ka deklaruar detyrimet financiare, kontratën e sipërmarrjes për apartamentin me sip. 113.1m² në Tiranë dhe kredinë e marrë prej 40.000 euro. Pra ka deklaruar detyrimet e mbartura deri në datën 31.12.2007 dhe jo

⁴ Sipas përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni (duke marrë në konsideratë respektimin e termave të kontratës së kredisë për sa i përket afatit të shlyerjes dhe interesit të aplikuar prej 15 %) nga shuma prej 2.224.250 lekësh, shuma prej 2.169.698 lekësh paguar për uljen e principalit të kredisë, ndërsa shuma prej 54.552 lekësh paguar interesi përkatës; në këtë mënyrë, principalin e kredisë është ulur nga 2.517.2010 lekë në mars të vitit 2007 në 347.512 lekë në qershor të vitit 2007, i cili u shlye totalisht në shtator të vitit 2007 (përlllogaritjet janë paraqitur në excel-in e analizës financiare bashkëngjitur rezultateve të hetimit administrativ).

⁵ Nga të ardhurat/shpenzimet e njohura të kësaj periudhe, nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në maj 2007 në shumën total prej 2.000.000 lekësh, për shkak se janë deklaruar si burim për krijimin e gjendjes *cash* në vitin 2007 sipas formularit të deklarinimit DPV 2007 dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.10.2014; (ii) të ardhurat nga shitja e një automjeti tip “Mercedes-Benz” në shumën 250.000 lekë në datën 27.3.2007; (iii) shpenzimet për ndërtimin e objektit në Tropojë sipas lejes së ndërtimit datë 6.12.2006; (iv) pagesa e kështit prej 10.000 euro në datën 26.3.2007.

20.3.2007, duke ngatërruar kështu deklarin si deklarim periodik vjetor dhe kështu nuk kishte çfarë të deklaronte në kushtet kur ishte e shlyer në datën 7.9.2007.

29.5.2. Sa i takon mundësisë për shlyerjen e kësaj kredie, subjekti pretendon se ai ka pasur të ardhura të ligjshme nga shitja e dy apartamenteve me kontratat nr. ***, datë 18.5.2007 dhe nr. ***, datë 22.5.2007, në vlerën 2.000.000 lekë dhe diferenca është paguar nga të ardhurat familjare të kursyera qoftë nga pagat qoftë nga shitja e pasurive të paluajtshme, brenda periudhës 20.3.2007 – 12.6.2007, të ardhura të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

29.6. Në analizë të parashtrimeve vlerësohet se sqarimet e subjektit qëndrojnë pjesërisht, pasi sa i takon pretendimit se kjo kredi ka shërbyer për ndërtimin e shtesës mbi njësinë me sip. 105.8 m² nuk duket i provueshëm, për sa kohë që si në DPFĐ-në e dorëzuar në datën 19.3.2008, në deklaratën *Vetting* ashtu edhe në pyetësorin nr. 2 subjekti nuk e ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtesës. Por, nga ana tjetër, duket e besueshme se një pjesë e kësaj kredie mund të ketë shërbyer duke qenë se në kohën e marrjes së saj subjekti ishte në proces e sipër të pajisjes me leje ndërtimi për shtesën, si dhe në DPFĐ-në e dorëzuar në datën 27.10.2014 edhe pse nuk e ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtesës, tek rubrika e detyrimeve financiare subjekti e ka deklaruar si detyrim me përshkrimin “Për ndërtim shtesë objekti”.

29.6.1. Sa i takon mosdeklarimit në DPFĐ me datë 19.3.2008 dhe DPV-në për vitin 2007 të dorëzuar në datën 27.10.2014, shpjegimet e dhëna nga subjekti qëndrojnë pasi në DPFĐ të dorëzuar në datën 19.3.2008 subjekti ka deklaruar detyrimet aktive dhe kjo kredi ishte mbyllur që në datën 7.9.2007, pra subjekti nuk kishte më detyrime financiare për shlyerjen e saj.

29.6.2. Sa i takon mundësisë për shlyerjen e kredisë, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit qëndrojnë pasi në dukje të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të paluajtshme janë gjeneruar pas datave kur është bërë shlyerja e pjesës më të madhe të kredisë, por nga leximi i kontratave rezulton se në mënyrë specifike është pasqyruar që pagesat janë kryer para përpilimit të tyre dhe jashtë zyrës noteriale. Pra, pavarësisht se kontratat për shitjen e pasurive janë lidhur në datat 18.5.2007, 22.5.2007 dhe 28.12.2007, të ardhurat janë gjeneruar para këtyre datave dhe si të tilla ato mund të kenë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë në FAF, ku pjesa më e madhe prej 2.224.250 lekësh është kryer në periudhën 4.4.2007 – 12.6.2007. Në përfundim të rishikimit të analizës financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë së marrë.

30. *Kontratë kredie me kufi të marrë në RFZ Bank, në datën 2.7.2014, shuma 300.000 lekë likuiduar, datë 12.3.2014 shuma 300.000 lekë likuiduar, datë 13.7.2011 shuma 220.000 lekë likuiduar, datë 16.2.2012 shuma 10.000 lekë likuiduar, datë 30.1.2008 shuma 80.000 lekë likuiduar.* Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur disa dokumente shkresore. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Nga verifikimet e të gjitha akteve shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me linjat e *overdraft*-it me të dhënat bankare, por për sa i përket kontratave kredi kufi datë 2.7.2014, datë 12.3.2014 dhe datë 16.2.2012, banka informon se këto linja *overdrafti* nuk janë disbursuar në llogarinë e subjektit. Megjithatë në llogarinë nr. *** – lekë të subjektit pranë kësaj banke, vërehet se gjatë vitit 2014 ka balanca negative, që nënkupton përdorimin e një *overdrafti* nga ana e subjektit.

30.1. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto konstatime, i cili në parashtrimet e tij deklaroi se kontratat e datave 12.3.2014, 2.7.2014 dhe 16.2.2012 nuk kanë hyrë në fuqi (pra sipas tij nuk është përdorur *overdrafti*), ndërsa gjendja negative në vitin 2014 ka ardhur për shkak se veprimi i tërheqjes është pasqyruar para veprimit të depozitimit, deklarime të cilat duken bindëse.

31. *Kontratë kredie datë 19.1.2007, marrë nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank në shumën 8.000.000 lekë, likuiduar.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

31.1. Subjekti ka paraqitur kontratë kredie datë 19.1.2007, në Raiffeisen Bank, kredimarrës V. dhe Artan Hajredinaj, të shumës 800.000 lekë⁶, me afat 5-vjeçar, për arsye personale. Nga verifikimet e kryera sipas dokumenteve bankare të Raiffeisen Bank, përputhet deklarimi i subjektit për sa i përket marrjes së kredisë në shumën 800.000 lekë në datën 19.1.2007 nga bashkëshortja e tij pranë Raiffeisen Bank, por nga verifikimi i DPV-ve ndër vite vërehet se vetëm në DPV-në e vitit 2008 është deklaruar shuma e shlyer gjatë atij viti për këtë kredi, pra kjo kredi nuk është deklaruar si detyrim financiar as në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në DPV-në e vitit ***. Gjithashtu, shlyerja para afatit e kësaj kredie në datën 11.11.2010 nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2010 nga subjekti.

31.2. Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë financiare për të shlyer me të ardhura të ligjshme kredinë para afatit në shumën 270.000 lekë në datën 11.11.2010, nga ku rezulton një balancë negative në shumën 139.407 lekë.

31.3. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: (i) subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi për të shlyer kredinë para afatit dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare, për shkak të një balance negative prej 139,407 lekësh; (ii) kredia dhe shlyerja e saj nuk janë deklaruar në deklaratat DPFDF dorëzuar në datën 19.3.2008 dhe në DPV-në e vitit 2009/2010.

31.4. Në parashtrimet e tij, në lidhje me pamundësinë financiare për shlyerjen e kredisë, subjekti sqaroi se nga të dhënat bankare rezulton se ai dhe bashkëshortja për periudhën 1.10.2010 – 11.11.2010 kanë tërhequr *cash* në total 1.388.500 lekë dhe se shpenzimet jetike janë në vlerën 550.012 lekë. Në lidhje me mosdeklarimin e shlyerjes së kredisë, subjekti ka parashtruar se ai e ka konsideruar të mjaftueshëm deklarimin e marrjes së kredisë në DPFDF plotësuar në mars të vitit 2008 dhe i referohet faktit që shlyerja e saj bëhej nëpërmjet bankës nga llogaria e pagës të cilën ai e ka deklaruar, ndërkohë që sipas ligjit ai nuk kishte detyrimin për të deklaruar shpenzimet.

31.5. Komisioni vlerëson se pavarësisht se subjekti e ka deklaruar marrjen e kredisë në DPFDF plotësuar në mars të vitit 2008 dhe nuk ka pasur si qëllim të fshehtë kredinë apo shlyerjen e saj pasi këto procese realizohen nëpërmjet sistemit bankar, ai duhet të deklaronte në deklaratat periodike detyrimet financiare ndaj të tretëve, për të cilat ligji nuk parashikon ndonjë kufi të vlerës nga ku duhet ose jo të nisë deklarimi. Por, pasaktësia për shkak të mosdeklarimit të shlyerjes së kredisë vlerësohet pa pasoja. Në lidhje me pamundësinë financiare për shlyerjen e kredisë në vitin 2010, në analizën financiare të kryer prej tij dhe të paraqitur në parashtrime, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që shpenzimet jetike të llogariten nga Komisioni në shumën 550.012 lekë nga 589.743 lekë që janë përlllogaritur në rezultatet e hetimit, por nuk ka depozituar një dokumentacion që të provojë pretendimin e tij. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka prapësuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë në vitin 2010, pavarësisht se kjo mungesë është në një vlerë jo domethënëse.

KONSTATIME TË TJERA

32. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar dhënie huaje si vijon: (i) *Dhënë hua prej 30.000 euro shtetasit V. J. H., deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.6.2016;* (ii) *Dhënë hua shumën prej 19.000 USD shtetasit E. Xh. D., deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017.*

32.1. Nga ana e Komisionit, pasi u kryen verifikime në lidhje me huat e dhëna nga subjekti, trajtuar gjerësisht në rezultatet e hetimit, u vërtetua që huat janë marrë nëpërmjet akteve noteriale dhe subjekti i ka deklaruar ato sipas ligjit. Si burim kanë shërbyer të ardhurat nga

⁶ Shuma prej 8.000.000 lekësh e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* duket të jetë lapsus nga ana e tij.

shitja e tri pasurive⁷ në datën 2.6.2016 të cilat janë tërhequr nga subjekti nga llogaria e tij bankare pranë Raiffeisen Bank. Të dyja huat për të cilat nuk kanë rezultuar problematika janë përfshirë si pasuri në analizën financiare të vitit 2016. Po kështu, pas verifikimeve nuk rezulton konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar në lidhje me huamarrësit V. H. dhe E. D.

Të ardhura të deklaruara nga shitja e disa pasurive të paluajtshme

33. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 2.6.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, Bajram Curri, Tropojë. Shuma: 6.500 euro. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se pasuria nr. *** është blerë me kontratën nr. ***, datë 4.9.2006 (para fillimit të detyrës) në shumën 500.000 lekë dhe pas kryerjes së analizës financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për kursim dhe blerjen e kësaj pasurie. Kjo pasuri është shitur me kontratën nr. ***, datë 2.6.2016, në vlerën 6.500 euro kaluar me transfertë bankare në llogari të subjektit pranë Raiffeisen Bank. ZVRPP/ASHK Tropojë ka konfirmuar me akte shtesore blerjen dhe shitjen e pasurisë, rrjedhimisht janë konsideruar si të paguara detyrimet tatimore. Në përfundim nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e saj.

34. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur: (i) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.9.2006, sipas së cilës z. Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit M. Gj. një truall të lirë me sip. 150 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 200.000 lekë; (ii) vërtetim nr. ***, datë 7.11.2016, nga ZVRPP Tropojë sipas të cilit z. Artan Hajredinaj ka të regjistruar në z. k. ***, Bajram Curri, pasurinë nr. ***, lloji truall me sip. 30.7 m², kjo sipërfaqe është nën objekt jo truall i lirë; (iii) kontratë nr. ***, datë 22.9.2006, për blerjen e pasurisë nr. *** nga shtetasi M. Gj., të lloji truall nën objekt me sip. 140.7 m², në vlerën 300.000 lekë.

34.1. ZVRPP/ASHK Tropojë, duke përcjellë edhe dokumentet, kanë konfirmuar se z. Artan Hajredinaj ka pasur pasurinë nr. ***, fituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.9.2006, e cila më vonë është bashkuar me pasurinë nr. ***, truall (150 + 140.7 = 290.7 m²). Pasuria nr. *** është fituar në bashkëpronësi dhe pas heqjes dorë nga bashkëpronarët⁸ është regjistruar në pronësi individuale të subjektit dhe është bashkuar me pasurinë nr. ***. Kjo pasuri më vonë është ndarë në pasurinë nr. *** truall me sip. 260 m² dhe pasurinë nr. *** truall me sip. 30.7 m², e cila është shuar dhe nuk ekziston më (këto transaksione janë trajtuar hollësisht në paragrafin 35 në vijim). Nga analiza financiare për periudhën përpara detyrës rezulton se subjekti ka pasur mundësi për kursime dhe blerjen e pasurive nr. *** dhe nr. ***, blerë përkatësisht sipas kontratave datë 4.9.2006 dhe datë 22.9.2006.

35. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 2.6.2016 për pasurinë e paluajtshme nr. ***, Bajram Curri, në shumën 120.855 euro dhe kontrata e shitjes nr. ***, datë 2.6.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, Bajram Curri, në shumën 10.678 euro. Në kushtet kur ka pasur të dhëna publike në një media online⁹ dhe është administruar një denoncim anonim sipas të cilave subjekti ka bërë ndërtime pa leje, nga ana e Komisionit janë kryer verifikime të detajuara në lidhje me pasuritë e shitura prej të cilave janë krijuar të ardhura si vijon.

35.1. Nga aktet në dosje në mënyrë të përmbledhur në rend kronologjik, rezultoi se:

- Me kontratë nr. ***, datë 14.7.2005, z. Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit M. Gj. pasurinë nr. ***, lloji njësi tregtare, me sip. 105.8 m², blerë në çmimin 1.600.000 lekë.

⁷ Pasuria nr. ***, datë 2.6.2016, me çmim shitjeje 120.855 euro; pasuria nr. ***, datë 2.6.2016, me çmim shitjeje 10.678 euro; pasuria nr. ***, datë 2.6.2016, me çmim shitjeje 6.500 euro.

⁸ Pas verifikimeve nuk rezulton konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

⁹ Artikulli i publikuar www.***.com/****/

- Me kontratë nr. ***, datë 4.9.2006, z. Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit M. Gj. një truall të lirë me sip. 150 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 200.000 lekë.

- Me kontratë nr. ***, datë 22.9.2006, ka blerë pasurinë nr. *** po nga shtetasi M.Gj., të lloji truall nën objekt me sip. 140.7 m², në vlerën 300.000 lekë.

- Sipas vërtetimit hipotekor datë 20.1.2009, figuron në pronësi të z. Artan Hajredinaj pasuria nr. ***, njësia me sip. 392.59 m² para Gjykatës së Rrethit Tropojë (shtesë dhe ngritje kati mbi pasurinë nr. *** blerë nga shtetasi M. Gj.). Në këtë shkresë pasqyrohen aktet që vërtetojnë lejimin e subjektit për ndërtimin e shtesës dhe regjistrimin e pasurisë së kësaj shtese si: shkresë nr. *** prot., datë 17.12.08, lëshuar nga KRT Bashkia Bajram Curri; leje shfrytëzimi nr. *** me datë 25.11.2008; vendim nr. ***, datë 6.12.2006, për leje ndërtimi. Në vitin 2014 subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së lejen e shfrytëzimit të objektit, në përmbajtje të së cilës pasqyrohet se procesverbali i kolaudimit është mbajtur me datë 14.9.2008.

- Në DPFĐ-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë nr. ***, duke shpjeguar ngritjen e lokalit sipas lejes me sipërfaqe ndërtimi 222 m² + kat, por nuk ka deklaruar blerjen e pasurisë nr. *** truall me sip. 150 m² dhe pasurisë nr. *** truall me sip. 140.7 m².

- ZVRPP/ASHK Tropojë ka informuar se pasuria nr. *** (njësi ekzistuese), më vonë është bashkuar me pasurinë nr. *** me sip. 392.59 m² (objekti shtesë mbi ekzistuesin) dhe pas disa ndarjeve dhe bashkimeve janë formuar njësitë nr. *** me sip. 98.49 m² dhe nr. *** me sip. 399.5 m² në vitin 2009. Më pas (në vitin 2016) njësia nr. *** është ndarë në tri pasuri, nga të cilat pasuritë nr. *** dhe nr. *** subjekti i ka dhuruar, ndërsa pasuria nr. *** është shitur. Po kështu edhe pasuria nr. *** është shitur.

- Në lidhje me pasuritë e dhuruara, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se njësitë nr. *** dhe nr. *** ia ka dhuruar shtetasit F. Gj. pasi nga ky janë bërë shpenzimet e ndërtimit sipas lejes nr. ***, datë 6.12.2006, duke shpjeguar se që nga momenti i fillimit të ndërtimit dhe deri në momentin e dhurimit nuk ka bërë asnjë shpenzim dhe se shtetasi F. Gj. që nga fillimi i ka disponuar dhe poseduar. Gjatë procesit iu kërkua subjektit të sqarojë duke paraqitur dokumentacion provues sa është shuma e investimit të kryer nga shtetasi F. Gj., kur, kujt dhe si i është dhënë kjo shumë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se me shtetasin F. Gj. ranë dakord verbalisht që në momentin e realizimit të ndërtimit, ky shtetas të merrte në posedim katin përdhe, ndërkohë që punimet nga subjekti do të konsistonin vetëm në ngritjen e kolonave. Sipas tij, investimi i kryer nga shtetasi F. Gj. , nuk është pjesë e vlerës prej 2.259.351 lekësh sipas preventivit, por janë kryer investime prej tij në shumën 600.000 lekë. Subjekti paraqiti deklaratë noteriale me datë 19.8.2023 ku shtetasi F. Gj. pohon deklaratet e subjektit.

35.2. Në lidhje me vlerën e ndërtimit të shtesës trikatëshe (mbi objektin ekzistues) që është pasuria nr. ***si dhe periudhat e ndërtimit, u konstatua se në DPFĐ-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 subjekti ka deklaruar si vlerën e investimit të shtesës shumën prej 2.259.351 lekësh dhe bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka paraqitur një preventiv në këtë vlerë që mban datën 20.7.2005. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka shtuar edhe vlerën prej 600.000 lekësh të kryer nga shtetasi F. Gj. . Siç rezultoi nga hetimi, nuk është administruar një procesverbal kolaudimi që të vërtetojë periudhën dhe vlerën e investimit, ndërkohë që u administrua leja e shfrytëzimit me datë 25.11.2008, në përmbajtje të së cilës shkruhet se *procesverbali i kolaudimit është mbajtur me datë 14.9.2008.*

35.2.1. Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor (akt kolaudimi) që të provojë vlerën faktike të investimit dhe kohën e saktë të kryerjes së punimeve, Komisioni kreu përllëgaritjet e kostove të ndërtimit për përfundimin e shtesës së lokalit ekzistues dhe kateve më sipër sipas lejes së ndërtimit të datës 6.12.2006, duke konsideruar: (i) sipërfaqen e shtesës prej 392.59 m² të ndërtuar sipas vërtetimit hipotekor të vitit 2009; (ii) periudhën e kryerjes së punimeve nga

data 6.12.2006 (kur është lëshuar leja e ndërtimit) deri në datën 14.9.2008 (referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudimit sipas lejes së shfrytëzimit nr. ***, datë 25.11.2008); (iii) koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Bajram Currit për vitet 2006 – 2008 sipas EKB-së.

35.2.2. Nga këto përlllogaritje, rezulton se shpenzimet për investimin janë në vlerën prej 13.219.017 lekësh pasqyruar në tabelën më poshtë. Sa i takon vlerës 2.259.351 lekë për të cilën bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur një preventiv punimesh deri në përfundim të hetimit është çmuar se kjo nuk mund të konsiderohet si vlerë investimesh për sa kohë që preventivi është një akt që tregon një vlerë paraprake punimesh dhe jo vlerën reale të investimeve të cilat do të duhet të ishin vërtetuar me një situacion punimesh apo akt kolaudimi të cilat mungojnë të jenë paraqitur nga subjekti.

Periodhat	Kostoja mesatare e ndërtimit sipas EKB-së (lekë/m ²)	Sipërfaqe ndërtimi (m ²)	Periodhat e punimeve (muaj)	Periodhat e punimeve në përqindje	Vlera e ndërtimit sipas periudhave (lekë)
6.12.2006 – 31.12.2006	27,904	392.59	0.5	2%	260.829
1.1.2007 – 19.3.2007	31,986		2.5	12%	1,494,927
20.3.2007 – 31.12.2007			9.5	45%	5,680,721
1.1.2008 – 14.9.2008	35,872		8.5	40%	5,700,257
TOTAL					13,136,734

35.3. Sa i takon mundësisë financiare të subjektit për investim të të gjithë objektit (ai ekzistues + shtesën), në përfundim të hetimit, pasi janë verifikuar burimet e ligjshme është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e blerjes së njësisë ekzistuese prej 105.8 m² në datën 14.7.2005 në vlerën 1.600.000 lekë, sipas së cilës subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme. Sa i takon investimit në shtesën e njësisë ekzistuese që është pasuria nr. ***, nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të kryer shpenzimet në vlerën prej 13.219.017 lekësh për shkak se në periudhën para detyrës 6.12.2006 – 20.3.2007 ka një balancë negative -1.755.756 lekë dhe në periudhën pas detyrës 20.3.2007 – 14.9.2008 ka një balancë negative -11.380.978 lekë.

35.4. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, pasi duket se: (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të kryer shpenzimet në shumën 1.755.756 lekë në periudhën 6.12.2006 – 20.3.2007 (para detyrës) dhe 11.380.978 lekë në periudhën 20.3.2007 – 14.9.2008; (ii) subjekti nuk i ka deklaruar njësitë në DPV-në e vitit 2009 si dhe ka bërë deklarime të pasakta dhe të paplota ndër vite dhe gjatë procesit në lidhje me sipërfaqet e njësive dhe burimin e krijimit; (iii) mbetet e paqartë arsyeja e dhurimit të njësive nr. *** dhe nr. *** shtetasit F. Gj. në vitin 2016, për më tepër 7 vite pas regjistrimit të tyre në ZVRPP, duke ngritur dyshime për dhurime fiktive, pasi të gjitha deklaratimet e subjektit sa i takon shkaqeve të dhurimeve, janë në nivel deklarativ dhe nuk justifikojnë dhurimin e pasurive.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35.5. Në lidhje me pamundësinë financiare për ndërtimin e shtesës, fillimisht subjekti kundërshton përlllogaritjet e Komisionit në dy drejtime: në lidhje me periudhën e investimeve si dhe në lidhje me vlerën e punimeve. Konkretisht sa i takon periudhës së investimeve të konsideruar nga Komisioni për periudhën 6.12.2006 – 14.9.2008, subjekti pretendon se kjo periudhë nuk është e saktë, për faktin se punimet për shtesat kanë nisur dhe kanë përfunduar në periudhën 2006 – 2007, brenda afatit të lejes së ndërtimit, pra në datën 28.2.2007, sikurse konfirmon edhe akti i kolaudimit datë 14.9.2008, paraqitur si provë e re shkresore. Sipas tij, volumi i punimeve të kryera nuk dikton një afat më të gjatë kohor nga ai i përcaktuar në lejen

e ndërtimit dhe fakti që procesverbali i kolaudimit është mbajtur në datën 14.9.2008 nuk do të thotë që punimet kanë përfunduar në atë datë, pasi kjo datë është përtej afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Subjekti vijon se nëse do të kishte punime përtej afatit duhej të paraqiste një kërkesë për shtyrje të afatit të lejes për kryerjen e punimeve, të paguante taksat përkatëse dhe më pas të vijohej me daljen e vendimit për shtyrje të afatit të lejes, fakt që nuk konfirmohet nga ana e asnjë organi kompetent që të ketë ndodhur. Sipas subjektit kolaudimi si proces bëhet vetëm kur një objekt është ndërtuar me leje ndërtimi, prandaj kur ka deklaruar (pranë ILDKPKI-së në vitin 2014) se ndërtimi ka qenë i përfunduar në vitin 2008 i është referuar pikërisht momentit të lëshimit të procesverbalit të kolaudimit dhe lejes së shfrytëzimit (të dyja në vitin 2008), kur ndërtimi konsiderohet përfundimisht i certifikuar dhe nuk i është referuar përfundimit faktik të ndërtimeve. Në mbështetje të parashtrimeve të tij subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore.

35.5.1. Në lidhje me vlerën e investimeve subjekti kundërshton mënyrën e përlllogaritjes sipas EKB-së të bërë nga Komisioni, duke pretenduar se vlera e investimit është sipas preventivit datë 20.7.2005 prej 2.259.351 lekësh të paraqitur me deklaratën *Vetting*, duke parashtruar edhe faktin se gjatë hetimit ka sqaruar se shuma e investuar nga shtetasi F. Gj. prej 600.000 lekësh nuk është pjesë e vlerës së pasqyruar në preventiv, por përtej saj.

35.5.2. Sa i përket dokumentit “situacion përfundimtar” të cilin Komisioni e konsideron të munguar, subjekti shprehet se në dosjen e pasurisë që i është vënë në dispozicion atij dhe Komisionit nga ZRPP Tropojë, nuk ndodhet një dokumenti i tillë dhe pasi e ka kërkuar nga kompania e ndërtimit, i është bërë me dije se afati i ruajtjes së dokumentacionit dhe mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore, e për rrjedhojë edhe e çdo dokumenti justifikues që lidhet me to (në rastin konkret një kopje e dosjes së plotë të punimeve të ndërtimit të shtesës së njësisë) është 5 vjet. Për këtë arsye edhe dosja e ndërtimit të shtesës nuk është ruajtur nga shoqëria ndërtuese. Kështu që, ai nuk mund të mbaje përgjegjësi¹⁰ përse institucioni shtetëror përgjegjës nuk e disponon dokumentin “situacion punimesh”, e për rrjedhojë ai nuk ka nga ta disponojë e ta paraqesë atë para Komisionit, duke bërë që të gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, sikurse është parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

35.5.3. Subjekti paraqet edhe argumentin se sipas aktit të kolaudimit në vendin ku do të duhej të ishte plotësuar vlera sipas situacionit të realizuar, nuk është vendosur asnjë shifër nga inxhinierët kolaudues. Ndërsa në faqen 2 të këtij akti kolaudimi vërehet se nuk ka asnjë diferencë në vlera punimesh midis faktit dhe situacionit përfundimtar. Pra, sipas subjektit vlera e punimeve është sipas preventivit të dosjes së lejes së paraqitur në deklaratën *Vetting*.

35.5.4. Gjithashtu subjekti argumenton se kostot e EKB-së, të cilat janë çmime referuese e si të tilla ato kanë një vlerë udhëzuese, përdoren për vlerësimin e një investimi kur nuk ka asnjë tjetër dokument të kohës që ta provojë këtë vlerë. Sipas tij, Komisioni duke u bazuar në çmimet e EKB-së, përlllogarit sikur ndërtimi është bërë nga fillimi dhe jo për shtesa. Sipas subjektit, sikurse evidentohet nga planimetritë e shtesës dhe fotot e pronës të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ, punimet e ndërtimit janë kryer mbi një ndërtesë ekzistuese, pra nuk ka pasur nevojë të bëhen themele nga e para dhe punime fillestare, të cilat përbëjnë 44.1% të punës sipas zërave të preventivit. Kështu, edhe në rastin e marrjes për bazë të çmimeve të EKB-së nga ana e Komisionit, duhej të ishte përlllogaritur një vlerë shpenzimesh të paktën 44.1% më pak nga çka është përlllogaritur.

35.5.5. Subjekti ka paraqitur një akt ekspertimi të kryer nga ing. B. K. , ku vërehet se:

- Eksperti ka përpiluar një preventiv me zëra dhe vlera pothuajse të njëjta me preventivin e datës 20.7.2005, por vlera totale e punimeve të kryera sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 6.12.2006, është përlllogaritur në shumën 2.795.731,2 lekë.

¹⁰ Subjekti sjell për analogji edhe vendimin nr. 20, datë 14.7.2021 të KPA.

- Këto punime shtesë janë përlllogaritur sipas çmimeve të ndërtimit në fuqi në kohën e marrjes së lejes së ndërtimit që është dhe metodologjia e vetme në përlllogaritjen e këtyre punimeve ndërtimore.

- Është arsyetuar ndër të tjera se këto punime korrespondojnë vetëm në punime të pjesshme, të cilat janë punime shtesë anash ndërtesës ekzistuese, të llogaritura sipas çmimeve të zërave të ndërtimit në fuqi në kohën e marrjes së lejes dhe se nuk është ndërtuar ndërtesë e re me të gjitha zërat e nevojshëm për zbatimin e projektit, por vetëm disa punime shtesë. Sipas aktit, në rast të ndërtimit të një ndërtese të re me të gjitha zërat e plotë, mund të përdoren edhe metodologji të tjera si përlllogaritja me çmimin e EKB-së, por kjo metodologji është e gabuar dhe nuk vlen për këtë rast.

35.5.6. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, subjekti pretendon se ka provuar të kundërtën e barrës së provës dhe kërkon që Komisioni: (i) të pranojë si kohë ndërtimi periudhën 6.12.2006 – 28.2.2007 sikurse është përcaktuar në aktin e kolaudimit datë 14.9.2008; (ii) të ketë në konsideratë faktin që ndërtimi është një shtesë dhe jo një ndërtesë e re; (iii) të pranojë vlerën e investimit të shpenzuar prej tij 2.195.731 lekë sipas preventivit të punimeve të paraqitur për marrjen e lejes së ndërtimit plus 600.000 lekë të investuara nga shtetasi F. Gj. ; (iv) ndarja e shpenzimeve midis muajve dhjetor 2006 – fund shkurti 2007 të kryhet në mënyrë uniforme sikurse është konsideruar nga Komisioni.

35.6. Në lidhje me pasaktësitë në deklaratimet e njësisive apo sipërfaqeve të tyre subjekti parashtrori se është e vërtetë që në DPFD-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 ka deklaruar vetëm blerjen e njësisë ekzistuese nr. ***, duke lënë pa deklaruar blerjen e pasurive nr. *** truall me sip. 150 m² dhe nr. *** truall me sip. 140.7 m², por në këtë deklaratë ka dhënë shpjegime në lidhje me ngritjen e lokalit shtesë sipas lejes së ndërtimit me sipërfaqe ndërtimi 222 m² + kat, i cili ndodhet mbi trojet e padeklaruara dhe me deklarimin e ngritjes së lokalit me një leje ndërtimi të dhënë nga organi kompetent pikërisht mbi trojet e blera, duke menduar se ka ezauruar detyrimin ligjor për deklarimin e tyre. Ai thekson faktin se këto janë deklaratimet e tij të para, dhe se mosnjohja në atë kohë e kuadrit ligjor dhe mungesa e plotë e orientimit të duhur për mënyrën e plotësimit të deklaratimeve kanë çuar shumë subjekte rivlerësimi në deklarime të pasakta dhe të paqarta. Por, duke pasur parasysh që ka qenë gjithmonë i kujdesshëm për të depozituar të gjitha aktet shkresore që lidhen me pasuritë e tij, tregon pikërisht mungesën e dashjes për të kryer pasaktësi në mënyrë të qëllimtë.

35.6.1. Sa i takon mosdeklarimit në DPV-në e vitit 2009 të dy njësisive, sipas subjektit kjo është vetëm si pasojë e faktit që këto pasuri nuk përbëjnë pasuri të re të rikrijuar, por janë thjesht formalizimi i ndarjeve dhe bashkimeve që ka realizuar ZVRPP/ASHK në momentin e regjistrimit të objektit. Sipas tij nuk ndodhemi përpara krijimit të një pasurie të re, por të ndarjes së tyre për efekt të identifikimit dhe pasqyrimit të sipërfaqeve konkrete sipas planimetrive dhe hartave treguese të ZVRPP-së.

35.6.2. Subjekti në parashtrime ka dhënë sqarime edhe në lidhje me paqartësitë në burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës, duke theksuar edhe një herë se si burim për investimin në shtesë i cili ka përfunduar në datën 28.2.2007 kanë shërbyer të ardhurat e shitjes së pasurive nr. *** dhe ***. Duke paraqitur një panoramë më të gjerë të burimeve që kanë shërbyer në tërësi për të gjithë objektin (atë ekzistues ashtu edhe shtesën mbi të), subjekti nënvizon se në këndvështrimin njerëzor ai nuk ka mbajtur shënimet me “laps dhe letër” të parave që ka përfituar nga shitblerjet e pasurive apo transaksionet e tjera të ligjshme dhe se është krejtësisht e pamundur të bëhet ndarja dhe përcaktimi i saktë çfarë shume u mor nga prurjet e vëllezërve dhe çfarë shume u përdor nga shitja e vreshtave, apo çfarë shume u përdor nga kredia e marrë në atë periudhë pranë FAF-së, për të cilën deklaroi se i ka dalë nga kujtesa dhe se kjo kredi e marrë dhe disbursuar në datën 2.8.2006 ka si objekt “Rikonstruksion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij” e cila sipas tij është marrë për ndërtimin

e këtij objekti në pritje të lejes së ndërtimit, fakt që është deklaruar prej tij edhe në deklarinimet e vitit 2014.

35.6.3. Sipas subjektit paratë janë sende gjenerikisht të cilësueshme dhe jo individualisht të përcaktuara dhe prandaj kanë ndodhur edhe ngatërresa apo nxitime në deklarime. Për më tepër këto veprime janë bërë përpara detyrës kur ka përfunduar edhe shtesa dhe ai nuk ka pasur as detyrimin të mbajë shënime apo të kryejë deklarime.

35.7. Në lidhje me pasuritë e dhuruara shtetasit F. Gj. , subjekti jep të njëjtat shpjegime si gjatë procesit se që nga momenti i fillimit të ndërtimit dhe deri në momentin e dhurimit nuk ka bërë asnjë shpenzim dhe se ky shtetas që nga fillimi i ka disponuar, poseduar apo vjelë frytet mbi këtë pasuri. Duke sjellë në vëmendje vendimin nr. 33, datë 3.11.2021, të Kolegjit parashtron se deklarata noteriale e shtetasit F. Gj. , në referim të nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet si provë. Subjekti pasi bën interpretime ligjore mbi aktet shkresore referuar ligjit të noterisë, pretendon se në rastin konkret deklarata noteriale e lëshuar nga shtetasi F. Gj. për një marrëdhënie që ka ekzistuar përpara emërimit të tij në detyrë konfirmon sot faktet e ndodhura dhe është akt zyrtar me fuqi të plotë provuese. Sipas tij, kjo deklaratë noteriale e përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit nuk është i vetmi dokument që përdoret për të vërtetuar ekzistencën e fakteve juridike që kanë passjellë krijimin e kësaj marrëdhënieje, pasi: (i) Me kontratën e shitblerjes të datës 15.9.2006 me palë shitëse M. Gj., shtetasi F. Gj. ka blerë njësinë me nr. pasurie ***, që kufizohet me pasuritë nr. ***, nr. *** etj.; (ii) Me deklaratën për heqje dorë nr. ***, datë 2.11.2006, është vendosur heqja dorë nga bashkëpronarët F. Gj. , A.A. dhe R. M. lidhur me pasurinë e llojit truall, me qëllim që të miratohej leja për kryerjen e shtesave të kateve nga ana e subjektit. Subjekti i referohet faktit që edhe kur është pyetur nga ILDKPKI-ja në datën 27.9.2014, ka deklaruar ndër të tjera se: *“Kati përdhe zotërohet nga një person tjetër”*. Subjekti sjell në vëmendje qëndrimin orientues të Kolegjit, nr. 15, datë 18.6.2021, sipas të cilit: *“Kolegji konstaton së pari se qëndrimi dhe arsytimi i deritanishëm i Kolegjit... ka qenë se të vetme, deklaratat noteriale të përpiluara përgjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të provojnë një fakt të caktuar, por ato marrin vlerë kur mbështeten nga të dhëna, fakte apo indicie të dëshmuara/provuara nga dokumente të tjera (...)”*. Në këtë kuadër, subjekti pretendon se Komisioni duhet të vlerësojë me objektivitet provat e marra gjatë procesit të rivlerësimit, të analizojë faktet që burojnë prej tyre dhe nivelin e besueshmërisë së tyre në unitet me njëra-tjetrën dhe me shpjegimet e tij për të vlerësuar nivelin e besueshmërisë.

35.7.1. Ashtu si dhe gjatë procesit subjekti parashtron se me shtetasin F. Gj. kanë pasur një dakordësi verbale që pjesën e investimit të kryer nga subjekti deri në momentin e karabinasë t’ia dhuronte shtetasit F. Gj. . Ky dhurim u materializua në momentin që realizoi shitjen e të gjitha njërive, pas regjistrimit të tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Fakti që ky dhurim u realizua 7 vite pas regjistrimit, ka të bëjë vetëm me neglizhencën e të dyja palëve në kushtet e një marrëdhënieje të plotë mirëbesimi. E vërteta është që posedimi dhe sundimi i faktit të kësaj pasurie ka qenë gjithmonë i shtetasit F. Gj. , pasi në asnjë moment ai nuk është zhveshur nga të drejtat faktike mbi përdorimin e kësaj pasurie.

Vlerësimi i Komisionit

35.8. Pasi u analizuan parashtrimet dhe dokumentet që subjekti paraqiti në lidhje me periudhën e investimeve, vërehet se:

- Në procesverbalin e kolaudimit me datë 14.9.2008, rezulton se në zërin *“Janë bërë ndryshime në projekt”* është shënuar *“Jo”*; në zërin *“Punimet dorëzohen me datë”* është shënuar *“Në afat”*; në zërin *“Arsyet e shtyrjes”* është shënuar *“ – ”*; në zërat *“Vlera e shpenzimeve në fakt sipas situacionit të realizuar”* dhe *“Këto diferenca rezultojnë nga këto zëra punimesh”* është shënuar *“ – ”*.

- Në deklaratën noteriale datë 9.2.2024 të shoqërisë “****” sh.p.k., administratori B. B. deklaroi se ka filluar punimet dhe ka përfunduar objektin sipas projekt-preventivit të miratuar dhe në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit.

- Në ortofoto të viteve 2007 dhe 2015, ku është vijëzuar objekti, me sy të lirë nuk duket që objekti ka ndonjë ndryshim nga ortofotoja e vitit 2007 me atë të vitit 2015.

35.8.1. Nisur nga sqarimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, nga ana e Komisionit çmohet se për të arritur në një konkluzion në lidhje me investimin në shtesën e pasurisë mbi atë ekzistuese duhen vlerësuar në harmoni dhe në proporcion me njëra-tjetrën sipas peshës specifike dhe kohës, provat dhe rrethanat si vijon:

i) Sa i takon periudhës së investimeve, në procesverbalin e kolaudimit datë 14.9.2008 është përcaktuar se nuk ka pasur ndryshime në projekt dhe se punimet janë kryer në afat. Ky akt i paraqitur në parashtrime është një dokument zyrtar i cili nuk mund të mos merret në konsideratë nga Komisioni si provë mbi bazueshmërinë e pretendimit të subjektit për përfundimin e objektit brenda periudhës 6.12.2006 (data kur është lëshuar leja e ndërtimit) – 28.2.2007 (që është data e përfundimit të përcaktuar në lejen e ndërtimit). Një të dhënë përforcuese për këtë fakt përbën edhe deklaratata noteriale me datë 9.2.2024 e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., ku deklarohet se punimet kanë përfunduar sipas projekt-preventivit të miratuar dhe në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit. Data 14.9.2008 e procesverbalit të kolaudimit e cila ishte konsideruar si data e përfundimit të punimeve nga Komisioni, në vetvete nuk është një e dhënë përjashtuese që punimet të kenë përfunduar në afatin e lejes së ndërtimit, sikurse përcaktohet në procesverbalin e kolaudimit. Po kështu, një e dhënë tjetër përforcuese është edhe fakti që sipas ortofotos me datë fotografimi 23.6.2008 përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2023, nga ASIG për Komisionin, objekti duket i përfunduar para datës së lëshimit të procesverbalit të kolaudimit 14.9.2008. Gjithashtu, siç vërehet në të gjitha dokumentet e administruara, nuk rezultoi të ketë ndonjë dokument për ndryshim projekti apo që afati i lejes së ndërtimit të jetë zgjatur. Data kur është plotësuar procesverbali i kolaudimit 14.9.2008 (për të cilin nuk mund të përjashtohet mundësia që të ketë ardhur për shkak të sjelljes apo neglizhencës së palëve të treta), në vetvete nuk mund të përbëjë provë të mjaftueshme për të kundërshtuar të gjitha provat dhe faktet e mësipërme.

35.8.2. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me këtë çështje janë të besueshme dhe dokumentet e administruara arrijnë një nivel provueshmërie të tillë që Komisioni të krijojë bindjen se punimet janë kryer brenda afatit të lejes së ndërtimit, pra 6.12.2006 – 28.2.2007 dhe jo brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni në përfundim të hetimit 6.12.2006 – 14.9.2008.

35.9. Sa i takon vlerës së punimeve, subjekti pretendon marrjen në konsideratë të vlerës sipas preventivit, duke iu referuar: (i) procesverbalit të kolaudimit sipas të cilit nuk janë bërë ndryshime në projekt dhe nuk rezultojnë diferenca në vlerën e shpenzimeve; (ii) deklaratës së shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Në vlerësim të këtij pretendimi, vërehet se në preventivin datë 20.7.2005 ku vlera totale është përcaktuar 2.259.351 lekë, rezulton se në përmbajtje ka një gabim matematikor pasi në zërin “Ndërtim çati me tjegull” sasia është 240 m² ndërsa vlera për njësi është 2.300 lekë ku si vlerë është shënuar vlera 55.200 lekë, ndërkohë që 240 x 2.300 lekë bëjnë 552.000 lekë, vlerë e pasqyruar nga eksperti në aktin e ekspertimit. Ndërsa si vlerë totale të investimit eksperti ka përcaktuar shumën 2.777.499,7 lekë. Gjithashtu, vetë subjekti, shumës së preventivit prej 2.259.351 lekësh i ka shtuar edhe shumën prej 600.000 lekësh si të investuar nga shtetasi F. Gj. . Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se këto elemente të çojnë në konkluzionin se vlera e investimit e përcaktuar në preventivin e datës 20.7.2005, në shumën 2.259.351 lekë, nuk mund të konsiderohet si vlerë e saktë dhe e pakundërshtueshme.

35.9.1. Në këto rrethana, Komisioni në përlllogaritjen përfundimtare të vlerës së investimit çmon të marrë në konsideratë konkluzionin e ekspertit të fushës të arritur në aktin e ekspertimit, i cili ndër të tjera është shprehur se: “...nuk është ndërtuar ndërtesë e re me të gjitha zërat e

nevojshëm për zbatimin e projektit por vetëm disa punime shtesë. Në rast të ndërtimit të një ndërtese të re me të gjithë zërat e plotë, mund të përdoren edhe metodologji të tjera si përlllogaritja me çmimin e EKB-së, por kjo metodologji është e gabuar dhe nuk vlen për këtë rast...". Po ashtu, duke ruajtur të njëjtën logjikë, Komisioni vlerëson t'i referohet qëndrimit të mbajtur nga subjekti i rivlerësimit sipas të cilit edhe në rastin e marrjes për bazë të çmimeve të EKB-së, nga ana e Komisionit duhej të ishte përlllogaritur një vlerë shpenzimesh të paktën 44.1% më pak nga ajo që është përlllogaritur nga Komisioni.

35.9.2. Një rrethanë tjetër që Komisioni vlerëson të evidentojë është fakti që, sipas kostos së ndërtimit të përlllogaritur në rezultatet e hetimit, rezulton një vlerë mesatare prej 33.461 lekë/m² (këtu pa përfshirë vlerën e trojeve apo edhe investime në kohë të kryer nga qiramarrësit) ndërkohë që pas 9 vitesh subjekti e ka shitur në treg të lirë me një vlerë prej 302 euro/m² ose 41.766 lekë/m², pra një rritje krahasimisht e vogël prej 8.305 lekë/m². Kjo rrethanë nuk do të përbente një logjikë normale ekonomike që subjekti si palë shitëse të pretendonte një fitim të tillë nga diferenca investim-shitje, duke pasur parasysh minimalisht që për një periudhë kaq të gjatë kohe pasuritë e paluajtshme kanë pësuar gjithnjë rritje. Për rrjedhojë, për Komisionin fakti që kjo pasuri është shitur në vitin 2016 në vlerën 41.766 lekë/m² përbën një element për të konkluduar logjikisht që investimi të ketë qenë ndjeshëm më i vogël se ai i përlllogaritur në rezultatet e hetimit. Në drejtim të kësaj logjike duhet evidentuar edhe fakti se objekti është i llojit njësi tregtare, çka do të thotë se nga praktika, por edhe nga legjislacioni, në tregun e lirë ato shiten më shtrenjtë se objektet e llojit banesë, ndërsa përlllogaritja sipas EKB-së nuk bën ndonjë diferencim të kostove për këto lloj objektesh, fakt ky që përforcon idenë se çmimi i shitjes së njësisë në vitin 2016 është disa herë më i lartë se investimi i kryer në vitin 2006/2007.

35.9.3. Si përfundim të procesit, Komisioni bazuar në një analizë logjike e harmonike të të gjitha fakteve dhe provave arsyetuar si më sipër, në analizën e rishikuar financiare vlerësoi të konsiderojë si kohë investimi periudhën e parashikuar në lejen e ndërtimit 6.12.2006 – 28.2.2007 dhe vlerën e investimit prej 6.720.969 lekësh që është 44.1% më pak se vlera e përlllogaritur sipas çmimeve të EKB-së për periudhën përkatëse.

35.10. Sa i takon pasaktësive në deklarime, pretendimet e subjektit vlerësohen bindëse dhe ndonjë pasaktësi apo paqartësi në deklarimet e viteve 2008 – 2009 ka ndodhur si pasojë e veprimeve shumëdimensionale që subjekti ka kryer në një hark kohor të shkurtër. Nga ana tjetër, mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i subjektit i cili pranon pasaktësitë në deklarime duke dhënë në çdo rast argumentet përse kanë ndodhur dhe se janë të paqëllimta, për shkak se pavarësisht kësaj ai ka treguar kujdes për të depozituar të gjitha dokumentet. Ky argument është tërësisht i besueshëm, pasi subjekti pavarësisht mënyrës së deklarimit, si në shpjegimet e dhëna në vitin 2014 në ILDKPKI ashtu edhe në deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacion të plotë në lidhje me përfitimin e pronësisë mbi njësinë ekzistuese dhe trojet rreth saj ku është ndërtuar shtesa, aplikimin dhe marrjen e lejes së ndërtimit për shtesën, regjistrimet, ndarjet apo bashkimet e pasurive, shitjet, dhurimet etj., të trajtuara gjatë hetimit administrativ, fakt që tregon mungesën e ndonjë qëllimi të paracaktuar.

35.10.1. Sa i takon pasaktësive në deklarimet në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga ana e Komisionit vlerësohet se në kushtet kur investimi ka filluar dhe përfunduar përpara fillimit të detyrës nga subjekti dhe ai nuk ka pasur detyrimin e deklarimeve, justifikohen paqartësitë apo mospërputhjet në deklarime. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se në analizën financiare Komisioni ka përfshirë vetëm të ardhurat e ligjshme të vërtetuara me dokumente shkresore. Sa i takon kredisë prej 3.000.000 lekësh të marrë në vitin 2006 pranë FAF, kjo kredi nuk është konsideruar si burim për investimin në pasurinë objekt vlerësimi (shtese e njësisë ekzistuese), deklaruar për herë të parë gjatë procesit vetëm në parashtrime ku subjekti ka pohuar se kishte harruar ta deklaronte. Nga analiza financiare e rishikuar pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, rezulton se ai ka justifikuar investimet me të ardhura të ligjshme, në këto kushte edhe pasaktësitë janë pa ndonjë pasojë.

35.11. Në lidhje me pasuritë e dhuruara shtetasit F. Gj. për të cilat gjatë hetimit administrativ u ngritën dyshime për dhurime fiktive, vlerësohet se argumentet dhe provat e paraqitura nga subjekti janë në koherencë të plotë me deklaratimet e tij dhe se dhurimi i pasurive nuk është një akt i beftë, por është rrjedhojë e disa rrethanave pararendëse si:

- rezulton e provuar se shtetasi F. Gj. ka blerë në vitin 2006 pasurinë e llojit njësi në të njëjtin objekt ku ka blerë edhe subjekti i rivlerësimit dhe nga i njëjti shitës, konkretisht pasurinë nr. ***;

- ky shtetas ka blerë së bashku me subjektin një truall me nr. pasurie *** po në vitin 2006, dhe pas heqjes dorë si një nga bashkëpronarët, pasuria është regjistruar në pronësi individuale të subjektit;

- subjekti që në vitin 2014 në deklaratimet pranë ILDKPKI-së ka deklaruar se sipërfaqet e ndodhura në katin përdhe nuk janë të tij dhe se ato posedohen nga një person tjetër;

- në përmbajtje të akt dhurimeve me datë 8.6.2016 të pasurive, është cituar se ndërtimi ka ardhur nga leja e ndërtimit 2006 marrë në emër të dhuruesit dhe se ky objekt që nga ajo kohë disponohet dhe posedohet nga shtetasi F. Gj. .

35.11.1. Këto fakte të ndodhura para procesit të rivlerësimit përputhen me deklaratimet e shtetasit F. Gj. në deklaratën noteriale redaktuar gjatë procesit të hetimit, e në këto kushte argumenti i subjektit duke iu referuar edhe qëndrimit të Kolegjit se, *deklaratat noteriale të përpiluara përgjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të provojnë një fakt të caktuar, por ato marrin vlerë kur mbështeten nga të dhëna, fakte apo indicie të dëshmuara/provuara nga dokumente të tjera, gjendet i bazuar.*

35.11.2. Gjithashtu, duke u nisur nga provat e administruara, subjekti nuk ka përfituar apo pretenduar/deklaruar të ardhura nga dy pasuritë e dhuruara. Duke qenë se ligjërisht e gjithë pasuria ishte e krijuar dhe e regjistruar në emër të subjektit (pa ndonjë dokument që provon marrëdhënie juridike me shtetasin F. Gj. për të pretenduar të drejta reale të mundshme), subjekti nuk do të kishte asnjë pengesë ligjore për t'i shitur ato duke krijuar kështu të ardhura të ligjshme. Vullneti i subjektit i shprehur që në vitin 2014 kur ka deklaruar pranë ILDKPKI-së se kati përdhe nuk i përkiste atij dhe i pasuar me veprime juridike të mëtejshme si kontratat e dhurimit, është një element thelbësor dhe nuk mund të mos merret në konsideratë në raport me deklaratimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit. Për më tepër, nuk u vërtetua që subjekti të ketë qenë në ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasin F. Gj.

35.12. Si konkluzion, në përfundim të procesit, duke u nisur nga specifika e rastit, elementet objektive dhe subjektive të arsyetuara më lart, vijueshmëria e fakteve dhe rrethanave që lidhin subjektin dhe shtetasin F. Gj., i cili nuk ka qenë një shtetas i panjohur për të, Komisioni nuk gjeti ndonjë arsye të qëllimtë të subjektit për të kryer dhurime fiktive të të dyja pasurive, duke i konsideruar këto dhurime si shprehje të lirë të vullnetit të palëve në vijim të marrëdhënieve/rrethanave të pranuar prej tyre përpara lidhjes së kontratave të dhurimit. Për rrjedhojë sqarimet e subjektit në lidhje me këtë çështje vlerësohen si bindëse.

35.13. Sa i përket të ardhurave nga shitja e pasurive nr. *** dhe nr. ***, ato janë konsideruar të ligjshme nga Komisioni pasi plotësojnë kriteret e nenit D të pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës.

36. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *kontratë shitjeje nr. ***, datë 14.9.2004, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, ***, Tropojë. Shuma: 3.500.000 lekë.* Subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje tokë bujqësore nr. ***, datë 28.2.2003, sipas së cilës i ka blerë shtetasit Q. Gj., si përfaqësues i familjes, pasurinë nr. ***, me sip. 2.463 m², në vlerën 1.000.000 lekë, pasuri të cilën më pas subjekti ia ka shitur fondacionit “****” me kontratën nr. ***, datë 19.4.2004, në vlerën 3.500.000 lekë. ZVRPP Tropojë me shkresën datë 4.8.2017 ka vërtetuar transaksionet e mësipërme. Nisur nga fakti që ZVRPP Tropojë ka konfirmuar blerjen dhe shitjen e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, rrjedhimisht janë paguar edhe detyrimet tatimore, të cilat janë konsideruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2004, ndërsa

shuma prej 3.500.000 lekësh në vitin 2004 është konsideruar si e ardhur e ligjshme duke u përfshirë në analizën financiare në periudhën para fillimit të detyrës.

37. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.5.2007, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, ***, Tropojë. Shuma: 1.000.000 lekë.* Subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 21.1.2003, sipas së cilës i ka blerë bashkëpronarëve R. një apartament me nr. pasurie ***, me sip. 48 m², i ndodhur në ***, në vlerën 700.000 lekë, si dhe ka paraqitur kërkesë për regjistrim ndarje të pasurisë nr. *** në nr. *** me sip. 26.6 m² dhe nr. *** me sip. 20.4 m². Më pas, pasurinë nr. *** ia ka shitur shtetasit U. K. me kontratën nr. ***, datë 18.5.2007, në vlerën 1.000.000 lekë, ndërsa pasurinë nr. *** ia ka shitur shtetasit I. A. me kontratën nr. ***, datë 22.5.2007, në vlerën 1.000.000 lekë.

37.1. Në DPFĐ-në e dorëzuar në datën 19.3.2008 subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 48 m² në vitin 2007 në shumën 3.300.000 lekë. Siç duket subjekti ka deklaruar këtë vlerë pasi po këtë vit ka shitur edhe një apartament tjetër me sip. 48 m² në vlerën 1.300.000 lekë, pra në total 3.300.000 lekë. Në deklaratën *Vetting* subjekti e ka deklaruar shitjen e pasurive nr. *** dhe nr. *** në shumën 1.000.000 lekë secila. ZVRPP Tropojë me shkresën e datës 4.8.2017 ka konfirmuar transaksionet me sipër, rrjedhimisht janë paguar edhe detyrimet tatimore, e në këto kushte shuma prej 2.000.000 lekësh duke i zbritur tatimin mbi të ardhurën nga shitja e pasurisë është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2007. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për kursim, blerjen e apartamentit dhe mbuluar shpenzime e tjera.

38. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.9.2011, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, ***, Tropojë. Shuma: 1.500.000 lekë.* Subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 8.11.2005, sipas së cilës i ka blerë bashkëpronarëve H. pasurinë nr. ***, lloji apartament me sip. 59 m², në vlerën 500.000 lekë, pasuri të cilën më pas ia ka shitur shtetasit A. O. me kontratën nr. ***, datë 27.9.2011, në vlerën 1.500.000 lekë. Në DPFĐ-në datë 19.3.2008 subjekti e ka deklaruar blerjen e pasurisë nr. *** në vlerën 500.000 lekë, ndërsa në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar shitjen e apartamentit me sip. 59 m² në vlerën 1.500.000 lekë. ZVRPP Tropojë me shkresën datë 4.8.2017 ka konfirmuar këto transaksione, rrjedhimisht janë paguar edhe detyrimet tatimore, e në këto kushte tatimi i paguar mbi të ardhurën nga shitja e kësaj pasurie është konsideruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011. Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e kursimit dhe blerjen e apartamentit me sip. 59 m² sipas kontratës së datës 8.11.2005 me të ardhura të ligjshme, nga ku rezultoi një balancë pozitive.

39. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *kontratë shitjeje nr. ***, datë 28.12.2007, për pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, Bajram Curri, Tropojë. Shuma: 1.300.000 lekë.* Subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 26.8.2002, sipas së cilës i ka blerë bashkëpronarëve K. pasurinë nr. ***, lloji apartament me sip. 48 m², në vlerën 800.000 lekë, pasuri të cilën më pas subjekti ia ka shitur shtetasit S. K. me kontratë nr. ***, datë 28.12.2007, në vlerën 1.300.000 lekë. Në DPFĐ-në datë 19.3.2008 subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 48 m² në vitin 2007 në shumën 3.300.000 lekë. Siç duket subjekti ka deklaruar këtë vlerë pasi po këtë vit ka shitur edhe një apartament tjetër me sip. 48 m² në vlerën 2.000.000 lekë, pra në total 3.300.000 (trajtuar më lart). ZVRPP Tropojë me shkresën datë 4.8.2017 ka konfirmuar këto transaksione, rrjedhimisht janë paguar edhe detyrimet tatimore, e në këto kushte shuma prej 1.300.000 lekësh duke i zbritur shumën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e tij është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare për vitin 2007. Nga analiza financiare subjekti ka pasur mundësi për blerjen e pasurisë.

40. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *të ardhura nga vëllezërit në Angli dhe Zvicër të dërguara me Western Union dhe dhënë dorazi nga viti 1998 deri në 2006-ën, disa depozituar në Bankën Amerikane me nr. llogarie ***, viti 2003 (llogari e mbyllur). Shuma: 40.000 USD.* Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore si akte

bankare që vërtetojnë llogari bankare të subjektit të rivlerësimit dhe formularë transfertash në Western Union për dërgesa nga vëllezërit apo të afërm të tij nga jashtë shtetit. Pas verifikimeve nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të vëllezërve B. H., M. H. (dhe bashkëshortja e tij) dhe H. H., pavarësisht se u vërtetua që ata kanë qenë të punësuar në emigracion dhe u vërtetua që t'i kenë dërguar subjektit vlera monetare. Si rrjedhojë, deri në përfundim të hetimit administrativ të ardhurat e dërguara nga vëllezërit e tij në emigracion nuk janë konsideruar si burim për blerjen e ndonjë pasurie në analizën financiare.

40.1. Në parashtrimë subjekti e kundërshtoi këtë konkluzion të Komisionit duke paraqitur disa argumente dhe dokumente shkresore në gjuhën angleze, të përkthyer, noterizuar dhe legalizuar me vulë apostile, në analizë të cilave edhe në përfundim të procesit nuk janë vërtetuar të ardhura të vëllezërve që plotësojnë kriteret e ligjit nr. 84/2016 për t'u konsideruar të ligjshme. Sikurse subjekti me të drejtë deklaroi, përfshirja e këtyre vlerave monetare në analizën financiare para emërimit në detyrë, nuk do të kishte asnjë impakt në analizën financiare të kryer me metodologjinë kumulative. Kështu, shumat e vërtetuara të dërguara nga vëllezërit nga jashtë shtetit nuk kanë asnjë ndikim jo vetëm në analizën financiare, por edhe në tërësi për gjithë procesin e rivlerësimit.

41. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja nga data 31.7.2014 – 2.6.2016. Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2014 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.11.2014. Shuma: 720.000 lekë. Subjekti ka paraqitur dy kontrata noteriale qiraje të vitit 2014 për të cilat Komisioni kreu verifikimin e të ardhurave të përfituara dhe ligjshmërinë e tyre dhe në përfundim të ardhurat nga qiratë, të kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar në shumën 425.000 lekë, janë konsideruar si të ligjshme dhe duke u përfshirë në analizën financiare të viteve kur janë paguar 2014 – 2015. Edhe sikur të mos konsiderohen këto të ardhura nga qiratë, rezultati i analizës financiare për vitet 2014 – 2015 mbetet pozitiv, pasi subjekti s'ka blerë ndonjë pasuri këto vite.

42. Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se nga data 20.3.2007 deri më 30.3.2017 ka banuar në apartamentin nr. ***, rruga “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja nr. ***, që është e njëjta adresë lagjja “****”, sot lagjja “****”, pallati nr. ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, ***. Në vijim subjekti ka deklaruar se këtë apartament pak kohë pasi e bleu motra e tij S. D. (H.) me kontratën e datës 18.5.2005 në shumën 500.000 lekë, duke qenë se motra ishte në pritje të djalit, ajo me bashkëshortin e saj vendosen të blejnë një apartament në Tiranë dhe meqenëse subjekti e pëlqente këtë apartament ka rënë dakord me motrën që ta blinte ai duke i dhënë shumën prej 500.000 lekësh nga fundi i vitit 2005, por pa kontratë kalim pronësie. Subjekti deklaroi se ky apartament *de facto* ka qenë në pronësi të tij dhe pasi i ka kërkuar motrës kalimin e pronësisë u hartua një kontratë dhurimi nr. *** në datën 29.1.2018. Subjekti sqaroi se ky apartament është deklaruar si adresë banimi në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në të gjitha deklaratat periodike më pas.

42.1. Për të provuar që subjekti ka qenë *de facto* pronar i apartamentit ka paraqitur: vërtetim nga FSHU-ja sipas të cilit kontrata që i përket apartamentit në lagjen “****” p. ***, shk. ***, ap. ***, ***, i përket abonentit Artan Hajredinaj që nga data 1.1.2007; vërtetim nga UKT-ja sipas të cilit z. Artan Hajredinaj ka kontratë uji që në vitin 2006 e në vazhdim për apartamentin në p. ***, shk. ***, k. *** ap. ***, lagjja “****”, sot ***, Bajram Curri; kontratë dhurimi nr. ***, datë 29.1.2018, me të cilën shtetasit S. D. (motra) dhe S. D. i dhurojnë subjektit apartamentin me nr. pasurie ***; certifikatë pronësie datë 7.2.2018, kartelë dhe hartë treguese, sipas të cilave apartamenti nr. *** figuron në pronësi të z. Artan Hajredinaj.

42.2. Në përfundim të hetimit pasi u konstatua se: (i) në vitin 2005 subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i paguar shumën 500.000 lekë motrës; (ii) bazuar në të gjitha provat e administruara si më sipër vërtetohet se subjekti e ka poseduar pasurinë që në vitin 2006 dhe e ka deklaruar si adresë banimi në disa nga deklaratimet periodike vjetore, nga Komisioni nuk janë ngritur dyshime për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, por atij iu kërkuan

sqarime për mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të përdorimit/posedimit të kësaj pasurie. Në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me deklarimin e adresave të banimit duke theksuar se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ishte zhvendosur nga qyteti i Bajram Currit në Tiranë (pasi kishte filluar detyrën e gjyqtarit në Lezhë në fund të vitit 2016), për të banuar në apartamentin e ndodhur në ***, Tiranë, pra nuk ishte duke e përdorur apartamentin e marrë nga motra, kalimi i pronësisë për të cilin u krye në vitin 2018. Subjekti parashtron se nëse Komisioni vëren se duhej të ishte deklaruar posedimi i saj, kjo është një pasaktësi e tij në mënyrën e të plotësuarit të deklaratës *Vetting* por që nuk dëshmon asnjë përpjekje për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë e me qëllim pasurinë në përdorim, pasi sikurse është evidentuar edhe nga Komisioni nuk rezulton mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

42.3. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerëson se në përputhje me ligjin subjekti duhej të deklaronte posedimin e pasurisë në deklaratën *Vetting*, pasi siç rezulton nga faktet e evidentuara gjatë procesit të hetimit si dhe nga vetë deklaratimet e subjektit kjo pasuri ka qenë *de facto* në pronësi të tij që nga viti 2006, pra para fillimit të detyrës. Por referuar rrethanave: (i) u vërtetua që në periudhën e plotësimit të deklaratës *Vetting* subjekti ka banuar realisht në Qesarakë, Tiranë, pasi në nëntor të vitit 2016 ishte transferuar si gjyqtar në Lezhë, pra realisht nuk ishte duke e përdorur apartamentin e përfutur nga motra në Bajram Curri; (ii) subjekti ka deklaruar në DPV pasurinë si adresë banimi; (iii) u vërtetua se subjekti ka justifikuar pagesën e shumës 500.000 lekë në vitin 2005 me të ardhura të ligjshme; (iv) në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka dhënë deklarime të detajuara si dhe dokumentacion shkresor në lidhje me apartamentin; (v) gjatë hetimit administrativ nuk u ngritën dyshime për fshehje pasurie, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, mosdeklarimi i posedimit të pasurisë në deklaratën *Vetting* nuk mund të ngrihet në atë nivel sa të kualifikohet sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës si pamjaftueshmëri në deklaram.

43. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka kryer deklarime dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore që kanë lidhje me dy pasuri të blera nga vëllezërit e tij, për të cilat nga Komisioni është kryer një numër i konsiderueshëm veprimesh hetimore (trajtuar në vijim).

44. Në lidhje me apartamentin e blerë nga vëllai B. H., u konstatua se ky shtetas me prokurë të përgjithshme nr. ***, datë 31.7.2007, ka autorizuar subjektin ndër të tjera edhe për blerje dhe dhënie me qira pasurie. Sipas kontratës nr. ***, datë 5.11.2010 shtetasi B. H. i përfaqësuar nga z. Artan Hajredinaj, i ka blerë shtetasit I. B. një apartament me nr. pasurie ***, me sip. 106.8 m², ndodhur në ***, Tiranë, në çmimin 7.800.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë datë 20.7.2010 apartamenti figuron në pronësi të shitësit dhe sipas certifikatës datë 17.11.2010 apartamenti u me regjistruar në pronësi të blerësit B. H.. Sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 27.10.2014, qiradhënësi B. H. i përfaqësuar me prokurë nga z. Artan Hajredinaj i jep qira apartamentin nr. *** shtetasit J. Xh. kundrejt shumës 25.000 lekë në muaj. Pas verifikimeve, në përfundim të hetimit administrativ, nuk u vërtetuan të dhëna për lidhje të mundshme të subjektit të rivlerësimit me këtë apartament, me përjashtim të faktit që ai ka përfaqësuar vëllain e tij për blerjen dhe dhënien me qira të saj, e për rrjedhojë nuk janë ngritur dyshime në lidhje me këtë pasuri.

45. Në lidhje me apartamentin në pronësi të vëllait H. H. në ***, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se ka prenotuar për vëllain H. H. një apartament në Shëngjin me kontratë sipërmarrjeje datë 12.12.2007, duke dhënë shpjegimet përkatëse dhe dokumente shkresore. Po kështu, ka deklaruar që e ka përdorur këtë apartament gjatë pushimeve verore, konfirmuar edhe nga vëllai i tij me deklaratë noteriale të paraqitur në përgjigje të pyetësorit standard¹¹.

¹¹ Gjatë hetimit janë administruar dy denoncime anonime që kanë pasur lidhje me këtë pasuri ku janë ngritur pretendime për marrëdhëniet e subjektit me administratorin e shoqërisë ndërtimore të pallatit ku ndodhet apartamenti.

45.1. Nga deklaratimet dhe aktet bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard, rezultoi se:

45.1.1. Me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., *** kol., datë 12.12.2007, subjekti në cilësinë e palës porositëse ka porositur një apartament pranë shoqërisë “***” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi A. N., në të cilën është pasqyruar se *apartamenti porositet nga H. H. i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP-në Lezhë.* Objekti i kësaj kontrate është një apartament me sip. 72 m² i ndodhur në ***, Lezhë, në vlerën 30.000 euro, ku kësti i parë prej 15.000 euro është likuiduar paraprakisht dhe diferenca do të paguhet në janar të vitit 2008. Siç vërehet në këtë veprim juridik subjekti ka përfaqësuar vëllain e tij para noterit dhe para shoqërisë pa një akt përfaqësimi.

45.1.2. Sa i takon mënyrës së likuidimit të çmimit të shitjes, subjekti sqaron se: (i) Ai ka paguar këstin e parë në shumën 15.000 euro në datën 12.12.2007, duke paraqitur një mandatpagesë me përshkrimin “Artan Hajredinaj për H. H. H.”. Shuma 10.000 euro është dërguar nga i vëllai nëpërmjet vëllait tjetër M. H. dhe familjarëve të tij, ndërsa shumën prej 5.000 euro e ka siguruar vetë. Në datën 21.12.2007 bashkëshortja e z. H. H., shtetasja anljeze T. W., i ka dërguar shumën prej 4.804 euro; (ii) Likuidimet e dy kësteve të tjera në shumën 8.000 euro datë 21.3.2008 dhe 7.000 euro datë 24.6.2008, janë kryer nga vetë vëllai i tij, duke paraqitur mandatpagesa të cilat janë lëshuar në emër të z. H. H..

45.1.3. Subjekti vijon të deklarojë se kontrata përfundimtare e shitjes nga vëllai i tij u lidh në vitin 2019 për shkak se pasuria ishte e bllokuar në hipotekë. Subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes nr. *** kol., datë 5.1.2019, sipas së cilës shtetasi H. H. ka blerë tek shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues E. N. (ka ndryshuar administratori) apartamentin nr. *** me sip. 70.075 m² i ndodhur në ***, Lezhë, në vlerën 30.000 euro, shumë e cila është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 12.12.2007. Sipas vërtetimit hipotekor datë 8.1.2019 pasuria figuron në pronësi të shtetasit H. H. , me shënim “Origjina nr. hip *** datë 27.10.2008”.

45.1.4. Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.8.2018, shtetasi H. H. (H.) deklaroi se në datën 30.11.2007 ka marrë një kredi në Bankën Barclays në Angli dhe i ka dërguar në Shqipëri vëllait Artan Hajredinaj për blerjen e një apartamenti ndërsa këstin e dytë e ka paguar vetë. Paratë i ka dërguar dorazi nëpërmjet personave që kanë udhëtuar nga UK. Ndër të tjera, shtetasi H. H. deklaroi se *për herë të parë pas vitit 1998 ka ardhur në Shqipëri në mars të vitit 2008 dhe se ka ardhur disa herë në Shqipëri, por nuk ka qenë e mundur të nënshkruajë vetë kontratën përfundimtare për shkak të vonësive të regjistrimit të objektit në ZVRPP pasi ka qenë i bllokuar nga gjykata.*

45.1.5. Subjekti ka paraqitur disa kopje dokumentesh në gjuhën angleze sipas të cilave duket se shtetasi H. H. duket të ketë marrë një kredi në shumën 15.000 GBP, me këst 358,57 GBP në dhjetor të vitit 2007 pranë Bankës Barclays, si dhe një ekstrakt të një llogarie bankare po pranë kësaj banke nëpërmjet së cilës subjekti do të vërtetojë pagesën e kësteve të kredisë, duke theksuar pagesën e shumës prej 358.57 GBP datë 3.10.2008.

45.2. Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit subjekti ka dhënë shpjegime e ka paraqitur dokumente shkresore, në analizë të të cilave u evidentua se: (i) vëllait të subjektit i është aprovuar një kredi konsumatore në shumën 15.000 GBP sipas njoftimit të bankës në datën 30.11.2007. Në ekstraktin bankar të llogarisë në emër të shtetasit H. H. në Bankën Barclays, nuk identifikohet disbursimi i shumës prej 15.000 GBP. Sipas ekstraktit bankar, duket se në prill dhe tetor 2008 janë kryer pagesa në shumën 358.57 GBP nga llogaria e tij (që korrespondon me shumën e këstit të përcaktuar në marrëveshjen e kredisë), por nga ana e Komisionit nuk mund të vlerësohet se këto pagesa lidhen me kredinë; (ii) nga dokumentacioni i depozituar për të ardhurat nga punësimi i vëllait të subjektit, duket se gjatë viteve 2003 – 2008 janë paguar kontribute për punësimin e tij në Angli, por nuk është e qartë sa kanë qenë të ardhurat e tij në këto vite dhe për këtë arsye Komisioni është në pamundësi për të kryer një vlerësim të mundësive financiare për kursim dhe blerje të apartamentit në Shëngjin; (iii) për sa i përket mënyrës së vënies në dispozicion të subjektit të shumës prej 10.000 euro, pjesë e totalit

prej 15.000 euro të paguar nga subjekti për këstin e parë të apartamentit në emër të vëllait të tij në datën 12.12.2007, është e paqartë se nga kush dhe kur i është vënë në dispozicion kjo shumë *cash* subjektit si dhe përse kjo shumë nuk i është transferuar në rrugë bankare subjektit por i janë dhënë *cash*.

45.3. Në lidhje me çmimin e apartamentit krahasuar me çmimet e EKB-së, u konstatua se sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e *** është 68.482 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Në rastin konkret çmimi i referencës për apartamentin objekt verifikimi rezulton 68.482 lekë/m² x 70.075 m², në total 4.798.876 lekë ose 39.690 euro sipas kursit zyrtar të vitit 2007, pra rezulton se apartamenti i porositur nga subjekti në shumën prej 30.000 euro sipas kontratës së datës 12.12.2007, është më lirë se çmimi i referencës.

45.4. Sipas informacionit të përcjellë nga FSHU-ja, rezulton një kontratë me nr. ***, në instancën Shkodër/Lezhë, me datë çeljeje 31.7.2008, me shënimin “Ndryshim emri nga Artan Hajredinaj në H. H. në datën 7.9.2017”.

45.5. Lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe administratorin e saj A. N. , Komisioni kreu disa verifikime të trajtuara hollësisht në rubrikat “Vlerësimi i figurës” dhe “Vlerësimin e aftësive profesionale”.

45.6. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar fakteve: (i) subjekti e ka përdorur pasurinë rregullisht gjatë muajve të verës dhe nuk ka deklaruar përdorimin në deklaratën *Vetting*; (ii) subjekti ka porositur apartamentin në vitin 2007 pa pasur prokurë përfaqësimi nga vëllai H. H. ; (iii) lidhja e kontratës përfundimtare të shitjes nga vëllai i subjektit është bërë në vitin 2019, pra rreth 11 vite më vonë pasi pasuria ishte regjistruar në pronësi të shoqërisë ndërtimore në vitin 2008 dhe pa barrë hipotekore; (iv) nuk u vërtetuan të ardhurat e ligjshme të vëllait H. H. për blerjen e pasurisë në shumën 30.000 euro, pasuri e cila është blerë më lirë se çmimi referencë i EKB-së; (v) kontrata e energjisë elektrike është lidhur në vitin 2008 në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është ndryshuar në vitin 2017 duke kaluar në emër të vëllait të tij; (vi) nga të dhënat e administruara rezulton që shtetasi A. (A.) L. (N.) me të cilin subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në datën 12.12.2007, ka qenë i proceduar penalisht që në vitin 2005 dhe është dënuar nga Gjykata e Apelit Milano me 10 vjet heqje lirie për një vepër penale të kimit të organizuar (trafikim ndërkombëtar narkotikësh); (vii) subjekti i rivlerësimit ka refuzuar lejimin e ekstradimit të shtetasit A. L. alias A. N. në kundërshtim me provat dhe ligjin, duke e favorizuar atë, janë ngritur dyshime për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, apartament në Shëngjin, porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k. dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime e dokumente në lidhje me konstatimet e mësipërme për të vërtetuar se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

45.7. Në parashtrimet e veta subjekti ka dhënë deklaramë e argumente në lidhje me konstatimet e Komisionit me disa dokumente shkresore bashkëlidhur, duke bërë interpretimet ligjore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe ka paraqitur një analizë të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” të Kodit Penal dhe ligjeve nr. 9049, datë 10.4.2003, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005. Në mënyrë të përmbledhur subjekti pretendon se apartamenti në Shëngjin e përdorur nga ana e tij vetëm për pushime verore dhe në mirëbesim të plotë me vëllain nuk është një pasuri e fshehur e tij por është e vëllait të tij, e fituar përmes kontratës së porosisë të vitit 2007 dhe kontratës së shitjes së vitit 2019, në respektim të plotë të nenit 850 e vijues të Kodit Civil dhe me burime të justifikuara financiare. Sipas subjektit, dokumentacioni ligjor i hartuar lidhur me këtë pasuri,

pra kontratat e porosisë dhe ajo e shitjes janë tërësisht të vërteta dhe përfaqësojnë situatën ligjore dhe faktike të kësaj pasurie.

45.7.1. Pasi ka shqyrtuar parashtrimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e tij si vijon:

45.8. Në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të pasurisë në deklaratën *Vetting*, në parashtrime subjekti, i cili ka paraqitur disa argumente në lidhje me dyshimet që ka ngritur Komisioni, sqaron se nuk ka qenë i vetmi që e ka përdorur apartamentin gjatë verës, pasi është përdorur për pushime edhe nga dy vëllezërit e tjerë. Sipas tij, ai ka shkuar në Shëngjin me familjen vetëm për pushime, sikurse ka shkuar edhe në Vlorë, ***, Sarandë dhe në Turqi, duke shpjeguar se nuk ka hasur as në praktikën e Komisionit që subjektet të deklarojnë në deklaratat vjetore vendet ku kanë qëndruar për pushime, pra hotelet, apartamentet, etj. Për këtë arsye nuk e ka deklaruar përdorimin e apartamentit për pushime vjetore sikurse nuk ka deklaruar përdorimin e vendeve/adresave ku ka qëndruar për pushime në qytete të tjera, brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke e deklaruar këtë fakt vetëm kur i është kërkuar në pyetësorin standard të vitit 2020. Subjekti citon deklarimin në përgjigje të pyetësorit standard: *“...nga viti 2008 deri në momentin e dorëzimit të përgjigjeve të pyetësorit gjatë periudhës së verës dhe konkretisht gjatë muajit gusht të çdo viti kam qëndruar për një periudhë 10-15 ditore në apartamentin e vëllait tim H. H. i ndodhur në ***, Lezhë”*.

45.8.1. Në përfundim të procesit Komisioni arsyeton se apartamenti në Shëngjin është porositur në datën 12.12.2007, pasi subjekti kishte filluar detyrën si gjyqtar në Tropojë të cilën e ka ushtruar deri në datën 4.11.2016 (pra ka banuar në Tropojë), rrethanë kjo që hedh dritë mbi përdorimin e përkohshëm nga subjekti gjatë muajve të verës, konkretisht gjatë muajit gusht që është periudhë lejesh vjetore, sikurse subjekti pretendon dhe ka deklaruar që me kthimin e përgjigjeve të pyetësorit standard. Për më tepër, gjatë hetimit janë vërtetuar marrëdhënie të vijueshme, të ngushta e specifike të subjektit me vëllain H. H. , i cili nuk ka banuar në Shqipëri (dhe jo vetëm me të), konfirmuar edhe me deklaratimet ndër vite, ku në jo pak raste subjekti i referohet të ardhurave të vëllezërve dhe marrëdhënieve me ata për shkak të dërgesave të parave herë pas here prej tyre. Veç kësaj, duke qenë korrekt me pyetjen përkatëse të pyetësorit standard, në përgjigje të këtij pyetësi subjekti ka deklaruar se: *“Nga viti 2008 deri në momentin e dorëzimit të përgjigjeve të pyetësorit gjatë periudhës së verës dhe konkretisht gjatë muajit gusht të çdo viti kam qëndruar për një periudhë 10-15 ditore në apartamentin e vëllait tim H. H. i ndodhur në Shëngjin, Lezhë”*. Në këto kushte, si dhe referuar faktit që nuk u vërtetuan dyshimet për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit (arsyetuar në vijim), u vlerësua se në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka pasur detyrimin për deklarimin e përdorimit të pasurisë vetëm për pushime në periudhën e verës, kryesisht gjatë muajit gusht, periudhë gjatë së cilës ka përdorur edhe vendqëndrime të tjera dhe për të cilat nuk ka pasur detyrimin për deklarim.

45.9. Në lidhje me faktin që nuk ka pasur një prokurë përfaqësimi nga vëllai gjatë hartimit të kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007, subjekti parashtron se ky fakt është i vërtetë, por kjo rrethanë ka ardhur për shkak se vëllai nuk ndodhej në atë periudhë në Shqipëri, i larguar që prej vitit 1998, dhe për shkak të mungesës së dokumenteve dhe pasaportizimit të kohës ai nuk ka pasur mundësi të vinte në Shqipëri për të nënshkruar kontratën. Për të vërtetuar këtë fakt ka paraqitur të dhëna të sistemit TIMS si dhe dokument identiteti të shtetasit H. H. lëshuar më 7.3.2008, pra pas datës 12.12.2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes. Subjekti argumenton se vëllezërit kanë pasur një marrëdhënie të shkëlqyer me njëri-tjetrin dhe vazhdojnë ta kenë ashtu si edhe me vëllezërit e tjerë që jetojnë jashtë shtetit dhe se ai është i vetmi në Shqipëri që mund t’u gjendet e të kujdeset për çdo gjë që duan të kryejnë në Shqipëri që e kanë të pamundur ta kryejnë vetë. Subjekti i referohet nenit 78 të Kodit Civil “Përfaqësimi pa tagër”, i cili parashikon se: *“Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi, si dhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagrat që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç*

kur ky e ka miratuar atë më vonë. Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi”. Në këtë mënyrë, subjekti duke iu referuar pagesave të kryera prej vëllait H. H. si pronar i kësaj pasurie, kontratës së blerjes prej tij të pasurisë të vitit 2019 dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.8.2018, ku shtetasi H. H. ka pranuar pronësinë duke deklaruar se apartamenti është shfrytëzuar nga subjekti gjatë periudhës së verës që ai nuk është në Shqipëri, pretendon se kontrata e sipërmarrjes është miratuar nga vëllai i tij.

45.9.1. Në përfundim të procesit, nga deklaratimet e subjektit dhe dokumentet që ai ka vënë në dispozicion provohet që shtetasi H. H. ka jetuar prej vitesh në Angli dhe në ditën kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes ka qenë në pamundësi objektive për të qenë prezent. Po kështu, për shkak se nuk ka qenë i pajisur me dokument identiteti në Angli me të cilin është pajisur në mars të vitit 2008, duket se ka qenë në pamundësi për të lëshuar një prokurë përfaqësimi për vëllain e tij, subjektin e rivlerësimit. Po kështu, në interpretim të nenit 78 të Kodit Civil, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka qenë një përfaqësues pa një prokurë përfaqësimi (pa tagër) i vëllait të tij H. H. në lidhjen e kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007, ky i fundit ka miratuar veprimin juridik të kryer prej subjektit pasi në mënyrë konkludente ka shfaqur vullnetin për porositjen e apartamentit nëpërmjet kryerjes se pagesave për blerjen e tij (vërtetuar me mandatpagesat nr. ***, datë 21.3.2008 dhe nr. ***, datë 24.6.2008), si dhe ka nënshkruar kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë në vitin 2019, duke përmbushur një nga kushtet e kontratës së sipërmarrjes e cila parashikon se: *“Apartamenti porositet nga H. H. i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP Lezhë”*.

45.10. Në lidhje me pikëpyetjen e ngritur për kalimin e pronësisë në emër të blerësit (vëllait) 11 vite pasi pasuria ka qenë e regjistruar në pronësi të shoqërisë ndërtimore dhe pa barrë hipotekore, subjekti pretendon se nuk qëndron, pretendim i cili pjesërisht u vlerësua i bazuar referuar shkresës kthim përgjigjeje të datës 5.2.2024 të lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Lezhë, paraqitur me parashtrime. Sipas kësaj shkrese, me vendimin penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. ***, datë 12.6.2015, është vënë në sekuestro preventive mbi pasurinë nr. *** të llojit apartament regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. Pra, justifikohet kështu moskalimi i pronësisë pas vitit 2015, por mbetet e paqartë përse kontrata e shitjes nuk është lidhur përpara këtij viti. Gjithsesi, në përfundim çmohet se periudha e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes në emër të vëllait të subjektit është një zgjedhje e palëve me vullnet të lirë dhe parë në këtë këndvështrim, një rrethanë e tillë më vete, nuk mund të përbëjë shkak për dyshime që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, për më tepër që në përfundim të procesit mbeten të pavërtetuara dyshimet për një pasuri të fshehur të tij.

45.11. Në lidhje me konstatimin se apartamenti është blerë më lirë se çmimi i referencës së EKB-së, subjekti paraqiti 4 kontrata sipërmarrjeje të realizuara në vitin 2007 për pasuri të tjera të ndodhura në të njëjtën godinë dhe të lidhura me të njëjtin sipërmarrës dhe duke iu referuar çmimit të tyre parashtron se nuk mund të ketë asnjë dyshim për çmimin e blerjes së apartamentit nga vëllai, për sa kohë ka qenë vullnet i lirë kontraktor i të dyja palëve, i përputhur ky edhe me kontratat e ngjashme të paraqitura. Nga verifikimi i kontratave vërehet se janë kryer transaksione me vlerë të ngjashme me apartamentin e blerë nga vëllai i subjektit pasi për dy raste rezultuan çmimet prej 396 dhe 399 euro/m², pra më pak se çmimi i porositur nga subjekti prej 416 euro/m² dhe dy raste figuron 500 euro/m². Në këto kushte, si dhe referuar faktit që çmimi në të katërta kontratat e ngjashme është nën çmimin e referencës, në përfundim nuk mund të konkludohet se çmimi në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2007 për pasurinë objekt vlerësimi është një çmim preferencial.

45.12. Sa i takon burimit të të ardhurave të vëllait për blerjen e apartamentit, subjekti paraqiti fletëpagesa të pagave javore të vëllait H. H. në Angli për periudhën 2005 – 2007, dokumente këto në formën e kërkuar nga ligji (me vulë apostile, të përkthyer dhe të noterizuara) që vërtetojnë pagën javore të vëllait në kompani të ndryshme. Sipas tij, bazuar në

dokumentacionin e administruar, për aq dokumentacion sa ai ka mundur të sigurojë, ka provuar që vëllai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri, duke marrë parasysh edhe kredinë e marrë si dhe të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga punësimi. Subjekti sqaron se në jurisprudencën e deritanishme si të Kolegjit ashtu edhe të Komisionit, është vlerësuar se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar apo dhënë hua dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, duke sjellë në vëmendje edhe tri vendime të Kolegjit.

45.13. Në analizë të parashtrimeve dhe provave të administruara të cilat vërtetojnë të ardhurat e vëllait të subjektit në emigracion si dhe në konsideratë të faktit që Komisioni është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999, në përfundim të procesit nuk mund të arrihet në përfundimin se z. H. H. ka qenë në pamundësi financiare për të blerë apartamentin. Konkretisht: (i) sipas fletëpagesave javore të pagave rezultoi se për periudhën 2005 – 2007 të ardhurat neto të përfituara janë në vlerën 20.769 GBP (nga totali prej 56 javësh që ka viti, mungojnë fletëpagesa për një numër të konsiderueshëm javësh për vitin 2005 dhe disa javë për vitet 2006 e 2007); (ii) sipas vërtetimit të lëshuar nga kompania “***” konfirmohet punësimi i z. H. me kohë të plotë për periudhën 12.9.2006 – 13.6.2014; (iii) sipas regjistrimit të kontributeve të derdhura nga z. H. H. në shtetin anglez vërtetohet pagesa e kontributeve për periudhën e punësimit 2003 – 2023. Këto fakte e prova çojnë në deduksionin se të ardhurat e ligjshme për periudhën 2003 – 2008 (kohë kur ka përfunduar edhe pagesa e apartamentit) për të cilat janë paguar tatimet dhe detyrimet ndaj shtetit janë në një vlerë më të madhe se ajo që rezulton në fletëpagesat e depozituara.

45.13.1. Bazuar në sa më sipër si dhe referuar të dhënave në lidhje me ndalesat mbi pagën bruto ku sipas fletëpagesave të depozituara ndalesat mbi pagën bruto për tatimin mbi të ardhurat dhe sigurimet shoqërore janë përkatësisht në masat 13.10% dhe 7.41%, është kryer një analizë për të vlerësuar të ardhurat e mundshme të realizuara nga z. H., nga ku rezultoi se deri në datën e kryerjes së pagesës ato janë në vlerën 57.740 GBP, pra mjaftueshëm për të paguar shumën 30.000 euro.

45.13.2. Veç sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të depozituar dokumentacion të plotë për të ardhura të ligjshme nga punësimi për të ndërën bashkëshorten e z. H., znj. T. W., për të cilën ka depozituar vetëm dy fletëpagesa ku evidentohet se pagesat javore janë ndjeshëm më të larta se e z. H., pothuaj sa 3-fishi. Për më tepër, në lidhje me bashkëshorten e vëllait, u provua nga të dhënat bankare se i ka transferuar subjektit shumën 4.804 euro, sipas subjektit për pagesën e kësteve të apartamentit, si dhe u vërtetua se në dhjetor 2007 të dy së bashku (vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij) kishin marrë një kredi konsumatore prej 15.000 GBP. Pra, sipas këtyre të dhënave duket se bashkëshortja e vëllait ka përfituar të ardhura të cilat mund të kenë shërbyer si të ardhura të tjera përveç atyre të vëllait të subjektit, që i kanë mundësuar familjes mbulimin e shpenzimeve jetike.

45.14. Lidhur me kontratën e energjisë elektrike me datë çeljeje 31.7.2008 në emër të subjektit, i cili në datën 7.9.2017 ka ndryshuar nga Artan Hajredinaj në H. H. , subjekti pretendon se ky regjistrim duhet të jetë një gabim i FSHU-së në momentin kur janë kryer regjistrimet përkatëse, që me shumë mundësi ky institucion i është referuar kontratës së sipërmarrjes, ku në dukjen e parë rezulton emri i tij, Artan Hajredinaj. Subjekti parashtron se i është drejtuar FSHU-së me kërkesë për marrjen e informacionit lidhur me këtë gabim dhe për pajisje me kopje të kontratës por FSHU-ja, me përgjigjen e datës 10.10.2023, ka sqaruar se kjo kontratë nuk rezulton më në emrin e tij dhe kopja e kontratës së lidhjes së energjisë nuk disponohet. Sa i takon këtij pretendimi, vlerësohet i drejtë pasi, siç është evidentuar edhe në raste të tjera të ngjashme nga Komisioni, lidhja e kontratave së energjisë elektrike është bërë në jo pak raste në emër të shtetasve që ishin shënuar në kontratat e porosive/sipërmarrjeve. Ndërsa në seancë dëgjimore, pasi është pyetur në lidhje me faktin se nga kush janë paguar shpenzimet e energjisë, subjekti

ka deklaruar se faturat e dritave shkonin tek shtëpia në Shëngjin, Lezhë dhe se, me sa mban mend, duhet të jenë paguar nga vëllezërit kur vinin në Shqipëri. Ky deklarim vlerësohet i arsyeshëm në kushtet kur u vërtetua që subjekti deri në fund të vitit 2016 ka jetuar në Tropojë (më pas në Tiranë).

45.15. Sa i takon konstatimeve në lidhje me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k. A. L. alias A. N. i cili ka qenë person me precedentë penalë në vitin 2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes për apartamentin e vëllait në Shëngjin, subjekti parashtrroi se nuk ka pasur asnjë njohje personale dhe se në atë periudhë ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ku nuk ka trajtuar çështje gjyqësore me palë pjesëmarrëse shoqërinë ndërtimore apo administratorin e saj. Po kështu, subjekti ka dhënë sqarime e dokumente në lidhje me trajtimin e një çështjeje me objekt ekstradimin e shtetasit A. N. alias L., për të cilin janë ngritur dyshime për favorizim nga ana e tij si gjyqtar i çështjes në vitin 2019, duke pretenduar se nuk e ka favorizuar këtë shtetas. Siç rezultoi në përfundim të procesit, u vërtetua se: (i) në kohën e porositjes së apartamentit (dhe jo vetëm) nuk vërtetohet që subjekti të ketë pasur njohje me administratorin e shoqërisë apo të ketë trajtuar çështje ku ai dhe shoqëria të kenë qenë palë në gjykime; (ii) nuk vërtetohet që subjekti të ketë favorizuar shtetasin A. L. alias A. N. (trajtuar hollësisht gjatë vlerësimit të aftësive profesionale dhe figurës).

45.16. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit çmohet se subjekti ka arritur të japë sqarime bindëse bazuar në fakte e dokumente në lidhje me rrethanat që kane çuar Komisionin në dyshime për një pasuri të mundshme të fshehur të tij mbi apartamentin në Shëngjin në pronësi të vëllait H. H. , duke vërtetuar se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

46. Në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 19.3.2008, subjekti ka deklaruar depozitë të përbashkët me vëllain e tij pranë Bankës Kombëtare të Greqisë në shumën 500 euro dhe pjesëmarrës 50%. Gjatë pyetjes nga ILDKPKI-ja në vitin 2014, subjekti deklaroi se depozita është në shumën 5.000 euro dhe jo 500 euro sa është deklaruar. Në dokumentacionin bashkëngjitur shkresës së ILDKPKI-së, nuk gjendet informacioni bankar në lidhje me balancën prej 5.000 euro, e në këto kushte ka qenë e paqartë se në cilën llogari ka qenë balanca në shumën 5.000 euro të deklaruar nga subjekti në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së. Me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkua subjektit të japë sqarime dhe dokumentacion shkresor në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se pas konsultimit me dokumentin bankar, ka vërejtur se në këtë llogari ka pasur lëvizje deri në datën 17.8.2007. Nga kjo datë e deri në fund të dhjetorit 2007, balanca ka qenë në vlerën 104 euro. Pas kësaj date dhe në vijim nuk ka pasur as shtesa apo depozitime të parave dhe as tërheqje të tyre. Meqenëse veprimet e tij në këtë llogari nuk kanë qenë as të shumta në numër dhe as periodike, kur është pyetur nga ILDKPKI-ja me shumë gjasa nuk ka mbajtur mend se sa është balanca e kësaj llogarie, në të cilën kishte bërë jo më shumë se 2 veprime, mbi 7 vite më parë, ose ka qenë një konstatim i pasaktë i inspektorit të ILDKPKI-së. Në analizë të të dhënave bankare të administruara, rezultoi se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe shteruese.

47. Analiza financiare

47.1. Nga analiza financiare e kryer me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, në përfundim të hetimit administrativ ka rezultuar se: (i) Sa i takon periudhës para fillimit të detyrës 1998 – 20.3.2007, nga analiza kumulative rezultoi një balancë negative prej 4.293.960 lekësh; (ii) Sa i takon periudhës nga emërimi në detyrë datë 20.3.2007 deri në datën 31.12.2016, pamundësia totale e subjektit (shuma e viteve me balancë negative) është 14.278.515 lekë. Në parashtrimet e veta subjekti ka kundërshtuar analizën financiare duke pretenduar se bazuar në të gjitha provat e administruara si gjatë hetimit administrativ ashtu edhe pas kalimit të barrës së provës ka vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

47.2. Në mënyrë të përmbledhur në lidhje me analizën financiare përpara fillimit të detyrës pretendon se në analizën financiare të kësaj periudhe duhen bërë ndryshimet si vijojnë:

- Duhet shtuar në rubrikën e pasurive, pasuria “vreshtë me sip. 586,4 m²” blerë në vlerën 500.000 lekë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.6.2006” si dhe pasuria “vreshtë me sip 12.117 m²” blerë në vlerën 1.000.000 lekë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.6.2006.

- Në rubrikën e të ardhurave duhet përfshirë shuma prej 12.392.800 lekësh e përfituar nga shitja e dy tokave vreshtë në datën 9.10.2006.

- Në lidhje me të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni për shkak se ato janë marrë dhe kthyer para detyrës, efekti në analizën kumulative është 0 (zero).

- Për sa i përket shpenzimeve, subjekti kërkon që vlera e investimit për shtesën e njësisë në Bajram Curri të përfshihet në analizë sipas aktit të vlerësimit të hartuar nga inxhinieri, në vlerën 2.195.731 lekë, shumë kjo e shpenzuar për periudhën e lejes së ndërtimit brenda vitit 2007 dhe jo deri në vitin 2008 sikurse ishte përlllogaritur nga Komisioni. Gjithashtu subjekti ka llogaritur si shpenzim edhe pagesën e tatimit në burim për shitjen e vreshtave në vlerën 293.566 lekë.

47.2.1. Në lidhje me periudhën në detyrë 20.3.2007 – 2016, në mënyrë të përmbledhur subjekti pretendon se në analizën financiare të kësaj periudhe:

- Komisioni duhet të përfshijë në rubrikën e të ardhurave nga periudhat e kaluara shumën e barabartë me pagesën e kësteve për apartamentin e Tiranës, 10.000 euro në datën 26.3.2007 dhe 10.000 euro në datën 22.8.2007 me burim të ardhurat nga shitja e vreshtave.

- Duhet përfshirë të ardhurat nga qiraja për vitet 2014, 2015 dhe 2016 në shumën 528.000 lekë, derisa është provuar marrëdhënia e qirasë dhe pagesa e tatimit në burim.

- Në rubrikën e shpenzimeve duhet hequr shuma 13.000 euro e konsideruar nga Komisioni si shpenzim më vete, për apartamentin e Tiranës me sip. 113 m². Kjo shumë është provuar të jetë pjesë e shumës prej 34.510 euro e cila është marrë me kredi, si dhe shpenzimet jetike të nënës të barazohen me pensionin e saj meqenëse një person nuk mund të shpenzojë më shumë sesa të ardhurat që ai përfiton.

47.2.2. Subjekti sjell në vëmendje zbatimin e parimit të proporcionalitetit duke referuar dhe disa praktika të Komisionit dhe të Kolegjit.

47.3. Pasi janë analizuar pretendimet e subjektit rast pas rasti, sikurse është arsyetuar në këtë vendim dhe pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e tij, në përfundim Komisioni ka vendosur të pasqyrojë në analizën financiare të rishikuar për periudhën para detyrës: dy pasuritë e llojit vreshtë në shumën 1.500.000 lekë; të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre pasurive në vlerën 12.392.800 lekë; shpenzimin për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat nga shitja e vreshtave në vlerën 293.566 lekë, si dhe vlerën e investimit për shtesën e njësisë në *** në shumën 6.720.969 lekë. Si periudhë investimi është konsideruar 6.12.2006 – 28.2.2007. Për pasojë, për periudhën para detyrës subjekti ka rezultuar me balancë pozitive.

47.3.1. Në lidhje me periudhën pas detyrës, Komisioni përfshiu si të ardhur nga periudhat e kaluara shumën prej 2.077.302 lekësh e cila rezultoi si mundësi kursimi pas përfitimit të të ardhurave nga shitja e vreshtave në vlerën 12.392.800 lekë për periudhën deri në 20.3.2007. Gjithashtu Komisioni ka marrë në konsideratë edhe pretendimin në lidhje me shpenzimet e mobilimit në shumën 13.000 euro pasi nga sa është arsyetuar në këtë vendim, kjo shumë është pjesë e shumës prej 34.510 euro e cila është marrë me kredi të përdorur për punime ndërtimore dhe mobilim.

47.3.2. Për sa i përket të ardhurave nga qiratë, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për shkak të mospërputhjeve të vlerave të deklaruara, por ka saktësuar shumën e përfshirë në analizën financiare e cila nga 125.000 lekë duhej 425.000 lekë. Për sa i përket pretendimit për shpenzimet jetike të nënës të përfshira në analizën financiare për periudhën pas detyrës, Komisioni nuk mori në konsideratë pretendimin e subjektit se ato duhen barazuar me të ardhurat nga pensioni, pasi ky argument nuk mbështetet në dokumentacion.

Shpenzimet jetike të nënës të përlllogaritura vetëm për periudhën pas detyrës janë pasqyruar sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit. Në përfundim sipas analizës financiare të rishikuar për periudhën pas detyrës, subjekti ka rezultuar me balancë negative në vlerën -271.379 lekë, e cila nuk vlerësohet penalizuese.

KONTROLLI I FIGURËS

48. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj. Në vijim AKSIK-ja ka informuar se Grupi i Punës thelloi më tej verifikimet mbështetur në kërkesën e Komisionit dhe ka përcjellë raportin nr. ***, datë 22.1.2024, të deklasifikuar pjesërisht, në përfundim të të cilit e lë konkluzionin në vlerësimin e Komisionit. Nga Komisioni u verifikuan informacionet pranë organeve ligjzbatuese dhe u kërkuan dosjet penale për të cilat kishte të dhëna për subjektin (trajtuar te kriteri profesional). SPAK ka informuar se në emër të z. Artan U. Hajredinaj është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2021, për të cilin pas verifikimeve është vendosur mosfillim procedimi.

48.1. Në lidhje me shtetasin A. (A.) L. (N.), administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., me të cilin në vitin 2007 subjekti ka lidhur një kontratë në emër të vëllait H. H. , pas disa verifikimeve të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ u vërtetua se ky shtetas është person i përfshirë në krimin e organizuar që në vitin 2007. Pas verifikimeve në sistemin TIMS nuk ka të dhëna për udhëtime të subjektit me këtë shtetas. Po kështu nuk ka pasur të dhëna të tjera të marra në rrugë ligjore për kontakte të çdolloji të subjektit me këtë shtetas. Në kushtet kur i vetmi kontakt i vërtetuar i tyre është ai gjatë lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me datë 12.12.2007, në përfundim të hetimit administrativ nuk është vlerësuar që subjekti ndodhet në kushtet e kontaktit të papërshtatshëm me këtë shtetas.

48.2. Në lidhje me shtetasin Y. D., i cili është pronar i një automjeti të përdorur në një rast nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2017, pas disa verifikimeve të trajtuar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit u konstatua se ky shtetas është proceduar penalisht në vitin 2006 për veprën penale “Krimi i organizuar”, por gjykata e shkallës së parë në vitin 2008, me vendim të lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë në vitin 2010, ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, në veprën penale “Vjedhje në formën e bashkëpunimit të thjeshtë”, që nuk është vepër e përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, nuk rezultoi që subjekti të ndodhej në kushtet e kontaktit të papërshtatshëm me këtë shtetas.

48.3. Bazuar në sa më sipër dhe pas analizimit të dosjeve të administruara sipas informacioneve të marra nga institucionet ligjzbatuese, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

49. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan U. Hajredinaj, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me nr. *** prot., datë 18.7.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 20.7.2018; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

49.1. Raporti për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që e shoqërojnë atë; (ii) 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Në përfundim, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit si vijon:

Për aftësitë profesionale

a) *Njohuritë ligjore*: Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit material, ndonëse njohuritë e tij procedurale kanë nevojë të përmirësohen. Ai përgjithësisht identifikon normën ligjore të zbatueshme. Në procesin penal, analizon me kujdes veprën penale dhe kur jep vendim fajësie, përpiqet të identifikojë masën e përshtatshme të dënimit, duke pasur njohuri edhe për alternativat e dënimit me burgim. Subjekti ka njohuri të përgjithshme për procedurën e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore civile dhe penale. Evidenton rastet, kur për zgjidhjen e çështjes kërkohen njohuri të posaçme me ekspertë por nuk është rigoroz në procedurën e caktimit të ekspertit. Ai duhet t’i kushtojë më shumë rëndësi hapave proceduralë në raport me rregullat ligjore. Nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve janë konstatuar edhe të meta: në një rast për përcaktimin e vendbanimit të të miturit, në vendim nuk shprehet nëse është zbatuar neni 6 i Kodit të Familjes për pyetjen dhe dëgjimin e fëmijës së mitur 6 vjeç e 6 muaj, në praninë e detyrueshme të psikologut. Në një rast tjetër për zgjidhje martesë, nuk ka zbatuar nenet 2, 6 dhe 155 të Kodit të Familjes për thirrjen e marrjen e mendimit nga psikologu për të përcaktuar ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së mitur. Në caktimin e seancës së parë gjyqësore civile apo penale nuk zbaton rregullat që garantojnë njoftimin në kohën e duhur të palëve të përcaktuara nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale apo nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile. Për çdo hap gjatë gjykimit, ai shprehet me vendime të ndërmjetme, por në disa raste vendimet e ndërmjetme janë pa referenca ligjore. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Artan Hajredinaj janë paraqitur 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga shqyrtimi administrativ i të cilave nuk kanë rezultuar të dhëna negative.

b) *Arsyetimi ligjor*: Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme me arsyetim ligjor në përgjithësi brenda standardit të procesit të rregullt ligjor. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe i shërben funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e legjislacionit. Arsyetimi i vendimit i jep përgjigje pretendimeve kryesore të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Ai bën pjesë të arsyetimit të vendimit edhe formulime standard mbi çështje procedurale, të cilat jo vetëm nuk janë kundërshtuar nga palët, por edhe janë çështje të cilat i përkasin praktikës gjyqësore konstante (juridiksioni, kompetenca apo edhe gjykimi i shkurtuar). Ai identifikon normën e zbatueshme dhe e analizon atë në raport me faktin e mosmarrëveshjes të përcaktuar sipas provave të shqyrtuara. Në analizën për caktimin e masës së dënimit dhe pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në shërbimin e provës, rrethanat lehtësuese paraqiten në mënyrë të përgjithshme dhe jo të detajuara, duke treguar provat që i mbështesin ato. Në 1 rast nuk arsyetohen se cilat janë arsyet që datëlindja e një dokumenti shkollor ka përparësi për korrigjimin e moshës mbi datëlindjen e një akti zyrtar të gjendjes

civile. Ndërsa në 1 rast tjetër, konkluzioni për të drejtën prindërore dhe masën e detyrimit për ushqim të fëmijës së mitur pas zgjidhjes së martesës është caktuar apriori, pa marrë në shqyrtim mendimin e psikologut dhe provat e duhura.

Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponimet janë të plota mbi objektin e mosmarrëveshjes dhe kërkimet dytësore. Në dispozitiv tregohet e drejta e ankimit për palët dhe afati i tij. Tek 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se jo në çdo rast ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme.

Për aftësitë organizative

a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë:* Gjyqtari Artan Hajredinaj ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin minimal, por përgjithësisht ka respektuar afatet në shqyrtimin e çështjeve dhe në arsytimin e vendimeve gjyqësore.

b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore:* Gjatë gjykimit, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerrë urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara mjaftueshëm për realizimin e tyre. Zhvillon procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat ligjore. Në një rast, procedura e ekspertimit nuk ka qenë e plotë, pasi eksperti i caktuar nuk është paralajmëruar dhe nuk është betuar. Në të njëjtën çështje, gjyqtari nuk ka marrë vendim formal për gjykimin në mungesë të dy të paditurve, që nuk janë paraqitur. Ndërsa në 1 çështje familjare për zgjidhje martesë, ku palët kishin fëmijë të mitur, gjyqtari nuk ka proceduar me marrjen e mendimit të psikologut sipas neneve 6 dhe 155 të Kodit të Familjes për interesin më të lartë të fëmijës së mitur nga zgjidhja e martesës, si dhe nuk ka administruar prova për caktimin e detyrimit për ushqim sipas nenit 201 të Kodit të Familjes (shihni dosjen 4). Ai kryen veprimet procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura nga palët. Ndër 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në asnjë rast çështja e gjykuar prej tij nuk është kthyer për rigjykim nga gjykatat më të larta për shkelje të procedurave gjyqësore.

c) *Aftësia për të administruar dosjet:* Është konstatuar se përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta duke u evidentuar ndonjë parregullsi procedurale e tipit organizativ.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) *Etika në punë:* Nuk janë konstatuar seanca gjyqësore të filluara me vonesë, gjykime të zvarritura përtej një afati të arsyeshëm dhe as vonesa në arsytimin e vendimeve gjyqësore.

b) *Integriteti:* Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia:* Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj. Në asnjë rast nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes apo që ai të ketë paraqitur dorëheqje nga gjykimi. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) *Aftësitë e komunikimit:* Gjyqtari Artan Hajredinaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*: Nuk janë konstatuar të dhëna direkte mbi aftësinë e tij për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta;

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*: Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka ushtruar funksionin si gjyqtar në fushën e të drejtës civile, familjare dhe penale. Ai vazhdon studimet për Master në të Drejtën Civile të Universitetit të Prishtinës, Kosovë. Për shkak të funksionit që kryen, gjyqtari Artan Hajredinaj i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 7 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë.

49.2. Subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mangësitë e konstatuara në raportin e KLGJ-së. Në parashtrimet tij subjekti deklaroi se sa i përket aftësive të tij profesionale flasin qartë vlerësimet e fundit të bëra nga KLGJ-ja duke paraqitur: vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. ***, datë 30.5.2014, sipas të cilit është vendosur vlerësimi “Shumë mirë” për periudhën 2007 – 2009; raport të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017 – 2019 sipas të cilit është vlerësuar me 91 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyer”; vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***, datë 6.7.2023, sipas të cilit është vendosur “Miratimi i raportit të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017 – 2019” duke vlerësuar: (a) aftësitë profesionale “Shkëlqyeshëm”; (b) aftësitë organizative “Shkëlqyeshëm”; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale “Shkëlqyeshëm” (ç) aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional “Shkëlqyeshëm”; niveli i përgjithshëm i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

49.3. Subjekti është ndalur më gjatë në rastin që ka të bëjë me mosparalajmërimin dhe betimin e ekspertit të caktuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. ***, datë 24.11.2013, duke deklaruar se nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh në punën e tij që të mos zbatohet nenin 224 të Kodit të Procedurës Civile. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur si provë vendimin datë 13.11.2013 i cili është pjesë e dosjes, ku në cilësinë e gjyqtarit ka vendosur caktimin e detyrave të ekspertit. Në procesverbalin e mbajtur në seancën gjyqësore të zhvilluar po në këtë datë, është shënuar: “...vendim gjykata bazuar në nenin 224, a, b, c, ç dhe nenin 225 vendosi të thërrasë ekspertin kontabël E. B.. U thirr dhe u paraqit E. B. ekspertja kontabël. ...I lexohet formula e betimit, ekspertja tha betohem dhe jep gjeneralitetet...”. Siç vërehet deklarimet e subjektit janë të vërtetuara dhe konstatimi në raportin e KLGJ-së nuk është i saktë.

49.4. Sa i takon konstatimit në çështjen me objekt zgjidhjeje martesë që u përket palëve paditës D. H. dhe e paditur N. H., sipas të cilit para marrjes së vendimit subjekti nuk ka caktuar psikolog për të pyetur fëmijën në lidhje me të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, subjekti ka parashtruar se çështjen civile me objekt “Zgjidhje martesë” ku palët gjatë gjithë procesit si në veprimet e pajtimit, ashtu edhe në seancë gjyqësore janë shprehur dakord për zgjidhjen e martesës dhe lënien e fëmijës për rritje dhe edukim nënës (të paditurës), e cila vazhdonte të kujdesej për fëmijën që në momentin që ata kishin shkëputur bashkëjetesën, e ka konsideruar si një zgjidhje martesë me marrëveshje ku nuk ekzistonte konflikti lidhur me përgjegjësinë prindërore në lidhje me fëmijën, duke marrë në konsideratë faktin që fëmija ishte e moshës 4 vjeç dhe palët nuk kishin mundësi ekonomike për të paguar psikologun. Fakt tjetër sipas tij ishte se në kohën e dhënies së këtij vendimi, nuk kanë pasur psikolog të atashuar pranë gjykatës, sepse psikologët vinin nga Tirana.

49.5. Nga Komisioni u vlerësua se qëndrojnë argumentet e subjektit në lidhje me të çmuarit se nuk kishte shumë vlerë caktimi i ekspertit pasi, subjekti ka pranuar verdiktin e palëve të cilët kishin rënë dakord lënien e fëmijës për rritje dhe edukim nënës. Në këto rrethana dhe në kushtet e mungesës së psikologeve në Gjykatën e Rrethit Tropojë, me qëllim moszvarritjen e

gjykimit, subjekti ka vlerësuar se mendimi i psikologut nuk kishte rol themelor në zgjidhjen e çështjes pasi nuk kishte konflikt lidhur me fatin e fëmijës. Edhe fakti që ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim, tregon se ai është i dakordësuar nga të gjitha palët dhe në këto kushte subjekti ka gjykuar sipas rrethanave specifike të këtij rasti dhe bindjes së brendshme.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

50. Si të tilla janë konsideruar denoncimet nga publiku në disa raste të përsëritura në përmbajtjen e tyre dhe me denoncues anonime, për të cilat pasi janë kryer verifikimet e duhura i janë kërkuar subjektit sqarime e dokumente në lidhje me denoncimet si vijojnë:

50.1 Tri denoncime nga shtetasi B. A. S.

Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me vendimin e datës 10.2.2022 të subjektit, në një çështje pronësie me palë kundërshtarë L. dhe D. K.. Sipas tij, subjekti ka thirrur një ekspert gjatë procesit gjyqësor, i cili ndërroi jetë dhe nuk arriti të relatojë ekspertizën. Më pas gjykata caktoi një ekspert tjetër ku ky i fundit i dha të drejtë denoncuesit por subjekti nuk mori në konsideratë atë por shpalli vendimin bazuar në ekspertizën e parë. Sipas denoncuesit nuk ka pasur kompetencë, si dhe gjatë periudhës së seancave gjyqësore subjekti ka kryer pushime me familjen në hotelin e palës kundërshtarë. Nuk ka paraqitur dokumentacion.

Nga ana e Komisionit u kërkuua nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosja gjyqësore me palë B. S. dhe L. K. që i përket vendimit datë 10.2.2022, e cila informoi se çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit dhe vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 10.2.2002, ku nga përmbajta e tij rezulton se në lidhje me pretendimet e ngritura mbi aktet e ekspertimit, bazuar në parashikimet e nenit 224/b të Kodit të Procedurës Civile, nuk vërehet që subjekti të ketë vepruar apo të jetë sjellë në mosrespektim të ligjit procedural pasi qëndrimin e mbajtur e ka arsyetuar sipas kërkesës së këtij neni. Në këto rrethana, pretendimet e denoncuesit si palë gjyqumbëse në thelb kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, për të cilin është ushtruar ankim dhe çështja ndodhet në gjykim në Apel. Për rrjedhojë, bazuar pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Nga verifikimi në internet rezultoi se Inspektorati i Lartë i Drejtësisë do të verifikojë vendimin e dhënë nga gjyqtari i Lezhës Artan Hajredinaj, në lidhje me këtë çështje. Subjektit iu kërkuua të japë sqarime shoqëruar me dokumentacion mbi statusin e verifikimit të nisur nga ILD-ja. Subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2024, lëshuar nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e cila vërtetonte se çështja është në fazën e shqyrtimit fillestar.

50.2. Denoncim i përcjellë nga Komisionerët Publikë (anonim)

Pretendohet se subjekti ka dhënë një vendim penal në kundërshtim me ligjin, pasi sipas tij ka dënuar shtetasin S. K. nën minimumin e parashikuar nga ligji. Bashkëngjitur ka paraqitur pjesë nga vendimi nr. ***, datë 19.6.2023, dhënë nga subjekti. Komisioni kërkoi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjen gjyqësore, që i përket vendimit nr. ***, datë 19.6.2023, me të pandehur z. S. K., gjykatë e cila vuri në dispozicion dosjen penale me objekt “Dërgimi në gjyq me nr. ***, datë 5.10.2022”, si dhe fashikullin penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Lezhë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ndër të tjera rezultoi se:

- Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore në datën 19.6.2023, prokurori ka dhënë konkluzionet përfundimtare në mënyrë verbale, duke kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit S. K. në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 406, uljen me 1/3 dhe dënimit përfundimisht me 3 vite e 4 muaj. Të aplikohet neni 59 duke e vënë në periudhë prove për kohën e mbetur.

- Sipas konkluzioneve përfundimtare të mbrojtësit, në mënyrë të përmbledhur është pretenduar se: (i) akuza e ngritur është e padrejtë dhe e pambështetur në prova, si dhe është kërkuar pushimi i çështjes, duke pretenduar në thelb që sasia është për përdorim vetjak; (ii) nga ana tjetër, është kërkuar se, në rast se gjykata ka krijuar bindjen e brendshme se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, të marrë në konsideratë rrethanat, si: i mbrojturi është i padënuar më parë, ka kërkuar gjykim të shkurtuar, pranon faktin që lënda e gjetur kalon dozën ditore për përdorim vetjak, por asnjëherë nuk ka qenë shpërndarës, shitës i lëndës narkotike, qëndrimi i tij korrekt gjatë hetimit, dënimi i tij do të ndikojë negativisht si në jetën shoqërore, ekonomike dhe psikologjike të familjes së tij; (iii) për sa i përket masës së dënimit, është kërkuar që në aplikim të nenit 53 të Kodit Penal të ulet dënimi nën kufijtë e parashikuar nga ligji etj.

- Me vendimin nr. ***, datë 19.6.2023, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarin fajtor të pandehurit S. K. për veprën penale të nenit 283/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim, në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e 1/3-ës së dënimit dhe dënimin përfundimisht me 2 vite burgim etj. Ky vendim është i formës së prerë. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se subjekti ka dhënë një dënim nën minimumin e parashikuar nga vepra penale, në aplikim të nenit 53 të Kodit Penal. Por, duke u nisur nga aktet e dosjeve, nga arsyetimi i vendimit, si dhe neni 53 i Kodit Penal, aplikimi i të cilit kërkon plotësimin e disa kërkesave, duket se vendimi i subjektit nuk është i bazuar në ligj dhe provat e administruara, si dhe është në kundërshtim me vetë arsyetimin e tij. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës mbi bazueshmërinë dhe arsyetimin e aplikimit të nenit 53 të Kodit Penal.

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se: (i) Ky vendim është i formës së prerë, në të cilin është aplikuar neni 53 i Kodit Penal, ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, për dhënien e të cilit ka gjykuar sipas provave dhe bindjes së tij të brendshme; (ii) Qëllimi i dënimit penal nuk është vetëm ndëshkimi, por njëkohësisht edhe edukimi i autorit të veprës penale. I pandehuri është hetuar dhe gjykuar nën masën e sigurimit “Arrest në burg” që nga data 22.10.2021 deri në datën 19.4.2022, kur nga Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë është vendosur masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, masë me të cilën i pandehuri është gjykuar nga subjekti; (iii) Gjatë gjithë periudhës së gjykimit, i pandehuri nuk i është shmangur hetimit, nuk ka thyer kushtet e sigurisë “Arrest në shtëpi”, nuk ka paraqitur rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë, nuk ka pasur asnjë rrethanë rënduese, masa e lëndës narkotike e sekuestruar në cilësinë e provës ka qenë shumë e vogël, sapo ka kaluar kufirin e përdorimit vetjak; (iii) Në tërësinë e të gjitha rrethanave ka vlerësuar se është përpara kushteve të parashikuara nga neni 53 i Kodit Penal, i cili ka parashikuar se aplikimi i këtij neni ka të bëjë me rrezikshmërinë e pakët të të pandehurit, si dhe me praninë e disa rrethanave lehtësuese, si dhe faktin e mospasjes së asnjë rrethane rënduese; (iv) Në këtë vendimmarrje, pavarësisht se për shkak të ngarkesës së lartë mund të ketë ceduar në arsyetimin e vendimit sa i përket kushteve të aplikimit të nenit 53 të Kodit Penal, qëllimi i të gjithë arsyetimit është vlerësimi se pse nuk është pranuar kërkesa e prokurorit për mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Duke i kushtuar shumë rëndësi këtij fakti, nuk i ka kushtuar po aq rëndësi arsyetimit të kushteve të aplikimit të nenit 53 të Kodit Penal, pasi ka vlerësuar se këto kushte plotësoheshin nga i pandehuri.

Subjekti ka paraqitur disa akte shkresore, ndër të tjera shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2024, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë mbi ngarkesën në punë në periudhën 2017 – 2023, ku evidentohet ngarkesa e lartë prej 1061 çështjesh në vitin 2022 dhe 583 çështje në vitin 2023.

Në analizë të parashtrimeve, vlerësohet se subjekti ka dhënë mjaftueshëm argumente për të justifikuar aplikimin e nenit 53 të Kodit Penal, por, sikurse dhe ai vetë e pranoi, në rastin konkret ai duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në arsyetimin e vendimit. Sa i takon ngarkesës në punë që subjekti i referohet, vlerësohet si shkak i arsyeshëm, pasi në periudhën 2022 – 2023 subjekti ka gjykuar në total 1644 çështje penale dhe civile, që është mbi mesataren sipas pikës

3, shkronja “g” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, ku gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë si relator në jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile me palë kundërshtare.

Nga ana tjetër, vlerësimi i aplikimit të nenit 53 është një e drejtë vendimmarrjeje nga ana e subjektit si gjyqtar, bazuar në rrethanat konkrete në momentin e vlerësimit, në bazë të bindjes së tij të brendshme dhe Komisioni, në bazë të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, nuk mund të gjykojë vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, vendimi është i formës së prerë, pasi as nga ana e prokurorisë nuk është ushtruar ankim. Nga ana tjetër, është vërtetuar që në një rast tjetër (trajtuar te paragrafi 50.15 i këtij vendimi) subjekti nuk ka pranuar kërkesën e palës mbrojtëse për aplikimin e këtij neni, ndërkohë që rasti në fjalë, kur është aplikuar neni 53 i Kodit Penal, është rast i vetëm dhe mangësitë e konstatuara në arsyetimin e vendimit në rastin konkret në vetvete nuk mund të konsiderohen si penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit, pasi janë pa ndonjë pasojë dhe nuk tregojnë vullnetin e subjektit për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit.

Juristi (anonim) i burgut Shënkoll, Lezhë, pretendon se në të gjitha vendimet e dhëna nga subjekti me objekt “Ulje dënimi”, të dënuarit nuk kishin plotësuar afatin me 1 vit dhe subjekti ka pranuar kërkesat e tyre në kundërshtim me ligjin. Me kërkesë të Komisionit, IEVP Lezhë ka përcjellë 5 vendime të dhëna nga subjekti, shoqëruar me praktikën nga IEVP-ja, nga shqyrtimi i të cilave vërehet se në të pesta rastet, nga ulja e mëparshme deri në datën e vlerësimit, nuk ishte plotësuar afati i vlerësimit 1-vjeçar, i parashikuar në nenin 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998.

Komisioni iu drejtua sërish IEVP Shënkoll, Lezhë, që të vërë në dispozicion vendime të dhëna nga gjyqtari Artan Hajredinaj, ku ka vendosur rrëzimin e kërkesave të të dënuarve me objekt “Ulje dënimi” në bazë të nenit 63 të ligjit nr. 8328/1998, për shkak të mosplotësimit të afatit kohor prej 1 viti, e cila vuri në dispozicion dy vendime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, duket se në pesë raste ka pranuar kërkesat për ulje dënimi jo në përputhje me kriteret e nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, pasi rezultoi se nuk është përmbushur kushti objektiv, afati kohor prej 1 viti, ashtu siç është shprehur IEVP Lezhë, sikurse ka arsyetuar në dy raste të tjera (vendimin nr. ***, datë 1.12.2016 dhe nr. ***, datë 2.11.2017) për rrëzimin e kërkesave.

Në parashtrimet e tij, subjekti pretendon se në të pesta rastet ka pranuar pjesërisht kërkesën jo në uljen maksimale prej 90 ditë, por në një ulje të pjesshme, konkretisht 60 ditë. Në këto raste, të dënuarit kanë paraqitur kërkesë për ulje dënimi nëse vendimi i formës së prerë është i 1 viti të mëparshëm dhe se vendimi i pranimit pjesërisht të kërkesës është i një viti të mëpasshëm kalendarik. Konkretisht, ai sqaroi se:

Për vendimin nr. ***, datë 6.7.2017, për të dënuarin A. M. ka paraqitur kërkesë në Gjykatë në datën 27.6.2017 për një vendim, i cili ka marrë formë të prerë në tetor të vitit 2016. Në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë, që i përket një viti të mëpasshëm, pra vitit 2016, ka pasur parasysh se shqyrtimi i kërkesës është bërë në vitin 2017 dhe se ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës. Shqyrtimi i kërkesës është bërë në vitin 2017, pra në një vit tjetër kalendarik dhe, duke qenë se nuk ishte plotësuar afati 1-vjeçar, por vetëm 10 muaj, kërkuesi ka përfituar ulje dënimi në masën 60 ditë.

E njëjta praktikë është ndjekur edhe në vendimin që i përket të dënuarit P. A., kur ky i dënuar ka vuajtur 11 muaj, i dënuari L. B. ka vuajtur 10 muaj, i dënuari B. H. ka vuajtur afro 11 muaj. Në të gjitha këto vendime ka pranuar pjesërisht kërkesën, e konkretisht uljen e dënimit në masën 60 ditë, duke arsyetuar se pavarësisht se i dënuari plotëson kriteret e tjera formale, duke mos plotësuar afatin 1-vjeçar nuk është aplikuar ulja e plotë e masës deri në 90 ditë.

Sipas subjektit, ndryshe nga sa arsyetohet në rezultatet e hetimit administrativ, ligji vlerëson qëndrimin e të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit, si dhe në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se i dënuari mund të përfitojë një ose disa ulje deri në 90 ditë në çdo vit. Duke interpretuar këtë dispozitë, ka vlerësuar se fakti që nuk është bërë ulje në masën 90 ditë, por është aplikuar kjo ulje në masën 60 ditë, është përcaktim ligjor si e drejtë që duhet t'u jepet të dënuarve.

Subjekti vijon se ligji nr. 8328/1998 është ndryshuar me ligjin nr. 81/2020 dhe në nenin 75, pika 2 e tij, është përcaktuar se: *“Ulja e dënimit për të dënuarit që plotësojnë kriteret e këtij neni, fillon jo më parë se 12 muaj”*. Vetëm nëse shqyrtimi i kërkesave do të ishte bërë pasi të hynte në fuqi ky ligj, mund të konsideroheshin shkelje vendimet e dhëna nga ana e tij. Duke qenë se ligji i mëparshëm, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes së vendimeve, ka pasur vend për interpretim duke lënë në analizën e provave edhe bindjen e gjyqtarit për të vendosur se cila ishte ulja që të dënuarit mund të përfitonin, një ose disa ulje, si dhe deri në 90 ditë si ulje maksimale, vlerëson se vendimmarrja e tij është e bazuar në ligj dhe e drejtë. Subjekti sjell në vëmendje faktin se kemi të bëjmë me vendime të dakordësuara nga të gjitha palët, ndaj të cilave nuk është paraqitur ankim, pra vendime të formës së prerë për dhënien e të cilave ka gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuar në ato gjykime. Ndaj edhe sipas tij është i pavend ky denoncim.

Subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit në rezultatet e hetimit, sipas të cilit në dy raste të tjera nuk është bërë ulja e dënimit për shkak se ishin në të njëjtat kushte, me argumentin se këto dy raste nuk janë në të njëjtat rrethana. Konkretisht, në vendimin që i përket të dënuarit G. C. ka rrëzuar kërkesën për ulje dënimi, duke arsyetuar se i dënuari kishte përfituar më parë një ulje dënimi, të cilën e kishte përfituar të plotë në masën 90 ditë me vendimin nr. ***, datë 7.3.2016. Kërkesa tjetër që ai po shqyrtonte, ishte paraqitur po në vitin 2016 dhe ulja e përfituar në atë vit ishte maksimumi që parashikon neni 63 i ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998.

Subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore në mbështetje të pretendimeve të tij, ndër to:

- Për rastin A. M. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 27.6.2017, me objekt ulje dënimi për periudhën 2016 – 2017 në masën 60 ditë, si dhe vendimin nr. ***, datë 28.10.2016 (formë e prerë datë 7.11.2016), me anë të të cilit kishte fituar ulje dënimi në masën 90 ditë për periudhën tetor 2015 – tetor 2016.

- Për rastin P. A. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 3.10.2017, me objekt ulje dënimi për periudhën 9.1.2017 – 27.9.2017 në masën 60 ditë, si dhe vendimin nr. ***, datë 9.1.2017 (formë e prerë datë 19.1.2017), sipas të cilit për periudhën 24.7.2015 – 24.7.2016 ka përfituar ulje në masën 90 ditë.

- Për rastin L. B. nuk ka paraqitur ndonjë dokument. Për rastin A. P. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 14.6.2017, me objekt ulje dënimi për periudhën 29.11.2016 – 29.6.2017 në masën 45 ditë, si dhe vendimin nr. ***, datë 29.12.2016 (formë e prerë datë 8.1.2017), sipas të cilit ka përfituar ulje në masën 90 ditë.

- Për rastin B. H. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 19.7.2017, me objekt ulje dënimi për periudhën 2016 – 2017 në masën 60 ditë, si dhe vendimin nr. ***, datë 21.11.2016 (formë e prerë datë 1.12.2016), sipas të cilit ka përfituar ulje në masën 90 ditë.

- Për rastin G. C. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 8.11.2016, me objekt ulje dënimi në masën 60 ditë, vendimin nr. ***, datë 7.3.2016 (formë e prerë datë 17.3.2016), sipas të cilit ka përfituar ulje në masën 90 ditë, si dhe vlerësimin e IEVP-së, ku ka propozuar rrëzimin e kërkesës për ulje dënimi, pasi nuk plotëson afatet kohore, meqë uljen e fundit e ka marrë në datën 7.3.2016.

- Për rastin M. I. ka paraqitur kërkesën e këtij shtetasi drejtuar gjykatës, datë 7.17.2017, me objekt ulje dënimi në masën 60 ditë, si dhe vlerësimin e IEVP-së, ku ka propozuar rrëzimin e

kërkesës për ulje dënimi, pasi nuk plotëson afatet kohore, meqë uljen e fundit e ka marrë në datën 20.3.2017.

Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura, vlerësohet se subjekti ka vepruar sipas interpretimit të nenit 63 të ligjit nr. 8328/1998, pasi kërkesat për të cilat ka vendosur ulje të pjesshme të dënimit i ka marrë në shqyrtim në vitin kalendarik pasardhës nga ai i përfitimit të uljes së mëparshme. Mbi të njëjtin interpretim subjekti ka refuzuar uljen e dënimit për dy rastet e tjera. Pra, duke qenë se ligji i mëparshëm, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes së vendimeve, ka pasur vend për interpretim, duke lënë në analizën e provave dhe bindjen e gjyqtarit për të vendosur se cila ishte ulja që të dënuarit mund të përfitonin, një ose disa ulje, si dhe deri në 90 ditë si ulje maksimale, pretendimi i subjektit vlerësohet i bazuar. Për më tepër, këto vendime nuk janë ankimuar nga institucioni përkatës, pra nuk i janë nënshtruar shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë nëse kërkesat duhen pranuar ose jo. Gjithsesi, kjo i përket zgjidhjes në themel të çështjes dhe në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit.

50.2.1 Juristi i burgut¹² dhe avokatja Sh. M. pretendojnë se subjekti ka dhënë vendim në kundërshtim flagrant me ligjin për rastin që i përket kërkesës së të dënuarit J. M., me objekt “Ulje dënimi”.

Me kërkesë të Komisionit Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vuri në dispozicion dosjen që i përket vendimit nr. ***, datë 6.4.2020 dhe nga shqyrtimi i saj rezultoi se:

- Me kërkesën datë 21.11.2019 shtetasi J. M. ka kërkuar uljen e dënimit me 270 ditë, për 3 vitet e vuajtjes së dënimit...; lirim para kohe me kusht të të dënuarit.

- Sipas një vlerësimi sjelljeje për në gjykatë në datën 17.10.2019 nga IEVP-ja Lezhë, me objekt “Ulje dënimi”, është konkluduar se shtetasi J. M. nuk plotëson kriteret ligjore për të përfituar ulje dënimi, pasi më 25.6.2019 ka marrë vendimin e formës së prerë.

- Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, rezulton se është arrestuar në datën 6.7.2016, është dënuar me 8 vite e 8 muaj burgim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 25.6.2019. Ka kryer gjithsej 5 vite e 2 muaj burgim dhe i mbeten për të vuajtur edhe 3 vite e 5 muaj burgim.

- Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 10.3.2020, IEVP-ja Reç ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për mosplotësim të afateve kohore.

- Me vendimin nr. ***, datë 6.4.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur uljen e dënimit për të dënuarin J. M., për dënimin e mbetur të pavuajtur me 270 ditë për periudhën nga data 6.7.2016 – 25.6.2019, që i përket vendimit nr. ***, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 25.6.2019, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

- Kundër vendimit nr. ***, datë 6.4.2020, ka paraqitur ankim IEVP-ja Shkodër, duke parashtruar se nga data 6.7.2016 – 25.6.2019 shtetasi J. M. ka pasur statusin e të paraburgosurit. Me vendimin nr. ***, datë 7.10.2020, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 6.4.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke rrëzuar kërkesën e kërkuarit J. M. etj.

Në përfundim të hetimit administrativ, duket se: (i) subjekti i rivlerësimit, jo në përputhje me kriteret e nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ka pranuar kërkesën e të dënuarit J. M. për ulje dënimi për periudhën e qëndrimit në paraburgim, po kështu duket se nuk ka vepruar në përputhje me nenin 75/3 të ligjit “Për të drejtat e të dënuarve”; (ii) objekti i gjykimit në këtë

¹² Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 12.5.2022 dhe nr. *** prot., datë 27.7.2021.

proces gjyqësor penal nuk është nga ato raste të parashikuara sipas pikës 3 të nenit 3 të aktit normativ nr. 9, datë 25.3.2020, për të cilat lejohet zhvillimi i seancave. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve.

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi si vijon:

- I dënuari J. M. është dënuar me vendim të formës së prerë të datës 25.6.2019, por se, që nga data e arrestimit të tij 5.7.2016 e deri më 25.6.2019 ky i dënuar kishte qëndruar për afro 3 vite në kushte paraburgimi, duke mos përfituar asnjë lloj ulje dënimi, duke konsideruar se nuk kishte marrë statusin e të dënuarit. Meqenëse kërkesa e këtij të dënuari është paraqitur në vitin 2020, në një vit të mëposhëm kalendarik dhe duke pasur parasysh qëndrimin e mbajtur edhe në raste të tjera, ka vlerësuar se ky i dënuar, duke qëndruar në kushtet e të njëjtit burg, si dhe duke qenë me statusin e të pandehurit ashtu dhe me statusin e të dënuarit, duhet të përfitonte një të drejtë të cilën ligji ia kishte dhënë. Pavarësisht se Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e tij duke rrëzuar kërkesën, vendim të cilin nuk mund ta komentojë, pasi është një vendim i dhënë nga një gjykatë më e lartë, ai i qëndron vendimit të dhënë dhe qëndrimin të mbajtur edhe në raste të tjera, për sa kohë që kërkesa për uljen e dënimit është paraqitur në një vit kalendarik të mëposhëm nga viti kalendarik kur vendimi ka marrë formë të prerë, kishin kaluar më shumë se 10 muaj, ndaj ka vlerësuar se duhet të pranohej kërkesa.

- Sipas subjektit, ai ka vepruar sipas bindjes së brendshme dhe praktikës së konsoliduar gjyqësore, si dhe vendimi është dhënë para ndryshimit të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i cili parashikonte se të dënuarit mund të përfitonin një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit, ndërsa me ndryshimet që ka pësuar ky ligj me ligjin nr. 81, datë 25.6.2020, është përcaktuar se afati i përfitimit të uljes së dënimit nis jo më parë se 12 muaj nga fillimi i kryerjes së dënimit me burgim, në zbatim të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë, si dhe ulja e dënimit nuk mund të jepet pa kaluar të paktën 12 muaj nga ulja e fundit e përfituar. Subjekti ka paraqitur disa dokumente pjesë nga dosja gjyqësore.

- Sa i takon konstatimit të dytë, subjekti sqaron se në këtë akt normativ, konkretisht në nenin 3, shkronja “e” e tij, është e përcaktuar se nuk zbatohen pikat 1 dhe 2 të këtij akti në rastet kur: ...i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit: *“e) Në çdo çështje tjetër penale ku i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit”*. Sipas tij, në çështjen objekt vlerësimi kemi të bëjmë me zbatim të ligjit dhe të këtij akti normativ, pasi i dënuari ishte duke vuajtur dënimin me burgim dhe si ai, ashtu edhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar vazhdimin e gjykimit. Pra, nuk qëndron ankimi i bërë nga ankuesja avokate Sh. M., pasi në rastin konkret nga ana e tij është zbatuar si ligji, ashtu dhe akti normativ i Këshillit të Ministrave.

Në analizë të parashtrimeve nga ana e Komisionit vlerësohet se argumentet e dhëna nga subjekti nuk qëndrojnë. Argumenti sipas të cilit, pavarësisht statusit, si të paraburgosurit, ashtu dhe të dënuarit duhet të përfitojnë të njëjtën të drejtë që ligji i jep (në rastin konkret, përfitimi i uljes së dënimit), nuk gjen mbështetje në vetë dispozitat e ligjit. Konkretisht, ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, në nenin 2 bën një dallim të qartë mes këtyre subjekteve, duke parashikuar se: *“U nënshtrohen rregullave të këtij ligji të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë...”*, ndërsa përfitimet e parashikuara në nenin 63 u referohen vetëm të dënuarve dhe jo të paraburgosurve, siç ka arsyetuar dhe Gjykata e Apelit. Në të njëjtin arsyetim ligjor është edhe qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë¹³. Po kështu, rasti i parashikuar në pikën 3, shkronja “e” e aktit normativ të cilit i referohet subjekti, për nga vetë formulimi bën fjalë për çështjet penale kur pozita procedurale e kërkuarit është ajo e të pandehurit dhe jo e të dënuarit.

50.3 Denoncim nga shtetasi F. N.

¹³ Shihni vendimin nr. ***, datë 29.6.2021, të Gjykatës së Lartë.

Denoncuesi pretendon se subjekti në shkelje të ligjit ka favorizuar në masën e dënimit shtetasin .E. V. , duke e dënuar në minimum dhe pezulluar dënimin për veprat penale “Prodhim/shitje narkotikësh” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve” etj. Denoncuesi referon dhe një artikull të publikuar në media në lidhje me rastin. Nga kërkimi në sistemin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë figuron vendimi nr. ***, datë 15.9.2019, gjyqtar Artan Hajredinaj, me të pandehur shtetasin E. V. , nga përmbajtja e të cilit rezulton se, pasi i pandehuri ka kërkuar deklarinimin e pafajshëm dhe akuza ka kërkuar siç është vendosur më pas nga gjykata, ndër të tjera është vendosur deklarinimi fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim; deklarinimi fajtor i të pandehurit E. V. për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve për disa vepra penale dhe dënimin e të pandehurit E. V. me një dënim të vetëm prej 6 vitesh burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së dënimit të mbetur pa vuajtur, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhe kohe prej 5 vitesh etj. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me konstatimin ku duket se arsyetimi i aplikimit të nenit 59 nga subjekti nuk është në përputhje me kërkesat e vendosura nga ky nen, pasi i pandehuri nuk duket të ketë shfaqur qëndrim pohues e pendues për veprën, si dhe në arsyetim cilëson se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore jo të ulët.

Subjekti parashtroi se pas shqyrtimit dhe administrimit të provave në procedurën e gjykimit të shkurtuar, në fazën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga prokurori i çështjes është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal për dënimin e dhënë të pandehurit, duke pretenduar se janë plotësuar kushtet për aplikimin e këtij neni. Edhe nga ana e tij si gjyqtar i çështjes është vlerësuar se i pandehuri E. V. plotësonte kushtet e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, ndaj ka pranuar këtë kërkesë të prokurorit dhe të pandehurit. Ai në dhënien e këtij vendimi ka pasur parasysh faktin që i pandehuri është i padënuar më parë, moshën relativisht të re dhe qëndrimin e mbajtur ndaj akuzës. Sipas subjektit, duke parë çështjen në kompleksitet dhe duke çmuar faktin e ekzistencës së rrethanave lehtësuese në raport me rrezikshmërinë shoqërore jo të lartë të të pandehurit, ka çmuar se nuk ishte i domosdoshëm izolimi i tij nga shoqëria. Sipas tij, kemi të bëjmë me një vendim të dakordësuar nga të gjitha palët ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra është një vendim i formës së prerë për dhënien e të cilit ka gjykuar sipas provave dhe bindjes së brendshme. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 15.10.2019 (mungojnë f. 10-11), të formës së prerë, kopje certifikate të të pandehurit në përbërje familjare me nënën e tij, si dhe certifikatë elektronike, ku i pandehuri figuron i padënuar.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura, vlerësohet se subjekti është përpjekur të argumentojë mjaftueshëm shkaqet dhe rrethanat që e kanë çuar në vendimmarrjen për të pandehurin për të cilin ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, duke iu referuar me të drejte faktit që i pandehuri është i padënuar më parë, që tregon rrezikshmëri jo të lartë të tij apo gjendjes familjare i vetëm me nënën e moshuar. Sa i takon faktit që i pandehuri nuk duket të ketë mbajtur një qëndrim pendues, kjo është e logjikshme në kushtet që ai ka kërkuar pafajësinë. Për më tepër, vendimi është i formës së prerë pa u ankimuar. Në përfundim, çmohet se subjekti ka vlerësuar sipas diskrecionit të tij në rolin e gjyqtarit për të caktuar llojin e dënimit (burgim), si dhe masën e tij në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal. Për më tepër, nuk u vërtetua që aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal të ketë qenë një metodë pune e tij (me mangësi), pasi në dy raste (trajtuar në paragrafët 50.2 dhe 50.5.1 të këtij vendimi) subjekti nuk ka pranuar aplikimin e kësaj dispozite ligjore. Ndërsa në dy raste të tjera (trajtuar në paragrafin 50.4 dhe çështjes që i përket dosjes nr. 5 të përzgjedhur me short) është vërtetuar që subjekti ka aplikuar drejt këtë dispozitë ligjore.

50.4. Denoncuesi E. M. pretendon se vendimi i datës 3.2.2021 i dhënë nga subjekti është në kundërshtim me ligjin. Nuk ka paraqitur dokumentacion. Komisioni i kërkoi Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjen gjyqësore që i përket vendimit datë 3.2.2021, me të pandehur shtetasin N. I., e cila informoi se çështja me objekt “Falsifikimi i dokumenteve” ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 3.2.2021, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nga shqyrtimi i të cilit vërehet se:

- I pandehuri N. I. është akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

- Prokurori ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit N. I. dhe dënimin e tij me 1 vit burgim; në bazë të nenit 190 të Kodit Penal, asgjësimin e dokumentit AMTP nr. ***, datë 28.7.1993, në emër të shtetasit N. I.; në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, asgjësimin e dokumentacionit të ndodhur në praktikën e ZVRPP-së Lezhë, planin e rilevimit për pasurinë nr. ***, konfirmimin e Komunës ***, datë 2.12.2010, vërtetimin e Komunës ***, datë 2.12.2010; kalimin e pasurisë nr. *** në favor të shtetit.

- Me vendimin nr. ***, datë 3.2.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: (i) deklarinim fajtor të të pandehurit N. I. për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 muaj burgim; (ii) në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit; (iii) në bazë të nenit 190 të Kodit Penal, asgjësimin e AMTP-së nr. ***, datë 28.7.1993, e cila përmban pasurinë nr. ***; (iv) shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit; (v) kundër këtij vendimi lejohet ankimi.

Nga përmbajtja e vendimit vërehet se subjekti pasi ka parashtruar rrethanat dhe faktet, ka arsyetuar se në çështjen në shqyrtim provohet plotësisht se dokumenti AMTP nr. ***, datë 28.7.1993, me sipërfaqe 18510 m² në emrin e shtetasit N. I. është i falsifikuar dhe me dashje është përdorur nga i pandehuri N. I. Subjekti nuk është shprehur në lidhje me kërkesat e prokurorisë për asgjësimin e planrilevimit, konfirmimin dhe vërtetimin e Komunës *** datë 2.12.2010 dhe as për kalimin e pasurisë nr. *** në favor të shtetit.

Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë arsyetim në lidhje me kërkesën e organit të prokurorisë, si dhe në dispozitiv nuk ka vendosur sipas kërkesave të neneve 190 dhe 391 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me planrilevimin, konfirmimin dhe vërtetimin e Komunës ***, datë 2.12.2010 dhe as për kalimin e pasurisë nr. *** në favor të shtetit. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar si vijon:

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje ka vendosur deklarinim fajtor për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe duke vlerësuar se dokumenti për të cilin ai është deklaruar fajtor, konkretisht AMTP-ja nr. ***, datë 28.7.1993, e lëshuar në emër të tij, është e falsifikuar dhe me qëllim mospërdorimin e këtij dokumenti në mbështetje të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, në pikën 3 të dispozitivit të vendimit është shprehur për asgjësimin e këtij dokumenti origjinal. Sipas subjektit, nuk qëndron denoncimi i bërë nga shtetasi E. M., pasi duke konsideruar këtë dokument, akt të marrjes së tokës në pronësi si të falsifikuar, është shprehur vetëm për asgjësimin e tij konform kërkesës së prokurorit në pretendimet përfundimtare. Asgjësimi është vendosur me arsyetimin se ky dokument nuk duhet të paraqitet në organet shtetërore dhe as të përdoret më në të ardhmen, duke e konsideruar atë si dokument të falsifikuar.

Sipas subjektit, nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, vetëm dokumenti AMTP nr. ***, datë 28.7.1993, me sipërfaqe 18510 m², në emrin e shtetasit N. I. ka rezultuar i falsifikuar, në vijim është përdorur me dashje nga i pandehuri N. I., ndërsa zgjidhja e pasojave civile që rrjedhin nga përdorimi i këtij dokumenti pronësie të falsifikuar nuk është kompetencë e gjykatës që

shqyrton çështjen penale, për sa kohë nuk ka paditës civilë të legjitimuar në procesin penal, rol që mund të ushtrohej nga Avokatura e Shtetit sipas nenit 14 të ligjit nr. 10018/2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar: *“Drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor njofton Avokaturën e Shtetit brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të procedimit penal për vepra penale, nga të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë. 2. Avokatura e Shtetit ngre padi civile në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale. 3. Avokatura e Shtetit mund t’ia delegojë të drejtën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni organit qendror ose vendor të administratës, që ka interes të drejtpërdrejtë, ose organit epror të personit juridik publik, në rast se vlera e dëmit është më pak se 1 milion lekë. Delegimi është i vlefshëm për gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit”*.

Subjekti sqaron se ky vendim është ankuar nga i pandehuri N. I. dhe çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 3.2.2021, si dhe shkresën e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila i ka dërguar për gjykim dosjen në Gjykatën e Apelit Shkodër me ankimin e shtetasit N. I. dhe të prokurorisë.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, vlerësohet se pretendimet e subjektit qëndrojnë për sa kohë është evidentuar dhe vërtetuar falsifikimi vetëm i dokumentit AMTP nr. ***, datë 28.7.1993, me sipërfaqe 18510 m², në emrin e shtetasit N. I., i cili është përdorur me dashje nga i pandehuri N. I., e për këto arsye është vendosur asgjësimi vetëm i këtij akti. Me të drejtë subjekti parashtron se zgjidhja e pasojave civile që rrjedhin nga përdorimi i këtij dokumenti pronësie të falsifikuar nuk është kompetencë e gjykatës që shqyrton çështjen penale, për sa kohë nuk ka paditës civil të legjitimuar në procesin penal. Megjithatë, subjekti duhet të ishte treguar më i kujdesshëm që këto fakte të ishin shprehur më mirë gjatë arsyetimit të vendimit.

50.5. Denoncuesi *** (anonim) pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar fisin e N. me vendimin datë 26.3.2021 për pushimin e çështjes së shtetasit A. N.; me vendimin datë 21.9.2018 për shtetasit D. N. dhe P. M. ka dhënë dënime të ulëta; me vendimin datë 20.3.2018 për shtetasin S. N. ka miratuar marrëveshjen e fajësisë në kundërshtim me ligjin, si dhe ka pezulluar vendimin, edhe pse kanë qenë të dënuar penalisht.

Sa i përket vendimit datë 26.3.2021 për pushimin e çështjes së z. A. N., u kërkua nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosja gjyqësore, e cila informoi se çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 26.3.2021, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se:

- Shtetasi A. N. është akuzuar për veprat penale falsifikimit, shpërdorimit të tokës në bashkëpunim dhe pastrimin e produkteve të veprave penale.
- Në përfundim, prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, mbrojtja ka kërkuar deklarin e pafajshëm të të pandehurit A. N.
- Me vendimin nr. ***, datë 26.3.2021, subjekti bazuar në nenet 148/1 të Kushtetutës dhe nenet 112, 377, 379, 384, 387 ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. N.

Nga përmbajtja e këtij vendimi vërehet se Prokuroria e Posaçme në datën 17.1.2020 mbi miratimin e gjykatës së posaçme (gjyqtarës së seancës paraprake) ka paraqitur për gjykim çështjen penale me të pandehur A. N. etj. Gjykata e Posaçme me vendimin datë 25.9.2020, ndër të tjera, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. N. dhe dërgimin e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Subjekti ka arsyetuar ndër të tjera se prokurori në pretendimet përfundimtare kërkoi pushimin e çështjes. Subjekti pasi ka bërë interpretim të ndryshimit të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017, ndër të tjera ka arsyetuar se: (i) në çështjen objekt shqyrtimi jemi para disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq; (ii) bazuar në nenin

148/1 të Kushtetutës, jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe nenet 377 dhe 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit A. N., për arsye se prokurori ka tërhequr akuzën dhe, për rrjedhim, ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë.

Në përfundim të hetimit administrativ duket se: (i) mbetet e paqartë përse subjekti ka arsyetuar se çështja objekt shqyrtimi është disponimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq; (ii) mbetet e paqartë nëse prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes apo tërheqjen e akuzës si dhe arsyet, pasi në vendim nuk pasqyrohet përmbajtja e kësaj kërkesë; (iii) subjekti i referohet parashikimit të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, por nuk bën asnjë citim, analizë dhe arsyetim mbi gjendjen që janë provat mbi të cilat del se duhet të pushohet çështja, siç e kërkon kjo dispozitë; (iv) mbetet e paqartë dhe e paarsyetuar se cilit prej rasteve të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale (që i referohet nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale), i referohet subjekti kur shprehet se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë. Po kështu, mbetet e paqartë se cilit vendim/e të Gjykatës së Lartë i referohet subjekti në vendim. Subjektit me kalimin e barrës së provës iu kërkuar sqarime e dokumente në lidhje me sa më sipër.

Në analizë të parashtrimeve Komisioni ka evidentuar se:

- Në lidhje me konstatimin e parë, subjekti në parashtrimet e dërguara me *email* datë 4.3.2024 ka shpjeguar se ka qenë një lapsus, kur është shprehur se “*në çështjen objekt shqyrtimi jemi para disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq*”, pasi sipas tij në këtë fjali mungon fjala “nuk”, e cila ndryshon dhe kuptimin e fjalisë, pra ai ka shqyrtuar çështjen në themel.

- Në lidhje me konstatimet e tjera, subjekti në parashtrimet e tij i përmbahet të njëjtit arsyetim dhe logjike me atë të bërë në arsyetimin e vendimit, pra që veprat penale të regjistruara në ngarkim të të pandehurit A. N. nuk provohet se janë kryer nga ai. Subjekti ka bërë analizë të nenit 377 dhe, në bazë të këtij neni, pasi janë shqyrtuar të gjitha provat, parashtron se prokurori ka tërhequr akuzën duke kërkuar pushimin, e në këtë rast gjykata duke mos pasur një bindje të ndryshme nga prokurori mbi mënyrën e zgjidhjen e çështjes, referuar mungesës së provave ndaj këtij të pandehuri dhe bindjes së tij të brendshme, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Subjekti deklaroi se në tërësi i është referuar praktikës dhe jurisprudencës së saj, si dhe vetëm ligjit si: Kodit i Procedurës Penale, nenet 377 dhe 387 të tij, pa referuar ndonjë vendim konkret të Gjykatës së Lartë.

Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) procesverbalin e seancës datë 26.3.2021, sipas të cilit prokurori ndër të tjera është shprehur se: “*Pas administrimit të provave, ne si organ akuze jemi përpara neneve 377 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Nga provat e administruara nuk arrihet të provohet se veprat penale për të cilat është akuzuar i pandehuri janë kryer nga ai... Kështu që i kërkojmë gjykatës pushimin e gjykimit; avokati është shprehur se referuar dhe kërkesës për tërheqjen e akuzës çmojmë se kjo gjykatë duhet të vendosë deklarin e pafajshëm të të mbrojturit prej tij, duke qenë se tërhiqet akuza sipas kërimit të institucionit të prokurorisë... se në rast të tërheqjes së akuzës gjykata vendos deklarin e pafajshëm kur kërkohet kjo edhe nga i pandehuri*”; (ii) vendimin nr. ***, datë 26.3.2021 dhe shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë për dërgimin e dosjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku tregohet se ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasi A. N.

Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, vërehet se, sa i takon konstatimit të parë, pranohet nga subjekti se ka pasur një lapsus, fakt që nga Komisioni vlerësohet se nuk ka sjellë ndonjë pasojë. Sa i takon analizës dhe arsyetimit mbi gjendjen që janë provat, subjekti ndalet te fakti se janë shqyrtuar të gjitha provat dhe se bindja e gjykatës ka qenë e njëjtë me atë të prokurorit. Në lidhje me këtë deklarin, Komisioni nuk mund të fajësojë subjektin sa i takon bindjes së tij, ndonëse vlerëson se duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në renditjen e fakteve dhe provave mbi të cilat është krijuar kjo bindje. Siç rezultoi,

i pandehuri duke mos qenë dakord me vendimin e subjektit, e ka ankimuar atë duke kërkuar pafajësi, për rrjedhë nuk mund të konkludohet se subjekti ka mbajtur qëndrim favorizues, sikurse pretendohet në denoncim.

Sa i takon çështjes nëse duhet të vendoste pushimin apo pafajësinë e të pandehurit, sipas pretendimeve të palëve, bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë, që siç rezulton çështja pritet të shqyrtohet në Apel.

50.5.1. Sa i përket vendimit datë 21.9.2018 për shtetasit D. N. dhe P. M., Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vuri në dispozicion dosjen penale nr. ***, datë 21.9.2018, në ngarkim të shtetasve D. N. dhe P. M., nga analiza e akteve të së cilës, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, u konstatua se në përfundim subjekti, bazuar në nenet 278/1, 84 të 47, 48 dhe 49 të Kodit Penal, me vendimin nr. ***, datë 21.9.2018, ka vendosur sipas pikave: (1) *Deklarimin fajtor të D. N. për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim;* (2) *Deklarimin fajtor të shtetasit D. N. për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim;* (3) *Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në 4 vjet e 6 muaj;* (4) *Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht me 3 vjet burgim;* (5) *Pushimin e akuzës për veprën penale, neni 84 i Kodit Penal;* (6) *Deklarimin fajtor të shtetasit P. M. për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim;* (7) *Deklarimin fajtor të shtetasit P. M. për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim;* (8) *Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në 3 vjet;* (9) *Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht me 3 vjet burgim;* (10)...

Sa më sipër, nisur nga parashikimi i nenit 278 të Kodit Penal nga ana e Komisionit nuk mund të konkludohej se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të akuzuarit, pasi masa e dënimit brenda kufijve të ligjit është në vlerësimin dhe diskrecionin e gjykatës. Gjithashtu, subjekti nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për aplikimin e nenit 59, pra të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Por, në përfundim të hetimit administrativ, në referim të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, u konstatuan mangësi në përpilimin e vendimit, parashtrimin e fakteve, arsyetimin e vendimit dhe sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kërkuar sqarime në lidhje me konstatimet që iu evidentuan subjektit në rezultatet e hetimit administrativ. Në parashtrimet e tij, subjekti i kundërshtoi konstatimet e Komisionit, duke sqaruar si vijon:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykimin e të pandehurit D. N., duke e akuzuar atë dy herë për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 278/1, 278/1 dhe 84 të Kodit Penal. Është akuzuar dy herë për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”. Në analizë të rrethanave të pasqyruara në vendimin penal të arsyetuar rezulton se i pandehuri D. N. është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 278/1 e 84 të Kodit Penal për ngjarjen e datës 25.5.2017 dhe për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal në ngjarjen e datës 25.10.2017 (ngjarje e cila përkon me arrestimin e tij). Në asnjë rresht të këtij vendimi nuk arsyetohet e relatohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, por gjatë gjithë vendimit i referohem nenit 278/1 të Kodit Penal, për të cilin është deklaruar fajtor. Në vendim është e shënuar se i pandehuri D. N. e ka kryer plotësisht veprën penale të mësipërme dy herë.

- Sipas subjektit, akuzat në ngarkim të të pandehurit D. N. janë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, e cila në atë kohë parashikonte se: *“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”*.

- Subjekti sqaron se ndryshimi në masën e dënimit me të pandehurin tjetër, i cili është gjykuar dhe deklaruar fajtor në të njëjtin procedim penal, konkretisht i pandehuri P. M., është sepse ky i pandehur është akuzuar vetëm një herë për veprën penale, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe përfundimisht është dënuar me 2 vite burgim. Pra, në asnjë pikë të dispozitivit të këtij vendimi nuk është shënuar neni 278/2 i Kodit Penal.

- Në parashtrimet shtesë të paraqitura me *email* datë 4.3.2024, subjekti ka sqaruar se në lidhje me të pandehurin P. M., në pjesën hyrëse ka një lapsus, pra duhet të ishte neni 278/1/2 dhe ky lapsus nuk sjell pasojë për zgjidhjen, pasi është referuar në dispozitiv. Sipas tij, pavarësisht se në pjesën përshkruese-arsyetuese nuk citohen elementet e kësaj veprë, ekzistenca e kësaj veprë është e evidente.

Në analizë të parashtrimeve, pretendimet e subjektit se në vendim ka pasqyruar saktë akuzën për të pandehurin D. N., pasi ai është akuzuar dy herë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe nuk ka pasur akuzë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, vlerësohet se qëndrojnë. Ndërsa sa i takon pretendimeve në lidhje me të pandehurin P. M., vetë subjekti pranon se në pjesën hyrëse ka një lapsus, pra duhet të ishte neni 278/1/2 i Kodit Penal, dhe se në pjesën përshkruese-arsyetuese nuk citohen elementet e kësaj veprë. Në këto kushte, vlerësohet se subjekti duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në redaktimin e vendimit, që mund të ketë ardhur edhe për shkak të ngarkesës në punë, pasi siç rezultoi në vitin 2018 subjekti ka gjykuar 912 çështje. Por këto dy elemente pakujdesie, në konsideratë edhe të faktit që vendimi nuk është ankimuar nga palët, çmohet se nuk janë të tilla që të cenojnë aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vuri në dispozicion dosjen penale nr. ***, datë 20.3.2018, me të pandehur S. N., si dhe fashikujt e procedimit penal ***/***, nga analiza e akteve të së cilës, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, rezulton se në datën 7.2.2018 është lidhur marrëveshja për pranimin e fajësisë nga i pandehuri S. N. në kuadër të procedimit penal nr. ***/***. Sipas kësaj marrëveshjeje, ndër të tjera është parashtruar se në datën 27.10.2017 shërbimet e policisë kanë kapur në flagrancë shtetasit S. N. dhe P. M. me nga një pistoletë dhe krehër me fishekë. Ndaj shtetasit S. N. është ngritur akuza për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. I pandehuri deklaroi se e pranon fajësinë, është thellësisht i penduar, shpjegon se i kanë vrarë babain dhe nuk ka njeri tjetër të kujdeset për familjen e tij, në dhënien e dënimit me kusht do të paraqitet te zyra e shërbimit të provës. Në përfundim është miratuar: deklarimi fajtor i tij dhe dënimi me tri vite burgim; në aplikim të nenit 59, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim etj. Me vendimin nr. ***, datë 20.3.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur miratimin e marrëveshjes së fajësisë datë 7.2.2018 për procedimin penal nr. ***/*** i pandehuri S. N. deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, etj.

Bazuar në sa më sipër, nisur nga vendimi nr. ***, datë 21.9.2018, me anë të të cilit subjekti ka deklaruar fajtor të pandehurit P. M. për veprat penale të parashikuara nga neni 278/1 dhe 278/2 të Kodit Penal në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti i rivlerësimit në miratimin e marrëveshjes së fajësisë ka vepruar jo në përputhje me kërkesën e shkronjës “ç” të nenit 406/e/2 të Kodit të Procedurës Penale pasi, siç rezultoi, faktet dhe rrethanat kanë qenë të njëjta me ato të të pandehurit P. M., i cili është deklaruar fajtor nga vetë subjekti për veprat penale të parashikuara nga neni 278/1 dhe 278/2 të Kodit Penal, ndërkohë që ndaj z. S. N. është

ngritur akuzë vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime e dokumente në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e tij, subjekti në mënyrë të përmbledhur sqaroi se marrëveshja bëhet me kërkesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, të cilët bisedojnë kushtet e pranimin të fajësisë dhe dënimit penal me prokurorin e çështjes. Sipas subjektit, kualifikimi ligjor i faktit është vlerësuar i saktë nga ana e tij, pasi fishekët e sekuestruar janë konsideruar si pjesë përbërëse të armës së zjarrit, e si të tilla mbajtja e tyre nuk përbën veprë penale më vete sipas nenit 278/2 të Kodit Penal, por fakti duhet të kualifikohet sipas akuzës së prokurorit dhe vendimit të shpallur. Subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 20.3.2018, i cili ishte administruar më parë nga Komisioni. Ndërsa në parashtrimet shtesë të paraqitura me *emailin* datë 4.3.2024 subjekti ka sqaruar se i pandehuri S. N. rezultoi se është kapur në flagrancë në datën 27.10.2017 me armë zjarri pistoletë dhe krehrin e saj me 7 fishekë. Ndërsa i pandehuri P. M. , përveç krehrit me 7 fishekë të armës së zjarrit që iu sekuestrua, kishte edhe një krehër tjetër rezervë me 8 fishekë, si dhe një fishek tjetër. Pra, kualifikimi ligjor i faktit nuk duhet të ishte i njëjtë për të dy të pandehurit.

Në përfundim të procesit, vlerësohet se në çështjen konkrete subjekti në argumentet e veta me të drejtë i është referuar akuzës së ngritur nga prokurori, si dhe qëndron pretendimi sipas të cilit ai ka miratuar një marrëveshje që ishte nënshkruar me vullnetin e lirë të pjesëmarrësve në proces.

50.6. Tri denoncime nga shtetasi A. S. , i cili ngre pretendime ndër të tjera edhe mbi subjektin Hajredinaj, që sipas tij në fjalinë e parë të vendimit është shprehur se mbahet seanca edhe në prani të prokurorit S. K. , ndërkohë që prokurori nuk ka qenë, si dhe ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen e subjektit. Njëri prej denoncimeve u paraqiti pasi subjektit i janë dërguar rezultatet e hetimit edhe me *emailin* e datës 20.2.2024 dhe i është kërkuar të japë sqarime.

Subjekti në parashtrime sqaroi se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe shpjegoi se në faqen e parë të vendimit nr. ***, datë 16.3.2023, ka një lapsus lidhur me prezencën e prokurorit të çështjes, ku citohet se: *“...gjykata, pasi dëgjoi prokurorin S. K. , që kërkoi pranimin e kërkesës... ndërsa në pjesën hyrëse të vendimit citohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, përfaqësuar nga prokurori S. K. (në mungesë në seancën e shpalljes së vendimit). Sipas tij, me procesverbalin e seancës së datës 28.2.2023 pasqyrohet fakti që ...prokurori është thirrur dhe është prezent, ka dijeni dhe gjykimi vijon në mungesë të tij”*. Ky lapsus i sekretares gjyqësore ka sjellë si pasojë edhe lapsusin në faqen 1 të vendimit nr. ***, datë 16.3.2023, prandaj pretendimi i ankuesit duhet të konsiderohet i pabazuar.

Për sa i përket zgjidhjes në themel të kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes, sipas subjektit, siç rezultoi edhe nga përmbajtja e vendimit nr. ***, ky procedim penal është regjistruar në vitin 2019 dhe disa herë, në mënyrë të përsëritur, është kërkuar pushimi i çështjes, ndërsa gjykata e seancës paraprake ka kthyer aktet për veprime të mëtejshme hetimore, duke caktuar afate e detyra konkrete për organin e akuzës. Edhe kërkesa e fundit e prokurorit për pushimin e çështjes është vlerësuar si e bazuar në ligj e prova nga ana e tij, me pasojë pranimin e kërkesës për pushim. Aktualisht kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe mbetet në pritje për t'u shqyrtuar.

Subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 16.3.2023, ku provohen deklaratimet e tij, si dhe ka paraqitur kopje të procesverbaleve datë 28.2.2023, ku pasqyrohet se: *“Është thirrur dhe është prezent prokurori S. K. , ka dijeni, vijon gjykimin në mungesë të tij...”*. Pra, dukshëm është lapsus, pasi vetë përmbajtja tregon se prokurori është në mungesë. Po ashtu edhe në procesverbalin e datës së shpalljes së vendimit, datë 16.3.2023, është pasqyruar fakti se prokurori S. K. nuk është prezent.

Në këto kushte, nga ana e Komisionit vlerësohet se argumentet e subjektit janë të plota dhe shteruese. Sa i përket vendimmarrjes bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

50.7. Denoncim nga një qytetar (anonim)

Denoncuesi ngre pretendime se subjekti, në kundërshtim me ligjin, në lidhje me kërkesën e shtetasit V. N. ka hequr sekuestron mbi pasurinë nr. *** tek *** *** me vendimin e datës 29.4.2022, pasuri e cila ishte sekuestruar edhe me vendim të Apelit të GJKKO-së. Nuk ka paraqitur dokumentacion. Komisioni iu drejtua GJPAKKO-së për vënien në dispozicion të vendimit me anë të të cilit është vënë sekuestro mbi pasurinë nr. *** ndodhur në ***, që ka të bëjë me shtetasin V. N., e cila informoi se në këtë gjykatë nuk është regjistruar sekuestro mbi këtë pasuri. Komisioni kërkoi nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjen gjyqësore që i përket vendimit datë 29.4.2022, me kërkues V. N. për heqje sekuestroje, e cila vuri në dispozicion dosjen penale me nr. ***, me objekt kthimin e sendeve të sekuestruara, aktet e së cilës janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar nga Komisioni, sikurse është pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës sa i përket paqartësive në lidhje me arsyetimin mbi heqjen e sekuestros sipas neneve 208 dhe 274 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbi administrimin e dosjes. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se referimi në nenin 274 është një lapsus në arsyetimin e vendimit, por në thelb ka pasur parasysh që kishte të bënte me veprim procedural konform nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht sekuestrim të praktikave në cilësinë e provave materiale dhe se kërkuesit i ishte mohuar e drejta e posedimit qetësisht të pasurisë së tij, prandaj ai nuk ishte subjekt i nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, pasi pasuritë nuk ishin pasuri të lidhura me ndonjë vepër penale. Sipas subjektit, në thelb ky ka qenë arsyetimi i tij lidhur me këtë vendim pasi, po të shihet dispozitivi i vendimit, del qartësisht fakti që ka vendosur heqjen e shënimeve kufizuese nga kartelat e pasurive, por që sipas tij nuk ka qenë i qartë në pjesën arsyetuese të vendimit. Si provë ka paraqitur disa dokumente të administruara edhe gjatë hetimit administrativ. Sipas tij, vendimi i dhënë është dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilave nuk është paraqitur ankim.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, vlerësohet se vetë subjekti pranon se ka një lapsus në arsyetimin e vendimit dhe faktin se nuk ka qenë tërësisht i qartë në pjesën arsyetuese të vendimit. Si konkluzion, nisur nga natyra e çështjes, ngarkesës në punë për vitin 2022 prej 1061 çështjesh të gjykuara në total, Komisioni paqartësitë në arsyetimin e vendimit i vlerëson si pa pasojë dhe pa ndonjë peshë për efekt të procesit të rivlerësimit.

50.8. Denoncim nga ***

Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendim me të meta procedurale dhe në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është formuar drejt ndërgjyqësia. Sipas tij, në kushtet kur është kërkuar pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, palë në gjykim duhet të ishte dhe ***, e cila ishte palë kreditore për rastin që i përket vendimit nr. ***, datë 30.3.2021. Bashkëngjitur ka paraqitur vendimin nr. 217, datë 30.3.2021, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me palë paditëse Ermal dhe E. B., palë e paditur shoqëritë përmbarimore “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., me objekt “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe kundërshtim i veprimeve përmbarimore”, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 24.4.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i cili në përfundim ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare, datë 1.6.2015, për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. ***, datë 24.4.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për shkak se detyrimi është shuar.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, duket se në këtë proces nuk është formuar drejt ndërgjyqësia dhe ka cenuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi si vijon:

Vendimi nr. ***, datë 31.3.2021, është ankimuar nga palët dhe Gjykata e Apelit ka prishur vendimin nr. ***, datë 31.3.2021 dhe ka dërguar çështjen për rigjykim. Gjatë gjykimit të zhvilluar nuk ka vendosur të thërrasë në cilësinë e personit të tretë ***, pasi nga tërësia e akteve të sjella nga përmbauesi gjyqësor ka vlerësuar se kjo bankë ka pasur dijeni për vendimet e përmbauesit gjyqësor dhe për faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë po zhvillohej ky gjykim për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit.

Neni 193 i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar se kur Gjykata çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili ka dijeni për çështjen, e thërret atë. Pra, vetë kjo dispozitë ligjore e ka lënë në kompetencën e Gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mosthirrjen e kësaj pale në cilësinë e personit të tretë. Në interpretim të këtij neni ka vlerësuar se nuk ka qenë e domosdoshme thirrja e ***, pasi interesat e saj në këtë proces mbroheshin nga përmbauesi gjyqësor. Sipas tij, ai i ka kushtuar rëndësi zgjidhjes në themel të çështjes, duke vlerësuar në dhënien e një vendimi të drejtë për palët.

Subjekti pretendon se zgjidhja e tij ka qenë e drejtë, pasi dhe pas rishqyrtimit të kësaj çështjeje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, megjithëse është thirrur në proces në cilësinë e palës së tretë, ***, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit, vendimmarrja e Gjykatës me vendimin nr. ***, datë 20.4.2022, është në thelb e njëjtë me zgjidhjen e dhënë nga subjekti në vendimin nr. ***, datë 30.3.2021. Subjekti ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. ***, datë 20.4.2022 dhe vendimin nr. ***, datë 21.7.2021, nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe vendimin e dhënë prej tij.

Sipas vendimit nr. ***, datë 21.7.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 30.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Sipas këtij vendimi, ndër të tjera është arsyetuar se: janë ngritur pretendime për ndërgjyqësinë. Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në shkëlqje të rregullave që disiplinojnë bashkëndërgjyqësinë. Në rastin konkret nuk është formuar drejt ndërgjyqësia, pasi duhet të jetë edhe ***, kreditore në këtë procedurë, që heq interesa të drejtpërdrejtë për pretendimet për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv.

Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. ***, datë 20.4.2022, gjykuar nga gjyqtarja E. U., me objekt kundërshtimin e vendimit të ekzekutimit të përmbauesit gjyqësor, ka ndryshuar vlera e ekzekutimit të vendosur me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 24.1.2017. Sipas këtij vendimi, rezulton se pas regjistrimit të çështjes, pala paditëse deklaroi se në asnjë moment nuk ka kundërshtuar vendimin nr. ***, datë 24.1.2017 dhe se ka qenë dakord me të, por kundërshtoi veprimet e përmbauesit dhe ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e objektit të padisë. Në bazë të detyrave të Apelit ka thirrur në cilësinë e personit të tretë *** Në përfundim ka vendosur pranimin e padisë, kundërshtimin e veprimeve përmbaimore.

Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, vlerësohet se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi edhe Apeli ka arsyetuar qartë parregullsinë e ndërgjyqësisë dhe se banka duhet të jetë palë në proces. Po kështu nuk qëndron as argumenti se neni 193 i lë në kompetencë Gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mosthirrjen e kësaj pale në cilësinë e personit të tretë, pasi, siç rezultoi, pala paditëse gjatë rigjykimit ka ndryshuar objektin e padisë dhe nuk pretendon më për pavlefshmëri titulli ekzekutiv, por ngre pretendime mbi veprimet e përmbauesit. Pra, ashtu siç është konstatuar në rezultatet e hetimit dhe është konstatuar nga Gjykata e Apelit, subjekti duhej të thërriste në gjykim edhe kreditorin. Sa i takon pretendimeve në lidhje me themelin, që sipas tij ka vendosur drejt, ashtu siç dhe është vendosur në rigjykim, subjektit nuk i janë kërkuar sqarime mbi themelin.

50.9. Tri denoncime nga shtetasi P. Rr.

Denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit dhe prokurorëve, që sipas tij kanë gjykuar çështjen në mënyrë të padrejtë dhe ka pasur zvarritje, duke ngritur dyshime se subjekti ka përfituar diçka. Denoncuesi i referohet vendimit nr. ***, datë 13.11.2019, të dhënë nga subjekti, që ka të bëjë me zëvendësim mase sigurimi dhe ka vënë në dispozicion disa akte shkresore. Pas shqyrtimit të akteve, me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime. Në parashtrimet e tij, në mënyrë të përmbledhur subjekti sqaroi se në rastin konkret: (i) duke vlerësuar se kishin ndryshuar kushtet dhe kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit, pasi në këtë fazë që ndodhej hetimi nuk ekzistonin shkaqe të rrezikshme që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e ndonjë prove; (ii) duke iu referuar faktit që nuk ekzistonte rreziku që i pandehuri të largohej; (iii) duke vlerësuar se masa e zbatuar nuk i përgjigjej më shkallës dhe nevojave të sigurimit për vetë faktin se i pandehuri kishte afro 5 muaj që ndodhej me masë sigurimi “Arrest në burg”, ka vlerësuar se është përballë kushteve që kjo masë sigurimi duhet të ndryshohej, duke caktuar si masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti sqaroi se lidhur me ndryshimin e kësaj mase sigurimi është shprehur dakord edhe organi i prokurorisë, i cili ka deklaruar përpara Gjykatës se hetimet për këtë të pandehur kishin përfunduar dhe se nuk ekzistonte rreziku i prishjes së provave apo dhe rreziku i ikjes së të pandehurit. Subjekti ka paraqitur vendimin e ILD-së, ku këto pretendime të denoncuesit ndaj subjektit janë arkivuar, pasi kanë të bëjnë me themelin dhe vlerësimin, si dhe vendimin nr. ***, datë 13.11.2019, të Gjykatës dhënë nga subjekti, i formës së prerë.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, argumentet e subjektit vlerësohen të bazuara dhe çmohet se ai ka vepruar sipas vlerësimit të rrethanave dhe provave. Po kështu, bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

50.10. Tri denoncime nga shtetasja S. B.

Denoncuesja ngre pretendime për disa gjyqtarë, përfshirë edhe subjektin Artan Hajredinaj. Në lidhje me subjektin pretendohet se subjekti ka ndërhyrë për transferimin e një çështjeje penale nga Prokuroria e Rrethit të Kukësit në atë të Tropojës. Me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës informoi se kërkesa e znj. B. me datë 3.10.2016 është padi civile në procesin penal nr. ***/***; kërkesa datë 5.10.2016 për heqje dorë nga gjykimi i procedimit penal nr. ***/*** të gjyqtarit Artan Hajredinaj; kërkesa datë 7.10.2016 për përjashtimin e gjyqtarit Artan Hajredinaj për gjykimin e çështjes penale nr. ***/*** – janë pjesë e dosjes penale, e cila ndodhet në Gjykatën e Lartë për shkak rekursi. Bashkëngjitur ka përcjellë disa akte shkresore, në analizë të të cilave Komisioni nuk konstatoi problematika në përfundim të hetimit administrativ.

50.11. Denoncim nga shtetasi A. Gj.

Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me prokurorin e çështjes, i cili ka vendosur mosfillimin e procedimit, si dhe ndaj subjektit, i cili me vendimin nr. ***, datë 15.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan të japë sqarime në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, duke paraqitur vendimin nr. ***, datë 15.10.2018, dhënë nga subjekti.

Në parashtrimet e tij, subjekti dha sqarime duke paraqitur dhe dokumentacion që në mënyrë të përmbledhur ka sqaruar se denoncuesi nuk ka qenë dakord me vendimmarrjen e tij dhe e ka ankimuar atë. Subjekti sqaroi se ka marrë informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Lezhë lidhur me ecurinë e hetimeve të lëna dhe i është vënë në dispozicion me *email* zyrtar vendimi për pezullimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në mbështetje të parashtrimeve dhe dokumenteve vërehet se qëndrimi që ai ka mbajtur në këtë çështje, në thelb ka të bëjë me themelin dhe vlerësimin e provave që ka pasur subjekti dhe,

bazuar pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

50.12. Denoncimnga shtetasi S. T.

Denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit për korrupsion, zvarritje të procesit etj., si dhe ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen pasi ka favorizuar palën tjetër, duke paraqitur disa dokumente shkresore. Në lidhje me vendimin datë 17.12.2014, subjektit iu kërkua të japë sqarime, ku duket se: (i) nuk ka trajtuar kërkesëpadinë në lidhje me paditësin R. T. dhe gjendjen juridike të të paditurit S. T. , në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) nuk u ka dhënë përgjigje kërkesave të paditësve, që të përcaktohet se cila është pjesa që mund të përdorin ato veçmas nga të paditurit, e aq më pak të ketë marrë një ekspert, i cili të përcaktonte nëse ishte i mundur ose jo ky përcaktim, duke zbatuar kriteret e kërkuara nga neni 259 i Kodit Civil.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se është e vërtetë se në arsyetimin e vendimit nuk është trajtuar padia në lidhje me paditësin R. T. dhe gjendjen juridike të të paditurit R. T., duke deklaruar se: *“Paditësi R. T., përveç faktit se ka qenë në certifikatën familjare të datës 30.10.1993, nuk ka jetuar dhe nuk jeton në atë banesë dhe nuk ishte cenuar asnjëherë në posedimin e kësaj banese, kjo e provuar nga aktet e dosjes dhe deklaratimet e palëve gjatë shqyrtimit të seancave gjyqësore. Për sa i përket gjendjes juridike të të paditurit S. T. , edhe për këtë provohet se përveç faktit se ka qenë në certifikatën familjare të datës 30.10.1993, nuk ishte poseduesi i kësaj banese, pasi ishte larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Provohet se konflikti i pretenduar ishte mes ish-bashkëshortëve S. T. dhe A. D., kjo për sa i përket pushimit të cenimit të pronësisë dhe rivendosjes në posedim, pra ka qenë kjo arsyeja që gjatë arsyetimit të vendimit ka analizuar pretendimet dhe konfliktin midis paditësit S. T. dhe paditëses A. D. Në arsyetimin e vendimit është shprehur se paditësi S. T. nuk është cenuar në asnjë moment në posedimin e kësaj banese dhe, duke qenë se nuk është cenuar, nuk kishte arsye për rivendosje në posedim”*.

Lidhur me sqarimet për sa i përket ndarjes së sipërfaqes së banesës, sipas subjektit kjo kërkesë ishte duke u shqyrtuar pranë një gjyqtari tjetër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Një fakt i tillë provohet edhe nga kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, e paraqitur nga gjyqtari E. C., në të cilën ky gjyqtar ka deklaruar se ka shkaqe të arsyeshme, pasi aktualisht është duke gjykuar çështjen civile ndërmjet këtyre palëve ndërgjyqëse me objekt “Pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore”.

Gjithashtu, sipas subjektit, nga ana e paditësit nuk u paraqit asnjëherë ndonjë kërkesë për ndarjen e banesës apo për caktimin e ekspertit. Subjekti sqaron se pasuria objekt konflikti nuk ishte regjistruar dhe nuk dispononin certifikatë pronësie. Paditësi S. T. dhe pjesëtarët e trungut familjar nuk ishin pajisur me kontratat e kalimit të pronësisë. Duke mos qenë të pajisur me certifikatë pronësie, në arsyetimin e vendimit është shprehur vetëm sa i përket posedimit të tyre, pasi nuk provohej pronësia me prova shkresore të ligjshme.

Subjekti paraqiti disa dokumente, si kërkesë të gjyqtarit E. Ç. për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes me nr. *** akti, me arsyetimin se është duke gjykuar ndërmjet këtyre ndërgjyqësve me objekt pjesëtim pasurie etj; procesverbale të seancave përgatitore të çështjes me nr. *** regjistri me paditë S. T., R. T., A. T., të paditur H. D. dhe S. T. , me objekt pushim cenimi posedimi dhe ndarje banese etj. me gjyqtar E. Ç.; akte nga dosje e çështjes nr. *** regjistri, dhe vendim nr. *** regjistri, me nr. **, datë 17.12.2014, të shqyrtuar nga subjekti etj.

Në analizë të sqarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur vlerësohet se subjekti ka argumentuar mjaftueshëm qëndrimin e tij dhe se vendimmarrja është bërë në vlerësim të provave dhe rrethanave të evidentuara gjatë trajtimit të çështjes.

50.13. Denoncim nga ***

Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me një çështje gjyqësore civile, me palë paditëse shtetasit L. dhe M. H. dhe palë e paditur *** etj., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së hipotekimit, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së kredisë dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, por nuk ka paraqitur dokumentacion.

- Sipas denoncuesit, kredimarrësit dhe hipotekuesit H. H. dhe S. H. kanë lidhur kontratën e kredisë dhe të hipotekës në datën 28.5.2007, duke lënë si garanci apartamentin nr. ***. Gjatë veprimeve përmbarimore ka rezultuar se në këtë apartament ishte bërë një shtesë dhe sipas kontratës së kredisë edhe kjo shtesë në përfundim të veprimeve përmbarimore i ka kaluar në pronësi bankës. Më pas, shtetasit L. dhe M. H. në datën 12.10.2007 kanë paraqitur padi për pavlefshmëri absolute të kontratave, me pretendimin se pasuria ka qenë në bashkëpronësi të të dyve dhe të prindërve H. H. dhe S. H. dhe subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018, e ka pranuar padinë.

- Denoncuesi në mënyrë të përmbledhur pretendon se subjekti në mënyrë të gabuar ka pranuar padinë, pasi paditësit nuk legjitimohen për ngritjen e kësaj padie, duke mos qenë bashkëpronarë, po ashtu edhe për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, pasi kjo e drejtë ishte parashkruar; subjekti është shprehur përtej asaj që është kërkuar, në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile; ka zvarritur shpalljen e vendimit të arsyetuar përtej afatit 20-ditor.

Nga verifikimi në sistemin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton vendimi me nr. çështjeje ***, me palë M. H. dhe të tjerë, kundër: S. H. dhe të tjerë për pavlefshmëri të veprimit juridik, me gjyqtar Artan Hajredinaj, shpallur në datën 21.5.2018. Subjekti ka marrë në analizë legjislacionin, ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimet”, Kodin Civil dhe Kodin e Familjes. Nga verifikimi në sistemin e Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton vendimi me nr. çështjeje ***, me palë M. H. dhe të tjerë, kundër: *** sh. a. Tiranë, dhe të tjerë për pavlefshmëri të veprimit juridik, ku në përfundim Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 21.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se: (i) paditësit nuk kanë një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil, duke qenë se nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse, si dhe nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar; (ii) paditësit nuk kanë legjitimitet aktiv për ngritjen e kërkesëpadisë për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së hipotekimit dhe për kërkimet e tjera të parashtruara në kërkesëpadi, që kanë të bëjnë me procedurat përmbarimore.

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se në kohën e lidhjes së kontratës është vënë në garanci një pasuri me sipërfaqe 56.1 m², por kredimarrësi në fakt, krahas kësaj pasurie, kishte ndërtuar dhe një shtesë të legalizuar me 51.9 m². Në total, pasuria shkon në 108 m² dhe, sipas subjektit, këtu qëndron konflikti, pasi banka ka kërkuar vënien në sekuestro të së gjithë sipërfaqes totale të kësaj pasurie. Subjekti shpjegoi se me vendimin e përmbaruesit gjyqësor nr. ***, datë 16.5.2012, është vendosur kalimi në pronësi të *** sh.a. të pasurisë së paluajtshme apartament nr. ***, me sipërfaqe totale 56.1 m² + 51.9 m² shtesa, në total 108 m².

Pra, sipas subjektit, edhe pse është vendosur në hipotekë një pasuri me sipërfaqe totale 56.1 m², veprimet e përmbaruesit janë shtrirë mbi të gjithë pasurinë, konkretisht edhe mbi pasurinë me sipërfaqe 59.1 m², pasuri ku paditësit janë bashkëpronarë të saj, pasi kjo shtesë është krijuar pas legalizimit. Sipas subjektit, ky ka qenë edhe fakti që ai ka legjitimuar paditësit në këtë kërkim dhe u ka dhënë të drejtë, pasi ka vlerësuar se nga Banka nëpërmjet përmbaruesit u ishte marrë pasuria prej 59.1 m², e cila nuk ishte vënë në hipotekë në momentin e marrjes së kredisë. Pikërisht për këtë shkak në arsyetimin e vendimit i është referuar ligjit për legalizimin.

Subjekti sqaroi se Gjykata e Apelit nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e palëve, por këtë gjë nuk mund ta komentojë, pasi është e drejta e palëve t'i drejtohen një gjykate më të lartë e cila mund ti japi të drejtë dhe subjektit pas vendimmarrjes dhe se ai nuk ka informacion nëse kjo çështje është ankuar në Gjykatën e Lartë.

Sa i përket denoncimit për zvarritjen e shpalljes së vendimit, subjekti shpjegoi se sipas vendimit të ILD-së është vendosur arkivimi i ankesës pas shqyrtimit fillestar, pra nuk i është konsideruar shkelje.

Subjekti ka paraqitur disa dokumente, si vendimin nr. ***, datë 21.5.2018, të dhënë prej tij, vendimin e Gjykatës së Apelit nr. ***, datë 17.3.2021, vendimin nr. *** prot., datë 19.1.2023, të ILD-së.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, vërehet se pavarësisht se Gjykata e Apelit ka bërë vlerësim ndryshe të fakteve dhe ligjit me atë të bërë prej tij, subjekti në vendimin e dhënë ka bërë parashtrimin e fakteve dhe rrethanave, si dhe ka arsyetuar mbi normat ligjore të aplikueshme për zgjidhjen e çështjes. Konkretisht, subjekti i është referuar edhe ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin", pasi siç dhe rezultoi, përveç hipotekimit mbi sipërfaqen e regjistruar prej 56.1 m², është vënë sekuestro edhe mbi shtesën me sipërfaqe prej 59.1 m², ndërsa Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit nuk është shprehur në lidhje me këtë çështje, por vetëm sa i takon sipërfaqes së regjistruar prej 56.1 m². Për rrjedhojë, për sa kohë që subjekti sipas logjikës së tij ka bërë interpretimin e aplikimit të ligjit, duke e arsyetuar qëndrimin e tij dhe i ka dhënë zgjidhje themelit të çështjes, ndonëse ndryshe nga ai bërë nga Gjykata e Apelit, nga ana e Komisionit vlerësohet se në këtë rast denoncimi në thelb ka të bëjë me themelin e çështjes, ndërsa nuk evidentohet ndonjë parregullsi nga ana e subjektit. Në këto kushte, vendimmarrja e subjektit sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 nuk mund të vlerësohet nga Komisioni si organ vlerësues, i cili çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Edhe sipas vendimit nr. *** prot., datë 19.1.2023, të ILD-së, i cili ka marrë në shqyrtim pretendimet e denoncuesit në lidhje me këtë rast, rezulton të jetë shprehur se këto pretendime i takojnë të shqyrtohen nga një gjykatë më e lartë.

50.14. Denoncim nga shtetasja V. M.

Denoncuesja ngre pretendime ndaj subjektit në lidhje me një çështje penale që ka të bëjë me procedimin penal nr. ***/***. Sipas saj, subjekti ka zvarritur me qëllim çështjen, pasi është regjistruar që në datën 2.11.2022 dhe nuk ka dhënë vendim, duke bërë shtyrje seance në favor të shtetasit A. I., sot avokat. Sipas denoncueses, subjekti është i korruptuar dhe i paaftë. Nuk ka paraqitur dokumentacion. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet e ngritura në denoncim, si dhe të paraqesë të gjitha procesverbalet e seancave gjyqësore në lidhje me çështjen penale që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2009.

Në parashtrimet e tij, subjekti dha sqarime si në lidhje me zhvillimin e seancave, duke dhënë shpjegime të detajuara. Subjekti sqaroi se ka bërë të gjitha përpjekjet për të përfunduar këtë çështje, por nuk ka përfunduar, për shkak se nga kallëzuesja nuk pranohej mbrojtja kryesisht nga avokatja e caktuar nga Gjykata. Subjekti, pasi i është drejtuar disa herë Dhomës së Avokatisë Lezhë, ka bërë të mundur që kallëzueses t'i caktohej avokat kryesisht. Duke qenë se ai me vendimin e KLGJ-së është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas urdhrin nr. ***, datë 31.10.2023, është bërë rishortimi i dosjes, duke i rënë për gjykim gjyqtarit A. K. Subjekti paraqiti disa dokumente, si procesverbale të seancave gjyqësore (të marra nga sistemi), si dhe shkresat e bëra nga ana e tij për zhvillimin e këtij gjykimi, të cilat provojnë pretendimet e tij. Në përfundim vlerësohet se argumentet e subjektit janë bindëse dhe nuk konstatohen problematika.

50.15. Denoncim nga një *** i Lezhës (anonim)

Denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit për korrupsion për një rast të bërë publik edhe në media, pasi sipas tij, në kundërshtim me ligjin dhe provat akt ekspertimi, ka dënuar me shërbim prove shkaktarin e aksidentit të ndodhur në muajin maj të vitit 2021, ku ka humbur jetën infermierja M. Gj. dhe u plagosën 4 pjesëtarët e familjes së saj, mes të cilëve dhe një fëmijë 2 vjeç. Sipas denoncuesit, akuza kishte arritur të provojë se shkak i aksidentit ishte parakalimi i gabuar dhe në konkluzionet përfundimtare kishte kërkuar 11 vite burg. Nuk ka paraqitur dokumentacion.

Nga ana e Komisionit u kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosja gjyqësore, e cila informoi se çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vuri në dispozicion vendimin nr. ***/***, datë 28.3.2022, dhe dosjen nr. *** vendimi, datë 21.7.2022, për korrigjim gabimi material. Nga përmbajtja e këtij vendimi, ndër të tjera rezulton se:

- Në datën 8.5.2021 ka ndodhur aksidenti automobilistik, ku janë përfshirë disa mjete dhe si pasojë e përplasjes shtetasja M. P. ka gjetur vdekjen, shtetasit N. P., B. P. dhe i mituri 2 vjeç kanë pësuar dëmtime në masën mbi 9 ditë, ndërsa shtetasja G. P. ka pësuar dëmtime, të cilat kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkakut.

- Sipas aktit të ekspertimit autoteknik me grup ekspertësh, rezulton se shkak primar në ardhjen e aksidentit ishin shkeljet e kryera nga drejtuesi E. N.

- Nga ana e prokurorisë është kërkuar dënim për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal me 1 vit burgim; 3 vite burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal; 7 vite burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit me 11 vite burgim dhe në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht me 7 vite e 4 muaj burgim, në bazë të nenit 37 të Kodit Penal ndalimin për drejtimin e mjetit me 3 vite.

- I pandehuri ka kërkuar të dënohet nën minimumin që parashikon ligji dhe dënimin alternativ.

Sipas arsytimit të vendimit nga ana e subjektit të rivlerësimit vërehet se:

- Rezulton se provat e administruara janë të mjaftueshme për të konkluduar me fajësinë e të pandehurit E. N. me pasojë tri plagosje të lehta, një plagosje e rëndë dhe një vdekje, parashikuar nga neni 290/1/2/3 i Kodit Penal;

- Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit është arsyetuar se veprat penale bartin rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe çmon se ndaj të pandehurit duhet të aplikohet lloji i dënimit me burg, ndërsa si masë dënimi për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, 6 muaj burgim; 2 vite burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal; 5 vite burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 55/3 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit me një dënim të vetëm prej 6 vitesh burgim dhe në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, duke u dënuar përfundimisht me 4 vite burgim.

- I pandehuri plotëson kushtet e posaçme për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, të evidentuara në gjykim nga mbrojtja (paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore, pasi është i padënuar më parë, i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen, i pandehuri ka pasur sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale, *fakti që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe të viktimave të veprës penale janë normalizuar*).

- Sipas vendimit nr. ***, datë 21.7.2022, subjekti ka bërë korrigjimin e gabimit material në vendimin gjyqësor nr. ***/***, datë 28.3.2022, konkretisht fjalinë: *fakti që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe viktimave të veprës penale janë normalizuar*, e ka korrigjuar në *faktin që marrëdhëniet mes familjes së tij dhe të viktimave të veprës penale janë tentuar të normalizohen*.

Për sa më sipër, nisur nga arsyetimi i subjektit se plotësohen kushtet e posaçme në referencë të dispozitës materiale 59 të Kodit Penal, duket se aplikimi i këtij neni nuk është analizuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të saktë në raport me provat e cituara, pasi: (i) sa i takon rrezikshmërisë së pakët, përveç faktit se është i padënuar, nuk ka analizuar faktin se vepra për të cilën është deklaruar fajtor sipas nenit 290/3 paraqet rrezikshmëri të lartë, duke parashikuar një dënim deri në 10 vjet burgim, i pandehuri është hetuar dhe gjykuar në gjendje mase sigurimi “Arrest në burg”; (ii) sa i takon rrethanës së posaçme, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në konkluzionin se i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen; (iii) sa i takon rrethanave të kryerjes së veprës, nuk ka analizuar faktin se nga mënyra e kryerjes së veprës penale pasojat kanë qenë të rënda, me vdekje, dëmtime të rënda dhe me viktimitë të mitur; (iv) sa i takon sjelljes pas kryerjes së veprës penale, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në konkluzionin se i pandehuri ka pasur sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale. Sipas vendimit, nuk rezulton që i pandehuri të ketë shfaqur pendim të thellë për veprën penale; (v) sa i takon rrethanave lehtësuese, ajo e normalizimit të marrëdhënieve familjare, së cilës subjekti i është referuar për pezullimin e vendimit, siç rezultoi nga vendimi nr. ***, datë 21.7.2022, për korrigjim vendimi, ky fakt nuk ekziston, pavarësisht se pas dhënies së vendimit ka bërë korrigjimin e këtij fakti në tentativë për ta normalizuar. Për më tepër, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në këtë konkluzion. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si më sipër.

Në parashtrimet e tij, ku subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***/***, datë 28.3.2022 dhe shkresën e gjykatës për dërgimin e çështjes në Gjykatën e Apelit pasi është ankimuar nga prokuroria, dha shpjegime në lidhje me faktet e çështjes dhe interpretim të veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në mënyrë të përmbledhur, sipas tij në rastin konkret ka vlerësuar edhe marzhet e dënimit që legjislatori ka parashikuar për këtë veprë penale, ku p.sh. paragrafi i tretë parashikon një minimum dënimi prej 2 vitesh dhe maksimum deri në 10 vjet burgim, duke i lënë gjyqtarit të çështjes caktimin e një dënimi të përshtatshëm sipas rrethanave të çështjes apo kryerjes së veprës penale, në varësi të rrezikshmërisë së të pandehurit etj. Sipas tij, në këto kushte, duke marrë në konsideratë edhe rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, si person i padënuar më parë, gjendjen ekonomike e familjare të tij, qëndrimin e tij rreth akuzës, faktin që është hetuar e gjykuar në kushtet e masës së sigurimit “Arrest në burg”, kohën që kishte kaluar nën këtë masë sigurimi, faktin që marrëdhëniet mes tij dhe familjes së dëmtuar ishin drejt normalizimit, plotësoheshin të gjitha kushtet ligjore të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal.

Në analizë të parashtrimeve të tij vlerësohet se subjekti ka dhënë sqarime të përgjithshme pa qartësuar në lidhje me çfarë i është konstatuar në rezultatet e hetimit dhe duke iu referuar fakteve që subjekti ka përmendur në vendim, në përfundim të procesit vlerësohet se subjekti në këtë vendim ka cituar shkurtimisht kushtet e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal pa bërë një analizë të mirëfilltë të fakteve e rrethanave që kanë çuar sipas tij në plotësimin e këtyre kushteve (ky është një nga rastet kur çështja i është dërguar ILD-së). Megjithatë, pavarësisht paqartësive në arsyetimin e vendimit nga subjekti, nuk u vërtetua që këto mangësi në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal të kenë qenë një metodë pune e përsëritur prej tij, pasi në dy raste (trajtuar në paragrafët 50.2 dhe 50.5.1 të këtij vendimi) subjekti nuk ka pranuar aplikimin e kësaj dispozite ligjore. Ndërsa dy raste të tjera (trajtuar në paragrafin 50.4 dhe çështjes që i

përket dosjes nr. 5 të përzgjedhur me short), është vërtetuar që subjekti ka aplikuar drejt këtë dispozitë ligjore.

50.16. Denoncim nga * (anonim)**

Denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit, pasi sipas tij, në kundërshtim me ligjin, ka liruar nga burgu ish-kreun e Njesisë Administrative ***, Lezhë, shtetasin B. S., duke zëvendësuar masën “Arrest në burg” me atë “Arrest në shtëpi”, pavarësisht akuzës së rëndë “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtje pa leje”. Sipas denoncuesit, vendimi i dhënë në datën 5.10.2022 ka të bëjë me procedimin penal nr. ***/***, vendim i cili është ankimuar nga prokurori. Sipas denoncuesit, subjekti ka dhënë edhe vendime të tjera në kundërshtim me ligjin. Nuk ka paraqitur dokumentacion.

Nga ana e Komisionit u kërkuan nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjet gjyqësore që i përkasin vendimit datë 5.10.2022, si dhe vendimit për vleftësim arresti dhe caktim mase të sigurisë, me të dyshuar B. S. Kjo e fundit vuri në dispozicion dosjen penale me nr. ***, datë 4.4.2022, me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurie”, dosjen nr. ***, datë 7.6.2022, me objekt “Zëvendësim mase sigurie”, si dhe dosjen penale me nr. ***, datë 5.10.2022, me objekt “Zëvendësim mase sigurie”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e Komisionit nuk u konstatuan problematika në lidhje me rastin e denoncuar.

50.17. Pesë çështje të referuara nga organet ligjzbatuese, ku pas verifikimeve të kryera, në përfundim të hetimit administrativ, iu kërkuan sqarime subjektit në dy raste si vijon:

50.17.1. Me vendimin nr. ***, datë 13.3.2021, subjekti ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit L. N. dhe caktimin e masës së sigurisë “Arrest në burg”, me afat 20 ditë, parashikuar nga neni 238 dhe 245 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e Komisionit u administruan dosjet për tri çështje penale. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan arsyet e dhënies së kësaj mase. Në parashtrimet e tij sqaroi se arsyetimi i gjykatës për dhënien e kësaj mase ka të bëjë me lënien kohë palëve për sigurimin e provave për të përlegjur masën e sigurimit të kërkuar. Ndërsa dokumentacioni shëndetësor i administruar, sipas tij vërtetonte problematikën shëndetësore të të arrestuarit. Pikërisht në ditën e 19 të këtij afati, siç e përcakton edhe ligji, është paraqitur si kërkesa e prokurorit, ashtu dhe kërkesa e të pandehurit, të cilat janë shqyrtuar nga gjykata sipas kohës së paraqitjes. Vendimi i gjykatës ka qenë i bazuar si në provat e paraqitura, ashtu dhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është shprehur dakord për masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar se gjykata nuk mund të caktojë masë siguri më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Sipas tij, kemi të bëjmë me vendim të dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra është vendim i formës së prerë për dhënien e të cilit ka gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuara në atë gjykim. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim nga ana e Komisionit vlerësohet se argumentet e paraqitura janë të plota dhe bindëse, pasi bazohen në dokumentet shkresore të administruara.

50.17.2. Me vendimin nr. ***, datë 5.9.2021, subjekti ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së shtetasit K. N., vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit të mitur në konflikt me ligjin K. N., si dhe ka caktuar si masë sigurie “Detyrim paraqitjeje” në policinë gjyqësore. Kundër vendimit nr. ***, datë 5.9.2021, ka bërë ankim prokuroria duke kërkuar caktimin e masës së sigurisë, atë “Arrest në burg”. Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 23.9.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 5.9.2021, me këtë ndryshim: Caktim mase sigurie për shtetasin K. N. “Arrest në shtëpi” etj. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se *vlerëson se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturve në konflikt me ligjin, parashikuar nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale. Çmohet se shkaqet e ankimit të prokurorit për caktimin e masës “Arrest në burg” janë të pabazuara në ligj, por duhet pranuar pjesërisht për caktimin e një mase tjetër, si ajo “Arrest në shtëpi”*. Sipas Apelit, për të miturit K. N. dhe L. F., dyshimi për veprat penale, bazuar në nenet 283/2 dhe 278/1 të

Kodit Penal, nuk është i supozuar, por i bazuar në prova. Subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me dhënien e një mase sigurimi të butë për shtetasin K. N., për të cilin Gjykata e Apelit ka vlerësuar se është në kundërshtim me provat. Në parashtrimet e tij, subjekti duket se i qëndron arsytimit në vendimin e tij pasi nuk dha sqarime, por ka paraqitur vendimin e dhënë prej tij dhe vendimin e Gjykatës së Apelit, administruar më parë nga Komisioni. Si konkluzion, edhe pse subjekti nuk dha ndonjë sqarim, pra i mbetet arsytimit të dhënë me vendimin e tij, nga ana e Komisionit vlerësohet se në këtë rast kemi të bëjmë me vlerësim të ndryshëm të rrethanave dhe provave nga subjekti pasi, siç rezultoi, vlerësimi i prokurorit nuk u gjend i bazuar nga Gjykata e Apelit, e cila ka bërë tjetër vlerësim të provave. Për rrjedhojë, nisur edhe nga natyra dhe rrethanat e çështjes, ky rast nuk vlerësohet se mban ndonjë peshë për efekt të procesit të rivlerësimit sa i përket aftësive profesionale.

50.18. Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi dhe marrëdhëniet me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj, shtetasin A. N. alias A. L., nga verifikimi në sistemin e QKB-së rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., me të cilën subjekti ka lidhur një kontratë porosie në vitin 2007, është regjistruar në datën 1.7.1996, me administrator E. N. Sipas akteve të depozituara në vitin 2005 është bërë ortak në shoqëri shtetasi A. N. , i cili është caktuar si administrator (në këtë cilësi ka qenë në vitin 2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes nga subjekti i rivlerësimit) dhe në vitin 2014 ka ndryshuar emrin në A. L. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka informuar si vijon:

Së pari, Artan Hajredinaj ka gjykuar çështjen që i përket vendimit nr. ***, datë 26.4.2022, me palë paditëse M. O., e paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “Lirim dorëzim sendi”, ku është vendosur pushimi i çështjes. Nga përmbajtja e vendimit vërehet se çështja është regjistruar në datën 26.10.2021. Paditësi është i përfaqësuar nga av. B. Gj. Në seancën përgatitore datë 26.4.2022, gjykata, pasi ka verifikuar se palët kanë dijeni për zhvillimin e seancës, pala e paditur është njoftuar me shpallje, nuk janë paraqitur për ndonjë shkak të arsyeshem, në bazë të nenit 197/1 ka vendosur pushimin e çështjes. Gjithashtu ka arsyetuar dhe faktin se avokati i palës paditëse, pas disponimit të gjykatës për pushimin e çështjes, në orën 10:52 ka depozituar në kryesekretari kërkesë për shtyrje seance, për shkak se i duhej të ishte në një tjetër çështje në Durrës, por nuk ka bashkëngjitur asnjë akt përfaqësimi.

Sa më sipër, është e paqartë përse subjekti nuk ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje, ashtu siç ka vepruar në çështjet më poshtë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë fakt, duke vërtetuar që nuk është në kushtet e pengesës ligjore sipas nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile. Në parashtrimet e tij, lidhur me mungesën e heqjes dorë në këtë rast, subjekti sqaroi se kjo çështje është regjistruar në vitin 2021. Ndërkohë, tashmë kishte një praktikë (vendim gjyqësor) për konstatimin e mosekzistencës së shkaqeve për heqjen dorë të subjektit nga shqyrtimi i çështjes penale me palë A. N. , pasi në vitin 2019 kërkesa e tij për heqje dorë nuk ishte pranuar nga gjykata. Për këtë arsye, ka vlerësuar se paraqitja e një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me palë paditëse M. O. dhe palë të paditur “****” sh.p.k., për shkak të nënshkrimit nga ana e tij të një kontrate sipërmarrjeje në vitin 2007, do të konsiderohej sërish si i pabazuar nga gjykata. Ndërsa kërkesën e tij për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me nr. akti ***, datë 17.1.2023, Gjykata e Apelit Shkodër e ka vlerësuar si të bazuar. Sipas subjektit, pavarësisht gjeneraliteteve të palëve ndërgjyqëse, për këtë vendimmarrje (pushim gjykimi) shkaku ka qenë qëndrimi i palës paditëse, duke mos u paraqitur në proces pa ndonjë shkak të arsyeshem, me pasojë aplikimin e nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithsesi, pala paditëse pas vendimit të tij për pushimin e gjykimit mund t’i drejtohet sërish gjykatës me të njëjtën padi. Në analizë të parashtrimeve, vlerësohet se sqarimet e subjektit janë të plota dhe bindëse. Siç ka rezultuar, subjekti që në vitin 2019, në kërkesën e tij për heqje dorë në shqyrtimin e një çështjeje penale me palë shtetasin A. N. , ka parashtruar si shkak pikërisht faktin se ai në datën 12.12.2007 ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje për llogari të vëllait të tij H. H. , ku shtetasi A. N. ka qenë përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe kjo kërkesë nuk

është pranuar nga kryetarja e gjykatës. Përpos kësaj, përveç faktit që marrëdhënia e subjektit me shoqërinë ka qenë përpara rreth 15 viteve, si dhe në rastin konkret nuk është zgjidhur çështja në themel.

Së dyti, çështja civile nr. akti ***, datë 17.1.2023 (pra, regjistruar më vonë se çështja e sipërpërmendur), me palë shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt “Sigurim padie dhe zgjidhje kontrate”, me shortin e datës 18.1.2023 i ka kaluar z. Artan Hajredinaj, i cili me kërkesën nr. *** regj. them., datë 17.1.2023, ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin datë 26.1.2023 ka vendosur miratimin e kërkesës së gjyqtarit Artan Hajredinaj dhe nga rishortimi i ka kaluar një gjyqtari tjetër. Nga përmbajtja e vendimit datë 26.1.2023 të Gjykatës së Apelit, e cila ka pranuar kërkesën e subjektit, vërehet se subjekti ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, duke parashtruar si shkak faktin se ai në datën 12.12.2007 ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje nr. ***/*** tek noteri M. V. për llogari të vëllait të tij H. H. , i cili në atë kohë ndodhej në Angli etj., duke bërë shënimin se apartamenti porositet nga z. H. H. , i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare, kontratë e cila është lidhur në datën 5.1.2019. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ai dhe vëllai nuk kanë ndonjë marrëdhënie interesi me shtetasin në fjalë, por duke qenë në të tilla kushte subjekti ka çmuar se në bazë të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile ka pengesa ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje. Siç vërehet, në këtë çështje subjekti ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i saj.

Së treti, me shtetasin A. U. N. dhe A. U. L. (i njëjti person) janë regjistruar tri çështje penale që u përkasin vendimeve si vijojnë:

a. Vendimi nr. ***, datë 13.5.2019, me objekt miratimin e arrestit provizor dhe caktim mase sigurimi për shtetasin për shtetasin A. L. alias A. N. . Me kërkesën datë 11.5.2019 Artan Hajredinaj ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi, ndërsa kryetarja e gjykatës me vendimin datë 13.5.2019 ka vendosur mospranimin e heqjes dorë. Nga përmbajtja e kërkesës për heqjen dorë vërehet se subjekti ka parashtruar të njëjtat shkaqe si në rastin e çështjes së sipërcituar, ndërsa kryetarja e gjykatës me vendimin datë 13.5.2019 ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, duke arsyetuar ndër të tjera se në thelb nuk ka marrëdhënie kontraktore ndërmjet gjyqtarit dhe shtetasit A. L. alias A. N. , por vetëm që ka pasur ndërmjet vëllait të gjyqtarit dhe personit juridik “****” sh.p.k. dhe kjo shoqëri tashmë ka përfaqësues shtetasin E. N. dhe jo shtetasin A. L. alias A. N. ; me regjistrimin e pasurisë ka përfunduar marrëdhënia kontraktore dhe, sipas kërkesës, as gjyqtari dhe as vëllai i tij nuk kanë ndonjë marrëdhënie tjetër interesi apo marrëdhënie të tjera me shtetasin A. L. alias A. N. .

Sa i takon vendimit nr. ***, datë 13.5.2019, të dhënë nga subjekti për miratimin e arrestit provizor dhe caktim mase sigurimi për shtetasin A. L. alias A. N. , vërehet se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar miratimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë “Arrest në burg” me afat 40-ditor. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë fillimisht ka kërkuar miratimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë “Arrest në burg” me afat 40-ditor, ndërsa në seancën gjyqësore prokurori ka kërkuar masën “Arrest në shtëpi” për shkak të gjendjes të të arrestuarit. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se duke pasur në konsideratë gjendjen jo të mirë shëndetësore sipas provave në dosje, duhet pranuar kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Lezhë, duke caktuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit me qëllim ekstradimit dhe caktimin e masës “Arrest në shtëpi” me afat 40 ditë. Pra, subjekti ka vendosur sipas kërkesës së prokurorit.

b. Vendimi nr. ***, datë 2.4.2020, me objekt zëvendësim mase sigurimi, me kërkues A. N. . Nga përmbajtja e këtij vendimi vërehet se A. L. alias A. N. ka kërkuar zëvendësimin e masës “Arrest në shtëpi” me një masë më të butë për shkak të problemeve shëndetësore, pasi duhej të paraqitej herë pas here në spital. Prokuroria e ka kundërshtuar këtë kërkesë, me argumentin se i arrestuari nuk është penguar ndonjëherë për t’u paraqitur në spital. Përfundimisht, subjekti nuk e ka pranuar kërkesën e shtetasit A. N. .

c. Me kërkesë të Komisionit, GJSHPJP Lezhë vuri në dispozicion dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 10.9.2020, me objekt “Lejim ekstradimi të A. L. alias A. N. ”, ndërsa PPSHPJP Lezhë vuri në dispozicion dosjen e kërkesës së ekstradimit të shtetasit A. L. Nga përmbajtja e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera është arsyetuar se:

- Prokuroria e Rrethit Lezhë ka paraqitur kërkesë për lejimin e ekstradimit të shtetasit A. L. alias A. N. për në Itali. Prokuroria e Milanos ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vuajtjen e dënimit të vendimit datë 5.6.2012 të Gjykatës së Apelit Milano, të formës së prerë, me anë të të cilit është dënuar me 10 vjet burgim, gjykim i cili është bërë në mungesë të shtetasit shqiptar.

- Ministria e Drejtësisë Italiane i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare me kërkesë për ekstradimin e shtetasit A. L. alias A. N. .

- Referuar shkresës nr. *** prot., A. H., datë 10.8.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, është konfirmuar se nga shteti italian mbetet në fuqi kërkesa e Prokurorisë së Milanos për ekstradimin e këtij shtetasi.

- Nga ana e autoriteteve italiane gjykimi është bërë në mungesë dhe nuk është dhënë garanci për rishikimin e vendimit, pavarësisht kërkesave të përsëritura të gjykatës për t’u shprehur në lidhje me këtë kërkesë dhe konkretisht kërkesat e bëra në datat 1.10.2019, 6.11.2019, 22.1.2020, 6.3.2020, 20.5.2020 dhe 29.6.2020.

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë në përfundim të gjykimit kërkoi të mos lejohet ekstradimi i të gjykuarit A. L. alias A. N. për shkak se shteti kërkues nuk jep garanci.

- Në përfundim subjekti, bazuar në nenin 491/f të Kodit të Procedurës Penale, ka arsyetuar se për gjykatën, mosdhënia e garancisë për rishikimin e vendimit (të dhënë në mungesë të të pandehurit) nga shteti kërkues, përbën pengesë të pakapërcyeshme për lejimin e ekstradimit (sipas kësaj dispozite ligjore nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit).

Nisur nga ky arsyetim i subjektit, u shqyrtuan aktet e dy dosjeve penale, nga ku konstatohet se:

i) Sipas shkresës datë 13.7.2015 të titulluar “Ekspozimi i fakteve kriminale”, Prokuroria e Republikës me seli në Gjykatën e Apelit në Milano, ka konfirmuar gjykimin në mungesë të të pandehurit, duke u shprehur se në rast vendimi në mungesë, sistemi juridik italian jep garanci juridike të parashikuara nga neni 175 i Kodit të Procedurës Penale, i cili në paragrafin 2 parashikon që për vendimet në mungesë i pandehuri ka mundësi që me kërkesë të tij të propozojë ankesë ose kundërshtim.

ii) Sipas kërkesës për difuzion datë 5.11.2018 të Interpolit për shtetasin A. N., rezulton se subjekti (i pandehuri) nuk ishte i pranishëm në gjykatë kur u dha vendimi gjyqësor dhe se ka ose do të ketë mundësinë për rigjykimin e çështjes në prani të tij.

iii) Me shkresën nr. ***/*** prot., datë 18.5.2020, Prokuroria e Përgjithshme e Republikës pranë Gjykatës së Apelit Milano ka informuar se ekstradimi kërkohet vetëm për vendimin nr. ***/***, datë 21.12.2007. Po kështu, informon se në urdhrin e arrestit evropian me datë 2.11.2018 është specifikuar se i dënuari është deklaruar si në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë, në kërkim e në mungesë, me mundësinë për të paraqitur kërkesë sipas nenit 175 të Kodit të Procedurës Penale pas dorëzimit të tij.

Bazuar në aktet si më sipër, duket se shteti italian i ka dhënë garanci të pandehurit për rishikimin e vendimit, ndërkohë subjekti në vendimin e tij për refuzimin e ekstradimit të shtetasit A. L. alias A. N. , nuk rezulton që të ketë përmendur apo analizuar faktet e mësipërme, por është shprehur që nga ana e autoriteteve italiane nuk është dhënë garanci për rishikimin e vendimit. Për një vlerësim sa më objektiv, Komisioni i është referuar edhe një rasti të ngjashëm të trajtuar me vendim të Gjykatës së Lartë, nr. ***, datë 27.10.2022, me objekt “Ekstradimi nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë”.

50.19. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se: (i) subjekti i rivlerësimit ka refuzuar lejimin e ekstradimit të shtetasit A. L. alias A. N. në kundërshtim me provat dhe nenin 491/f të Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjekti i rivlerësimit e ka zvarritur çështjen për një vit, pavarësisht nga informacioni i disponueshëm në dosje, për garancitë për shqyrtimin e çështjes nga autoritetet italiane. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të provojë të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

50.20. Në parashtrime¹⁴ subjekti sqaroi si vijon:

- Në seancë gjyqësore është kërkuar nga mbrojtësi dhe i arrestuari që në mbështetje të nenit 491, shkronja “f” e Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se është dënuar në mungesë në shtetin italian, t’i kërkohet këtij shteti që të jepet garancia rishikuese. Pasi edhe prokurori ishte dakord, me vendim të ndërmjetëm, gjykata pranoi këtë kërkesë dhe iu drejtua autoriteteve italiane me kërkesën për garancinë rishikuese. Për të marrë përgjigje lidhur me këtë kërkesë, i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme me letërporosi për mbi një vit autoriteteve italiane, të cilët nuk sollën asnjëherë përgjigje. Subjekti sqaroi se, në datën 10.8.2020 nga autoritetet italiane të drejtësisë u kërkua revokimi i pjesshëm i kërkesës së ekstradimit, urdhrin të mbajtes në paraburgim datë 31.3.2005 të gjykatës së hetimit paraprak L. I. Po në këtë kërkesë autoritetet italiane shprehen se mbetet në fuqi kërkesa e ekstradimit që lidhet me urdhrin e ekzekutimit nr. ***/**/2018, i nxjerrë nga Prokuroria e Përgjithshme e Republikës pranë Gjykatës së Milanos më 25.10.2018, për vendimin nr. ***/**/2012, datë 5.6.2012, të Gjykatës së Apelit Milano. Pra, edhe sipas kësaj shkrese autoritetet italiane të drejtësisë nuk dhanë garancinë rishikuese.

- Lidhur me këtë çështje subjekti bën një analizë të nenit 491 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe faktit se pse ka konkluduar në atë vendimmarrje, vendim të cilin e konsideron si një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë edhe me një vendim të formës së prerë, të dakordësuar edhe nga organi i akuzës.

- Sipas tij, autoritetet italiane kanë kthyer përgjigje duke referuar vetëm kuadrin ligjor, konkretisht neni 175 i Kodit të Procedurës Penale, të cilët janë njaftuar me citimin e nenit 175 të Kodit të Procedurës Penale duke nënkuptuar në këtë mënyrë faktin se legjislacioni italian ofron garanci që i pandehuri të rivendoset në afatin e të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor që e ka deklaruar fajtor. Sipas subjektit, Kodi i Procedurës Penale Italiane ka parashikuar institutin e rivendosjes në afat (*restituzione nel termine*), duke parashikuar se: *“Prokurori, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afat nëse provojnë se nuk kanë mundur të ushtrojnë ankim për shkak të rastit fajtor apo forcës madhore... I dënuari i gjykuar në mungesë, që nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor, me kërkesë të tij mund të rivendoset në afat”*.

- Sipas tij, referuar nenit 175 analog me nenin 147 të Kodit të Procedurës Penale Shqiptar, eventualisht, nëse do të bëhej dorëzimi i shtetasit shqiptar në kuadër të procedurës së ekstradimit, neni 175 i Kodit të Procedurës Penale Italiane nuk do të garantonte gjykimin e çështjes dhe të akuzave nga e para (sikur procesi i mëparshëm të mos kishte ekzistuar) por do të mjaftohej me garantimin e të drejtës së ankimit në Gjykatën e Apelit, duke i humbur në këtë mënyrë shtetasit A. L. një shkallë gjykimi. Në këtë kontekst, ka vlerësuar se në asnjë rast neni 175 i Kodit të Procedurës Penale nuk garantonte “Rishikimin nga e para të akuzave të ngritura ndaj shtetasit A. L. Për më tepër që, do të ishte ky i fundit që do të kishte barrën e provës pranë autoriteteve gjyqësore italiane për të provuar se nuk ka pasur dijeni për procesin dhe se ankimi nuk është ushtruar pikërisht për këtë shkak”.

- Sipas subjektit, koncepti i garancisë për rishikim, nuk nënkupton se ligji ofron mekanizma për të rivendosur në vend të drejtën e pretenduar të shkelur dhe gjykimin e çështjes nga e para,

¹⁴ Subjekti ka paraqitur disa dokumente nga dosja nr. vendimi ***, datë 10.9.2020, si dhe kopje vendimi nr. ***, datë 22.7.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

por kërkon që garancia të jetë e shprehur dhe të jepet nga titullari i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, përfaqësues i autoritetit qendror, që në rastin e shtetit italian dhe shqiptar është ministri i Drejtësisë. Ndaj ka vlerësuar se garancia e dhënë nga pala italiane në këtë rast nuk përmbushte kriterin e garancisë që kërkon Konventa e Vjenës dhe Kodi i Procedurës Penale Shqiptare, për miratimin e ekstradimit në kuadër të përmbushjes së kushtit të mësipërm, bazuar në nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale.

- Subjekti parashtron se sipas praktikave të mira në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ministri i Drejtësisë jep garancinë e shprehur se nëse ekstradimi do të realizohet, të dënuarit do t'i jepet mundësia që të gjykohet nga e para për akuzat e ngritura ndaj tij. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës sonë Kushtetuese, është trajtuar koncepti i “garancisë për rishikim”. Referuar vendimit nr. ***, datë 29.4.2010, paragrafi 2 ka këtë përmbajtje: “...Vendimi gjyqësor i formës së prerë është ekzekutuar në muajin shtator të vitit 2007, kohë në të cilën është pranuar kërkesa e shtetit shqiptar për ekstradimin e kërkuarit nga Spanja”.

- Në interpretim të “garancisë së shprehur për rishikim”, Gjykata Kushtetuese analizon se ...kur një nga shtetet palë kërkon nga shteti tjetër palë ekstradimin e një personi për qëllim të ekzekutimit të një vendimi ose dënimit të vendosur nga një vendim i dhënë ndaj tij in absentia, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse, sipas saj, procedurat që çuan në marrjen e atij vendimi nuk kanë kënaqur të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për çdo person që akuzohet penalisht.

- Sipas subjektit, bazuar në parimet e mësipërme, është vendosur rrëzimi i kërkesës për ekstradim, pasi mungonte garancia e shprehur për rishikim, e cila në kushtet e gjykimit/dënimit në mungesë të shtetasit A. L. duhej dhënë në mënyrë të shprehur ashtu siç konventa evropiane për ekstradimin dhe protokollat shtesë e parashikojnë. Vetëm parashikimi ligjor i rivendosjes në afat, i pashoqëruar me garancinë për rishikim, nuk krijonte premisa të mjaftueshme se për akuzat e ngritura ndaj tij shtetasit A. L. do t'i garantohej një gjykim në themel në të tria shkallët e gjyqësorit italian.

- Gjithashtu, sipas tij, vlen të përmendet fakti se Prokuroria është tërhequr nga kërkesa për ekstradim. Për Gjykatën, tërheqja e prokurorit nga kërkesa e paraqitur nga vetë ai është e tillë që nuk ofron më lëndë gjykimi dhe për Gjykatën nuk ka alternativë tjetër përveçse të vendoset rrëzimi/mospranimi i kërkesës. Në kërkesat në fazë ekzekutimi apo ato që lidhen me “marrëdhëniet juridiksionale me jashtë” roli i gjykatës është i kushtëzuar nga qëndrimi i palëve dhe vullneti i tyre për të vijuar ose jo me gjykimin apo shqyrtimin e kërkesës.

- Subjekti shprehet se ka pasur në konsideratë dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkodër e cila lidhur në një rast të tillë ishte shprehur me vendimin nr. ***, datë 22.7.2019, kopje që subjekti e paraqiti në parashtrime. Sipas subjektit, nuk mund të bëhet analogji me një vendim gjyqësor të vitit 2022 të Gjykatës së Lartë, pasi vendimi i tij në këtë rast daton në maj të vitit 2019 dhe thekson që vendimi i tij nuk është ankimuar nga prokurori siç e parashikon neni 498.5 i Kodit të Procedurës Penale.

- Nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë 22.7.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër, vërehet se ndër të tjera gjykata është shprehur: (i) Pas shpalljes së vendimit të shkallës së parë dhe transferimit të dosjes në Apel, është përcjellë informacion shpjegues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Milano, ku nuk është përmendur dhënia e garancisë së kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, por është përcjellë informacion shpjegues se i pandehuri B. B. është dënuar në mungesë si dhe informacion mbi nenin 175, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale Italiane, i cili sipas këtij shpjegimi ofron mundësinë e rivendosjes në afat të të pandehurit të gjykuar në mungesë për të paraqitur ankim ndaj vendimit të dhënë ndaj tij; (ii) Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër, duke konstatuar se përgjigjja e dhënë nuk përbënte garanci formale, vendosi t'i kërkojë autoriteteve italiane që të shprehen nëse japin garanci në rast ekstradimi. Autoritetet e huaja të drejtësisë nuk kanë kthyer përgjigje; (iii) Gjykata e Apelit Shkodër, duke iu referuar qëndrimeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së, ka vlerësuar se dhënia

e garancisë nga autoritetet italiane të drejtësisë për rigjykim *de novo* të çështjes ndaj shtetasit B. B. përbën një kusht të panegociueshëm për miratimin e kërkesës së këtij vendi për ekstradimin e tij jashtë vendit.

Vlerësimi i Komisionit

50.21. Në analizë të parashtrimeve, konstatohet se subjekti ka kundërshtuar bindshëm të kundërtën e konstatimeve të Komisionit sa i përket vendimmarrjes për refuzimin e lejimit të ekstradimit të shtetasit A. N. , referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

- Shtetasi A. N. u provua se ka qenë i dënuar në mungesë në shtetin italian dhe se ky shtetas ka kërkuar që nga autoritetet italian të jepet garancia rishikuese.

- Subjekti në datën 1.10.2019 u ka drejtuar kërkesë autoriteteve italiane për dhënien e garancisë për rishikim të vendimit të dhënë me datë 5.6.2012 nga Gjykata e Apelit Milano për të gjykuarin A. L. alias A. N. . Në këtë kërkesë subjekti ka parashtruar faktet dhe bazën ligjore duke iu referuar specifikisht nenit 497/1/f të Kodit të Procedurës Penale, Konventës Evropiane të Ekstradimit të vitit 1957, protokollove shtesë, marrëveshjes ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë etj. Në vijim, ka bërë edhe kërkesa në datat 6.11.2019, 22.1.2020, 6.3.2020, 20.5.2020 dhe 29.6.2020.

- Me shkresë nr. ***/*** prot., datë 18.5.2020, Prokuroria e Përgjithshme e Republikës pranë Gjykatës së Apelit Milano ka informuar se i dënuari është deklaruar si në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë në kërkim e në mungesë, e me mundësi për t'u paraqitur pas dorëzimit të tij, kërkesë e nenit 175 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në përfundim subjekti, bazuar në nenin 491/f të Kodit të Procedurës Penale, ka arsyetuar se për gjykatën mosdhënia e garancisë për rishikimin e vendimit (të dhënë në mungesë të të pandehurit) nga shteti kërkues, përbën pengesë të pakapërcyeshme për lejimin e ekstradimit. Sipas kësaj dispozite ligjore nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit.

Siç vërehet, subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes ka bërë kërkesa të shumta drejtuar autoriteteve italiane për dhënie garancie në bazë të interpretimit të tij të parashikimit të nenit 491/f të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë çuar edhe në zgjatjen për arsye objektive të procesit gjyqësor, provuar edhe nga aktet e dosjes. Pra, subjekti ka mbajtur qëndrim aktiv dhe jo pasiv, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt. Po kështu, me të drejtë, subjekti ka vlerësuar se vetëm parashikimi i nenit 175 të Kodit të Procedurës Italiane i pashoqëruar me garancinë për rishikim, nuk krijon premisa të mjaftueshme që për akuzat e ngritura ndaj shtetasit A. L., këtij do t'i garantohet një gjykim në themel në të tria shkallët e gjyqësorit italian.

Qëndrimi i mbajtur nga subjekti mbështetet edhe në praktiken e paraqitur prej tij, për një çështje të trajtuar nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 22.7.2019, që është një rast i ngjashëm me rastin e shqyrtuar nga subjekti mbi dhënien e garancisë për ekstradimin.

Bazuar në sa më sipër, vendimi nr. ***, datë 10.9.2020, i dhënë nga subjekti, me objekt "Lejim ekstradimi të A. L. alias A. N. " është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë nuk rezultoi që ai të ketë favorizuar shtetasin A. L. alias A. N. . Mungesa e një favorizimi përforcohet akoma më tepër me faktin se, siç rezultoi nga hetimi administrativ, që në fillim të procesit të ekstradimit kur është marrë vendimi nr. ***, datë 13.5.2019, nga subjekti për miratimin e arrestit provizor dhe caktim e masës së sigurimit për shtetasin A. L. alias A. N. , trajtuar më lart, subjekti ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila nuk është pranuar nga Kryetarja e Gjykatës. Për më tepër, u vërtetua se me vendimin nr. ***, datë 2.4.2020, me objekt "Zëvendësim mase sigurimi", me kërkues A. N. , subjekti nuk e ka pranuar kërkesën e këtij shtetasi, një fakt më tepër që hedh dritë mbi mungesën e vullnetit të subjektit për një favorizim të këtij shtetasi.

Sa i takon etikës profesionale dhe integritetit në fazën e përfundimit të hetimit administrativ referuar fakteve: (i) me shtetasin A. N. , shtetas i përfshirë në krimin e organizuar dhe dënuar me 10 vite heqje lirie, subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në vitin 2007 për një pasuri për të cilën janë ngritur dyshime për një pasuri të mundshme të fshehur të tij, për më tepër subjekti ka favorizuar këtë shtetas duke refuzuar kërkesën për ekstradim të tij; (ii) u vërtetuan kontaktet dhe marrëdhëniet me shtetasin Y. D. i cili është person me precedentë penalë, duket se subjekti ka cenuar standardet e etikës, rregullat e sjelljes dhe integritetit sipas parashikimit të neneve 4 dhe 75/3 të ligjit nr. 96/2016. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të kundërshtuar këtë konstatim.

Në parashtrimet e tij subjekti thekson se gjatë punës së tij si gjyqtar është përpjekur të jetë shumë korrekt duke parashtruar se me shtetasin A. N. ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në vitin 2007 për llogari të vëllait të tij H. H. dhe në kohën e lidhjes së kontratës nuk e ka njohur dhe as ka pasur ndonjë informacion lidhur me këtë shtetas. Subjekti sqaroi se nuk ka pasur interes të informohet më tepër, pasi ishte thjesht një kontratë sipërmarrjeje që u nënshkrua prej tij si përfaqësuar ligjor i vëllait i cili ka nënshkruar kontratën përfundimtare të shitjes. Sipas tij, vetëm data e redaktimit të kontratës së sipërmarrjes ka qenë momenti i parë dhe i fundit i takimit me këtë shtetas në zyrën e noterit. Subjekti parashtron se për këtë shtetas i cili ishte administrator i një firme të licencuar nga shteti që ka marrë përsipër ndërtimin e objektit pas marrjes së një leje ndërtimi të ligjshme, nuk ka ngritur asnjëherë dyshimin se mund të ketë qenë i dënuar apo i kërkuar në ndonjë shtet të Bashkimit Europian. Subjekti gjithashtu shpjegoi edhe faktin se, në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe nuk ka pasur asnjë mundësi njohje me këtë shtetas pasi jetonte në ***. Subjekti thekson se edhe në shqyrtimin e kërkesës për ekstradim ka zbatuar vetëm ligjin dhe nuk ka ndikuar në këtë vendimmarrje asnjë influencë përveçse ligji dhe ndërgjegjja e tij ka qenë shumë e lartë pasi në veprimet e para ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i kërkesës, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kryetarja e Gjykatës.

Në lidhje me kontaktin me shtetasin Y. D., subjekti parashtrroi se sikurse ai ka deklaruar edhe gjatë hetimit, e ka njohur thjesht si person që ka pasur një lokal në *** të Lezhës dhe e ka takuar në kohën kur ai së bashku me familjen ka qenë duke drekur në lokalin në pronësi të babait të tij M. D. dhe kur makina e tij ka pësuar një defekt për shkak se nuk ndizej. Sipas subjektit, fakti që ka përdorur një makinë e cila sipas dokumentacionit rezultoi që të jetë në pronësi të shtetasit Y. D., nuk arrin të provojë një kontakt me të dhe sipas tij, kjo gjë nuk e bën që të ndihet fajtor për faktin që nuk mund të ketë pasur dijeni se djali i pronarit të një lokali ku po drekonte ka qenë shtetas me precedent penal. Sipas tij, nuk kishte nga ta siguronte këtë informacion dhe se është një rastësi që, duke e gjykuar sot në këto kushte, mund të quhet e rastësi e keqe. Subjekti sqaron se e ka takuar shtetasin Y. D. vetëm ditën kur ka qenë në lokal dhe i ka marrë makinën ndërsa ditën që ka kthyer mjetin ka takuar babain e tij.

Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.2024, të lëshuar nga shtetasi M. D., babai i shtetasit Y. D., pronar i lokalit në ***, në të cilën ky shtetas deklaroi se në verën e vitit 2017 në restorantin e tij familjar, djali Y. D. i ka dhënë mjetin me targë *** një familjeje që po drekonte pas një defekti që ka pasur mjeti i tij, pasi kjo familje kishte fëmijë të vegjël. Këtë mjet ia kanë lënë me besim pasi kishte lënë mjetin e tij para lokalit dhe pas disa ditësh është kthyer dhe ka marrë mjetin me karroatrec dhe ka lënë mjetin e tyre.

Në analizë të parashtrimeve në përfundim të procesit, nga ana e Komisionit vlerësohen se sqarimet e subjektit janë të plota, shteruese dhe të provuara, pasi:

- *Së pari*, sa i përket shtetasit A. N. rezultoi se:

i) Subjekti ka pasur vetëm një kontakt në vitin 2007, në fillim të detyrës së tij si gjyqtar dhe nuk u konstatuan kontakte të mëtejshme si nga të dhëna të sistemit TIMS ashtu edhe nga të dhëna të tjera të marra në rrugë ligjore.

ii) Shkak i këtij kontakti ka qenë pikërisht cilësia e shtetasit A. N. si administrator i shoqërisë me të cilin subjekti ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje (blerë nga vëllai i tij), pra nuk ka qenë kontakt i një natyre të tillë që mund të cenonte etikën dhe integritetin e gjyqtarit.

iii) Në kohën e nënshkrimit të kontratës për një apartament të ndodhur në ***, Lezhë, subjekti si përpara ashtu edhe pas fillimit të detyrës ka qenë me banim në ***, rrethanë që në vetvete tregon se ai nuk mund ta njihje këtë shtetas në mënyrë të tillë që të krijonte dyshime mbi veprimtarinë e tij përtej të qenit administrator në një shoqëri.

iv) Në rastin e trajtimit të një kërkesë për ekstradimion e tij, pas një analize të detajuar të të gjitha fakteve e rrethanave dhe pas parashtrimeve e dokumenteve që subjekti paraqiti në ushtrim të barrës së provës, nuk rezultoi që subjekti ta ketë favorizuar këtë shtetas (trajtuar në paragrafin 50.18 të vendimit).

v) Në trajtimin e çështjes së ekstradimit me këtë shtetas, është vërtetuar që subjekti të ketë kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, kërkesë e cila nuk i është pranuar nga titullari i institucionit.

vi) Është vërtetuar se në një rast tjetër, subjekti ka refuzuar kërkesën e këtij shtetasi për zëvendësimin e masës së sigurisë.

- *Së dyti*, sa i takon shtetasit Y. D., rezultoi se dënimi i tij ka qenë në vitin 2008 për “Vjedhje në formën e bashkëpunimit të thjeshtë”, pra 9 vite para se subjekti të përdorte mjetin e tij vetëm një herë në muajin gusht të vitit 2017. Para dhe pas këtij takimi nuk janë vërtetuar kontakte me këtë shtetas si nga të dhënat e sistemit TIMS ashtu edhe nga të dhëna të tjera të marra në rrugë ligjore. Për rrjedhojë, nuk vërtetohet dijenia e subjektit se ky shtetas ka qenë i dënuar dhe sqarimet e subjektit sipas të cilit kemi të bëjmë vetëm me një rastësi për shkak të përdorimit të mjetit të këtij shtetasi, bëhen të besueshme.

50.22. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni çmon se kontaktet me këta dy shtetas nuk përmbajnë elemente të tilla që të mund të vlerësohet se subjekti ka cenuar standardet e etikës, rregullat e sjelljes dhe integritetin sipas parashikimit të neneve 4 dhe 75/3 të ligjit nr. 96/2016.

51. Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në analizë të çdo çështjeje të shqyrtuar dhe në një vlerësim tërësor të fakteve të rezultuara nga hetimi, Komisioni çmon se subjekti në disa raste ka treguar mangësi në drejtim të aftësive profesionale, parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016, kryesisht në arsyetimin dhe qartësinë e vendimeve, sikurse është evidentuar rast pas rasti në këtë vendim dhe në një rast ka treguar mangësi në drejtim të njohurive ligjore (çështja e trajtuar në paragrafin 50.8 të vendimit), ndërkohë që nuk janë evidentuar mangësi organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, problematika në etikë dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, si dhe aftësive personale dhe angazhimin profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Në një vlerësim tërësor të çështjes, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës¹⁵, faktin që kanë qenë të shpeshta rastet kur vendimet e subjektit nuk janë ankimuar, qëndrimin pohues dhe reflektues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në raport me çdo problematikë, Komisioni çmon të konsiderojë si pasaktësi mangësitë në rastet e analizuara, por të tilla që nuk mund të përbëjnë shkak për një vlerësim negativ të aftësive profesionale.

52. Për të arritur në këtë përfundim Komisioni mban në konsideratë nga njëra anë peshën specifike të pasaktësive të evidentuara në drejtim të kriterit të aftësive profesionale (neni 72 i ligjit) në raport me tri kriteret e tjera të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 (nenet 74, 75 dhe 76 të ligjit), për të cilat subjekti është vlerësuar pozitivisht dhe nga ana tjetër, standardin e

¹⁵ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 1.2.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016) 036 të Komisionit të Venecias). Në këndvështrim të këtij qëndrimi, në përfundim të procesit Komisioni çmon se mangësitë e konstatuara nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, të tilla që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme që cenojnë njohuritë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo bëjnë të domosdoshëm rregullimin e tyre nëpërmjet programit të edukimit si dhe, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin në publik. Për pasojë, subjekti nuk ndodhet në asnjë prej rrethanave të parashikuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

53. Bazuar në sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues për t’u konsideruar i aftë profesionalisht sipas parashikimit të nenit 44, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

54. Për një qëndrim sa më objektiv, sa i takon çështjeve të referuara në dy denoncime, konkretisht: (i) çështjes që i përket vendimit nr. ***, datë 6.4.2020, trajtuar tek paragrafi 50.2.1; (ii) çështjes që i përket vendimit nr. ***, datë 28.3.2022, trajtuar tek paragrafi 50.15, Komisioni vlerësoi transferimin e tyre pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

SEANCA DËGJIMORE

55. Në datën 12.3.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Artan Hajredinaj dhe shpalli vendimin në seancën e datës 19.3.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

56. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe deklaratën *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Transferimin e dy çështjeve të referuara në dy denoncime nga publiku, sikurse është arsyetuar në këtë vendim, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana